



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 188

Tiranë – E hënë, 13 janar 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 889, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Shyqyri Hajdar Ballgjini..... 16985
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 890, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Faruk Fejzulla Sejdi..... 16985
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 891, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Shyqyri Pajazit Sako..... 16985
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 892, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Zenel Bejto Drangu..... 16985
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror znj. Ela Sotiraq Tase..... 16986
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Visar Hekuran Zhiti..... 16986
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 895, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Ago Faik Nezha..... 16986
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 896, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Viktor Kiço Papavangjeli..... 16986
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 897, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Hysni Hasan Zela..... 16987
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 898, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror znj. Valentina Shefqet Shehi (Myrto)..... 16987
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 899, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Ndriçim Hivzi Spahiu..... 16987

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 900, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Rauf Islam Dimraj.....	16987
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 901, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Jorgo Perikli Papingji.....	16988
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 902, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Edgar Robert Prifti...	16988
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 24.12.2019	Për miratimin e strategjisë kombëtare për kulturën, 2019–2025.....	16988
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 907, datë 24.12.2019	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Astrit Shuaip Hafizi.	17019
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 30, datë 30.12.2019	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar.....	17019
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 438, datë 26.12.2019	Për procedurat e regjistrimit, licencimit dhe publikimit në mënyrë elektronike.....	17021
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 439, datë 26.12.2019	Për miratimin e përdorimit të formularëve të aplikimit vetëm <i>on-line</i> , të standardizuar nga Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), për regjistrimin dhe licencimin e biznesit.....	17022
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 439/1, datë 31.12.2019	Për një shtesë në urdhrin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 439, datë 26.12.2019 “Për miratimin e përdorimit të formularëve të aplikimit vetëm <i>on-line</i> , të standardizuar nga Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), për regjistrimin dhe licencimin e biznesit”.....	17024
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 444, datë 31.12.2019	Për një shtesë në urdhrin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 438, datë 26.12.2019, “Për procedurat e regjistrimit, licencimit dhe publikimit në mënyrë elektronike”.....	17024
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 685, datë 19.12.2019	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e kushteve shëndetësore dhe karantinore të disa specieve zogjsh”.....	17027
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 210, datë 18.12.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “Wonder” sh.p.k. dhe kërkesën e shoqërisë “Hydropower-SAS” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 7.11.2019.....	17045
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 211, datë 18.12.2019	Mbi shtyrjen e periudhës tranzitore për bërjen efektive të transferimit të licencave të Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), të shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.); licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të Shërbimit Universal të Furnizimit të Energjisë Elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), të shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.)”.....	17048

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 212, datë 18.12.2019	Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2019.....	17049
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 237, datë 23.12.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW.....	17057
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 238, datë 23.12.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 170, datë 7.11.2019, të ERE-s, mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme, të ardhshme apo të tashme, dhe vendosjen e hipotekës mbi asetet e paluajtshme, që do t’i përkasin hec-eve “German 1” dhe “German 2”, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për efekt të dhënies së kredisë për financimin e ndërtimit të veprave hidroenergjetike “German 1” dhe “German 2”	17058
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 239, datë 23.12.2019	Mbi rishikimin e vendimit nr. 114, datë 22.7.2019, mbi licencimin e shoqërisë “SPE Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gjadër nr. 1/1”, me kapacitet të instaluar 2134 kw, HEC “Gjadër nr. 1/2”, me kapacitet të instaluar 4406 kw, HEC “Gjadër nr. 2”, me kapacitet të instaluar 2983 kw, HEC “Gjadër nr. 3”, me kapacitet të instaluar 3874 kw, HEC “Gjadër nr. 4”, me kapacitet të instaluar 5922 kw, HEC “Gjadër nr. 5”, me kapacitet të instaluar 5619 kw, me kapacitet total të instaluar 24938 kw.....	17061
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 240, datë 23.12.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO-s dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar.....	17062
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 10966/1, datë 30.12.2019	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit: “Sistemim rrugësh, blloku te Stadiumi”, Pogradec.....	17063
	Ndreqje gabimi material në vendimin nr. 799, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 170, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1 000 000 000 (një miliard) lekë në programin: ‘Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 170, datë 13.12.2019.....	17065

**VENDIM****Nr. 889, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. SHYQYRI
HAJDAR BALLGJINI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Shyqyri Hajdar Ballgjini, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 890, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. FARUK FEJZULLA SEJDINI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Faruk Fejzulla Sejdini, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 891, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. SHYQYRI PAJAZIT SAKO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Shyqyri Pajazit Sako, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 892, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. ZENEL
BEJTO DRANGU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Zenel Bejto Drangu, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 893, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR ZNJ. ELA
SOTIRAQ TASE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Ela Sotirac Tase, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 894, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. VISAR
HEKURAN ZHITI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Visar Hekuran Zhiti, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 895, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. AGO FAIK NEZHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Ago Faik Nezha, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 896, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. VIKTOR
KIÇO PAPAANGJELI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Viktor Kiço Papavangjeli, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 897, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. HYSNI
HASAN ZELA**

1.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Hysni Hasan Zela, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 898, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI
TË POSAÇËM SHTETËROR ZNJ.
VALENTINA SHEFQET SHEHI
(MYRTO)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Valentina Shefqet Shehi (Myrto), në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 899, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. NDRIÇIM
HIVZI SPAHIU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Ndriçim Hivzi Spahiu, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 900, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. RAUF ISLAM DIMRAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Rauf Islam Dimraj, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 901, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. JORGO PERIKLI PAPINGJI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Jorgo Perikli Papingji, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 902, datë 24.12.2019****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. EDGAR
ROBERT PRIFTI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Edgar Robert Prifti, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 903, datë 24.12.2019****PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
KOMBËTARE PËR KULTURËN,
2019–2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 26, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën, 2019–2025, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe të gjitha institucionet e përmendura në Strategjinë Kombëtare për Kulturën, 2019–2025, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

Tabela e përmbajtjes

Fjala e ministrit

Pjesa I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

2. Kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, mësimet

3. Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019–2025

3.1 Vizioni dhe misioni

3.2 Treguesit e ndikimit dhe treguesit e rezultatit

Pjesa II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

4. Qëllimi i Politikës 1: Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit, nga i cili do të përfitojnë krijuesit, krijimtaria artistike dhe kulturore dhe trashëgimia kulturore

4.1 Objektivi specifik 1: Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës



5. Qëllimi i politikës 2 – Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore

5.1 Objektivi specifik 2 – Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve të rehabilituara

6. Qëllimi i politikës 3 – Nxjtja dhe përfaqësimi i vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave më të mira

6.1 Objektivi specifik 3 – Promovimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore

7. Qëllimi i politikës 4 – Mbështetje e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike.

7.1 Objektivi specifik 4 – Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, produkteve si dhe cilësisë artistike

8. Qëllimi i politikës 5 – Hartimi dhe zbatimi i një platforme arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit parauniversitar.

8.1 Objektivi specifik 5 – Edukimi përmes kulturës

Pjesa III: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Pjesa IV: PLANI I VEPRIMIT

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR KULTURËN 2019–2025

Vizioni

Artet dhe trashëgimia kulturore e Shqipërisë, si forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Misioni

Krijimi i mjedisit të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese në sektorin publik dhe privat.

Qëllimi strategjik

Më shumë vëmendje për artin dhe kulturën

Qëllimet politike dhe objektivat specifikë

1. Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit nga i cili do të përfitojnë krijuesit, krijimtaria artistike dhe kulturore dhe trashëgimia kulturore.

- Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës.

2. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore.

- Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike, muzeve dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve dhe muzeve të rehabilituara.

3. Nxjtja dhe përfaqësimi i vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave të mira.

- Promovimi i vlerave të artit, trashëgimisë kulturore dhe fondeve muzeore.

4. Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike.

- Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë, si dhe rritjen e cilësisë artistike.

5. Hartimi dhe zbatimi i një platforme arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit parauniversitar.

- Zhvillimi i audiencave.

Fjala e ministrit

“Nëse mund të ruajmë kulturën, jemi të aftë të krijojmë”.

Në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe në një botë gjithnjë e më globale, ruajtja e identitetit, e kulturës sonë të përbashkët, por edhe ngritja e standardeve, është kthyer në misionin tonë dhe në guidën drejt realizimit të këtij dokumenti strategjik.

Shpesh, kur flitet për kulturën, ndërmendet argëtimi, por ne tashmë jemi të bindur për karakterin ndërtues, edukues, por edhe zhvillimor të ekonomisë së vendit. Statistikat na dëshmojnë se kultura mund të kthehet edhe në motor zhvillimi ekonomik.

Përgjatë vitit 2019, për herë të parë pritëm mbi 1 milion vizitorë në muze, parqe arkeologjike e monumente kulture. Shifër kjo që përkthehet në numër biletash të shitura dhe në të ardhura ekonomike, që lidhen jo thjesht me buxhetin e shtetit, por drejtpërdrejtë me ekonominë lokale, me



mirëqenien e jetëve të të gjithë atyre banorëve pranë parqeve arkeologjike, kalave apo monumenteve të kulturës.

Edhe Strategjia Kombëtare Kulturore 2019–2025 do të mbështetet në këto shtylla kryesore: trashëgimi kulturore, jetë artistike dhe edukim përmes kulturës.

Është bërë një punë e gjatë dhe e thelluar, në konsultim të vazhdueshëm me të gjitha grupet e interesit, kemi mbledhur mendimet e të gjithëve, për të arritur në këtë dokument, që do të drejtojë në shinat e duhura, kulturën në këto 6 vitet e ardhshme, duke pasur si qëllim, krijimin e mjedisit të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese, në sektorin publik dhe privat.

Në fushën e trashëgimisë kulturore asaj materiale dhe jomateriale do të synojmë ruajtje, mirëmbajtje, restaurim, rijetësim, regjistrim, digjitalizim e promovim. Përmes përmirësimit të legjislacionit i kemi hapur udhë formave të reja të menaxhimit të pasurive të trashëgimisë sonë kulturore, për t'i kthyer ato në qendra konkurruese në rajon. Paralelisht po punojmë për përmirësimin dhe shtimin e shërbimeve, përmes biletarive elektronike dhe atyre on line, futjes së shërbimit të audioguidave etj.

Shqipëria është një vend me një histori të jashtëzakonshme, ndërthurje kulturash, me gjurmë që nga lashtësia, për të ardhur tek ato më moderne, lënë prej regjimit komunist. Të gjitha këto e bëjnë vendin tonë tërheqës për vizitorin e huaj. Është detyra jonë, që gjithë sa na është trashëguar, ta përcjellim ndër brezat e ardhshëm dhe ta bëjmë interesante dhe ftuese për turistët.

Në lëmë të artit, do të vijojmë të jemi gjithëpërfshirës, do të mbështesim krijimtarinë e artistëve shqiptarë, do të përfshijmë në aktivitete kulturore sa më shumë të rinj, në kuadrin e Paktit për Universitetin dhe do të nxisim aktivitetin e skenës së pavarur kulturore si edhe do të të stimulojmë industrinë kreative. Përmes këtij dokumenti strategjik është krijuar guidë mbi mbështetjen e krijuesve dhe organizatave të pavarura kulturore, me qëllim zhvillimin dhe promovimin e sektorëve kulturorë dhe synim pavarësimin e tyre në tregun e sotshëm.

Do të sigurojmë vazhdimësinë e pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare, si dhe organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare në vend.

Por në radhë të parë nevojitet krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës, duke iu afruar standardeve dhe kërkesave të Bashkimit Evropian. Këtu përfshihen hartimi dhe miratimi i ligjit “Për pensionet e profesioneve të vështira”; reformimi i ligjit të artit dhe kulturës; reformimi i ligjit për kinematografinë etj. Do të përforcojmë mekanizmat rregullatorë e do t'i kushtojmë një vëmendje të veçantë respektimit të së drejtës së autorit, çka do të ndikojë edhe në nxitjen e krijimtarisë.

Por sfida më e madhe është përmirësimi i infrastrukturës dhe ngritja e ndërtesave të reja për institucione të artit, si Biblioteka Kombëtare, Teatri i Kukullave, Qendra Kulturore Hebraike, ndërsa synojmë rijetësimin e Burgut të Spaçit, si një qendër kulturore.

Do të vijojmë me edukimin përmes kulturës, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, duke ia nisur që nga më të vegjlit deri te studentët. Të gjithë biem në një mendje në karakterin edukues të kulturës dhe të investosh në edukim, është një investim në të ardhmen.

Implementimi i kësaj strategjie do të dojë kohë dhe mund, ndaj ftoj çdo ent publik e privat, çdo shqiptar e shqiptare, të bëhet pjesë e këtij procesi, që e kthen kulturën në kryefjalë.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

Pjesa I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

Strategjia Kombëtare e Kulturës është dokument i hartuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë, i cili ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të politikave kulturore në vend, prirjet e zhvillimit të sektorit kulturor dhe krijues, si dhe të paraqesë planin e veprimit drejt krijimit të një mjedisi të favorshëm për rritjen e rolit të kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë, të shoqërisë së saj dhe të çdo individi.

Fuqizimi i sektorit të kulturës vazhdon të jetë një nga objektivat në planet afatmesme dhe afatgjata të qeverisjes 2017–2021, si e vetmja rrugë drejt zhvillimit të sektorit të kulturës në aspektin ekonomik dhe social. Dokumenti “Strategjia



Kombëtare për Kulturën” (SKK)¹ 2019–2025 është hapi i radhës me qëllim strukturimin e objektivave për zhvillimin e sektorit.

SKK 2019–2025 dhe Plani i saj i Veprimit synon konceptimin e një udhërrëfyesi për zhvillimin e sektorit të kulturës, trashëgimisë kulturore dhe industrisë krijuese me qëllim të krijimit të kushteve të favorshme për zhvillim individual, social dhe shtetëror.

Hartimi i dokumentit ka ndjekur metodologji gjithëpërfshirëse duke u bazuar në vlerësimin e grupeve të interesit nga sektori publik dhe privat, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, në mbështetjen e organizatave ndërkombëtare që veprojnë në fushën e kulturës, artit dhe trashëgimisë kulturore në Shqipëri, si dhe në mbështetjen e ekspertëve vendas dhe të huaj të fushës me synim të ofrimit të zgjidhjeve të qëndrueshme për sfidat sektoriale drejt misionit që kultura të bëhet element zhvillimi ekonomik dhe social për qytetarët shqiptarë.

Kjo strategji është hartuar duke pasur parasysh gjendjen e sektorit të kulturës në Republikën e Shqipërisë, karakteristikat dhe vlerat themelore të saj, problematikën e krijuar ndër vite dhe nevojën për gjetjen e zgjidhjeve optimale. Ajo është hartuar në përputhje me standardet evropiane të zhvillimit të kulturës dhe reflekton përvojën e krijuar në BE në fushën e hartimit dhe zbatimit të strategjive kulturore të vendeve evropiane.

Dokumenti strategjik SKK 2019–2025 u drejtohet institucioneve publike qendrore dhe lokale, operatorëve të pavarur kulturorë, OJF-ve, sektorit privat dhe aktorëve të tjerë që operojnë në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

2. Kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, mësimet

Krijimi i Ministrisë së Kulturës në vitin 2013, si institucion që, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ka për detyrë përmirësimin, konceptimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore për çështjet e sistemit të artit dhe kulturës, i dha rëndësi thelbësore politikave kulturore dhe investimeve në kulturë, me qëllim të hapjes së perspektivave të reja për sektorin, duke kthyer kulturën në prioritet, motor zhvillimi dhe pasaportë kombëtare.

Në qendër të investimeve me qëllim kthimin e Shqipërisë në një destinacion turistik u vendos trashëgimia kulturore, si burim i pashfrytëzuar për zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik. Në zbatim të programeve madhore të Qeverisë për rilindjen urbane dhe zhvillimit rural, si dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm 2030², investimet me fokus mirëmbajtjen, restaurimin, konservimin, rehabilitimin dhe rijetësimin e vlerave të trashëgimisë kulturore kombinuar me vlerat e pasurive natyrore për nxitje të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të rajoneve dhe komuniteteve, si dhe zhvillimi i turizmit kulturor gjatë periudhës 2014–2018 u zbatuan në koordinim mes programeve “Trashëgimia – Motor Zhvillimi”, “Rrugët e Besimit” dhe “Rrugët e Kujtesës.”

Përmes programit “Trashëgimia – Motor Zhvillimi” në bashkëpunim me partnerë të rëndësishëm, janë restauruar dhe rikonstruktuar qendrat historike dhe ansamble urbane në Korçë, Tiranë, Gjirokastrë, ndërsa vijojnë punimet në qendrat historike dhe ansamblet urbane në Vlorë, Voskopojë, Vuno dhe Dhërmi. Në kuadër të programit “Rrugët e Besimit” që në fokus ka rrugët historike dhe tregtare të kombinuara me trashëgiminë kulturore, kulinarinë dhe artizanatin janë restauruar një pjesë e konsiderueshme e objekteve të kultit³ monumente kulture. Për programin “Rrugët e Kujtesës,” unik i këtij lloji në Shqipëri, Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me partnerët ka ndërmarrë disa iniciativa që përmes rehabilitimit, transformimit dhe muzealizimit synojnë të nxjerrin në pah aspektin historik dhe edukativ të siteve të ish-diktaturës, me qëllim ruajtjen e kujtesës kombëtare dhe promovimin e vlerave të brezat e ardhshëm.

Në pesë vite u ngritën tre muze të rinj, Muzeu Kombëtar i Fotografisë “MARUBI”, Shkodër, Muzeu Kombëtar “GJETHI”, Tiranë dhe Muzeu “Gjon Mili”, Korçë⁴ si dhe u punua në muzealizimin dhe rinovimin e muzeve ekzistues: Muzeut Arkeologjik në Durrës dhe Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar në Korçë, të gjitha sipas standardeve evropiane. Gjithashtu janë

² Sustainable Development Goal / <https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>

³ Kisha, xhami dhe teqe.

⁴ Muzeu është ngritur në bashkëpunim dhe është në administrim të Bashkisë Korçë.

¹ Këtu e në vijim SKK 2019-2025




përgatitur projektet për rikualifikimin dhe rikonceptimin e Muzeut Historik Kombëtar, si dhe për rehabilitimin e godinës së Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura⁵, të cilat do të zbatohen në vitet në vijim nga buxheti i shtetit dhe në partneritet me donatorët.

Në kuadër të Programit të Integruar për Zhvillim Rural “100 Fshatrat”, Ministria e Kulturës përmes punës së institucioneve të varësisë dhe mbështetjes financiare të partnerëve të saj ka dhënë dhe vazhdon të japë kontribut me investime në ruajtjen dhe konservimin e monumenteve të kulturës dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe traditave përmes panairëve, festave lokale etj.

Në total gjatë periudhës 2014–2018 janë investuar mbi 68 milionë lekë për mirëmbajtjen dhe restaurimin e 689 monumenteve⁶, si dhe rjetëzimin e qendrave historike, të ndara sipas viteve në tabelën 1. Në grafikun 1. paraqitet përqindja e monumenteve të mirëmbajtura ndaj totalit të përgjithshëm (2028) të monumenteve të kulturës

Viti	Monumente të mirëmbajtura	
	Numri	Vlera e investimit (lekë)
2014	53	6,871,824
2015	123	15,383,211
2016	144	17,275,988
2017	155	15,491,735
2018	214	13,549,055
TOTAL	689	68,571,813

Tabela 1



Grafiku 1

Me synimin për të përmirësuar sistemin e menaxhimit fiskal të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe përmirësimin e performancës dhe

⁵ Galeria Kombëtare e Arteve me ligjin e ri emërtohet “Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura”.

⁶ Sipas LIGJIT nr. 27/2018, nenit 5, paragrafi 36. “Monument kulture” është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti.

standardeve të institucioneve të trashëgimisë kulturore, në shërbim të komuniteteve dhe në funksion të turizmit kulturor, Ministria e Kulturës në bashkëpunim me partnerë të huaj ndërmori dhe finalizoi projektin për biletaritet elektronikë në 10⁷ institucione të trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe platformën për promovimin e tyre⁸ dhe shitjen e biletave on-line.

Në vitin 2018 parlamenti miratoi ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”⁹, një nga ligjet më revolucionare në rajon, i cili synon ndër të tjera realizimin e reformave të thella në menaxhimin e trashëgimisë kulturore dhe muzeve, decentralizimin e administrimit dhe financimit të tyre, me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, si dhe të një ndryshimi në tërësi të qasjes së shoqërisë ndaj pasurive kulturore. Një nga konceptet e reja që sjell ligji, ndër të tjera është partneriteti strategjik me persona fizikë dhe juridikë të cilët, nga eksperiencia e tyre në fushë, vlera dhe cilësia e sponsorizimit, marrëveshja e bashkëpunimit, shkëmbimi i vlerave intelektuale dhe burimeve njerëzore e financiare, intensiteti dhe kohëzgjatja e bashkëpunimit vlerësohen si thelbësorë në zbatimin e politikave në fushën e trashëgimisë kulturore dhe sigurimin e objektivave të përbashkët në zhvillimin e fushës. Ndërsa përmes planeve të menaxhimit¹⁰ të qendrave historike, zonave dhe parqeve arkeologjike, grupit të vlerave të paluajtshme kulturore të rëndësisë kombëtare dhe vlerave të vetme të paluajtshme kulturore me rëndësi kombëtare, të cilët përveç planeve të ruajtjes dhe monitorimit kanë në përmajtje edhe dokumente legjislativë, financiare dhe administrative, përcaktohen strategjitë dhe mjetet e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke iu përgjigjur nevojave bashkëkohore të zhvillimit social dhe ekonomik.

Investimet kapitale në fushën e artit janë fokusuar kryesisht në rindërtimin e teatrove publike

⁷ Muzeu Gjergj Kastriot Skënderbeu, Krujë, Muzeu Etnografik, Krujë, Muzeu Onufri, Berat, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 5. Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, Shkodër, parqet arkeologjike Apollonia dhe Butrinti, Kalaja e Beratit, Shkodrës dhe Gjirokastrës.

⁸ <http://cultureticketsalbania.al>

⁹ <http://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Ligji.nr27-dt.17-05-2018.pdf>

¹⁰ Nenit 46, i ligjit nr. 27/2018 për trashëgiminë kulturore dhe muzetë



dhe krijimin e hapësirave në tërë vendin. Dy qytetet më të rëndësishme kulturore Shkodra dhe Korça kanë përfituar nga rindërtimi i teatrove Migjeni dhe Çajupi, ndërsa në Tiranë është krijuar skena e re shumë funksionale “ArTurbina”¹¹, si hapësirë për shfrytëzim nga institucionet e varësisë dhe operatorët e pavarur kulturorë. Në vitin 2017 ka filluar rindërtimi i godinës së Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, ndërsa në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës ka filluar procesi për rikonceptimin dhe ndërtimin e godinës së Teatrit Kombëtar, në një nga objektet me infrastrukturë moderne të fushës, e denjë për rolin e saj në historinë dhe zhvillimin e teatrit në Shqipëri.

Në kuadër të fushës së artit, rëndësi e madhe iu dha përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë në aktivitete ndërkombëtare, si Bialja e Artit dhe Bialja e Arkitekturës në Venecia, pjesëmarrjeve në panairt e librit në Lajpcig, Torino dhe aktivitete të tjera të rëndësishme ndërkombëtare.

Tipologjia e investimeve kapitale të realizuara nga fondi qeveritar dhe fondet e thithura nga burimet e jashtme për rinovime në institucionet kulturore të varësisë, si dhe për krijimin e hapësirave të reja për zhvillimin e artit dhe trashëgimisë kulturore, të paraqitura në tabelën 2, ka ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së ofertës kulturore, rritjen e të ardhurave nga produktet kulturore, si dhe edukimin e publikut të gjerë.

Viti	Buxheti i shtetit	DONATORËT	Totali
2014	360,120	424,963	785,083
2015	545,689	1,370,575	1,916,264
2016	409,515	570,250	979,765
2017	545,689	1,370,575	1,916,264
2018	851,794	341,727	1,193,521
TOTAL	2,712,807	4,078,090	6,790,897


Investime nga buxheti i shtetit dhe donatorët 2014–2018

Rëndësi e veçantë i është dhënë ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm menaxhimi të institucioneve publike dhe si rezultat i këtij sistemi, institucionet e varësisë kanë rritur numrin dhe cilësinë e produkteve dhe të shërbimeve kulturore, si rezultat i të cilave është rritur numri i vizitorëve dhe të ardhurat në institucionet e varësisë, të paraqitura në tabelën 3 dhe grafikët 2 dhe 3.


Vizitorë/spektatorë			Të ardhurat (,000)	
Viti	ART	TRASHËGIMI	ART	TRASHËGIMI
2013	39,248	325,805	9,349	52,719
2014	66,517	404,244	18,957	77,499
2015	149,586	460,744	18,597	98,953
2016	178,396	549,697	22,087	118,347
2017	387,356	669,110	15,127	141,574
2018	377,977	998,441	21,266	195,931

Tabela 3

¹¹ Hapur për publikun në vitin 2018.



Grafiku 2



Grafiku 3


Për herë të parë në vitin 2014, për financimin e projekteve me thirrje u iniciua procedura zyrtare e aplikimit me formular zyrtar, vlerësimit dhe aprovimit nga kolegjiu met përkatëse. Gjatë periudhës pesëvjeçare me një fond prej 233,591,000 lekë janë mbështetur 519 projekte me thirrje, ndërsa projektet e brendshme kapin numrin prej 241 projektesh në total prej 469,298,000 lekë.

Viti	Projekte me thirrje		Projekte të brendshme		Total projekte	
	Numri	Buxheti (,000 lekë)	Numri	Buxheti (,000 lekë)	Numri	Buxheti (,000 lekë)
2014	104	51,035	38	54,236	142	105,271
2015	82	39,813	47	119,046	129	158,859
2016	93	47,309	71	102,443	164	149,752
2017	123	45,868	40	102,866	163	148,734
2018	117	49,566	45	90,707	162	140,273
Shuma	519	233,591	241	469,298	760	702,889

Tabela 4. Të dhënat në lidhje me shpërndarjen e fondeve për projekte me thirrje, në vite sipas llojit të projektit.

Numri i aplikimeve ka qenë pothuaj konstant (mesatarisht rreth 238 të tilla në vit) dhe fituesit po ashtu kanë ndjekur të njëjtin trend (mesatarisht rreth 99 çdo vit). Nisur nga të dhënat për projektet e artit, siç vihet re edhe nga grafiku 4., rreth 60% e projekteve kanë marrë financim deri në vlerën 500 mijë lekë dhe vetëm 2% e tyre nga 1.5 deri 2.2 milionë lekë.


Shpërndarja e projekteve sipas vlerës së financimit



Grafiku 4

Me qëllim fuqizimin e diplomacisë kulturore, Ministria e Kulturës në vitin 2014 inicioi pjesëmarrjen në programe ndërkombëtare si Creative Europe/ Evropa Krijuese¹² dhe Traduki¹³ duke u mundësuar operatorëve të pavarur dhe institucioneve të varësisë të aplikojnë me projekte në platforma të njëjta, si homologët e tyre në shtetet perëndimore. Totali i fondeve të thithura në 5 vitet të fundit nga operatorët e pavarur nga këto dy programe është **1,618,425 €** i detajuar në tabelën 5. dhe grafikun 5.

Viti	TRAD UKI	Evropa Krijuese
2014	38,400 €	207,739 €
2015	38,700 €	308,743 €
2016	36,500 €	878,879 €
2017	30,500 €	54,458 €
2018	36,000 €	168,606 €
TOT ALI	180,100 €	1,618,425 €



Grafiku 5

Nga viti 2018, Ministria e Kulturës është Koordinator Kombëtar i Programit Europe for Citizens/ Evropa për Qytetarët duke filluar me trajnimin e operatorëve të pavarur për aplikim për komponentët: Projektet e shoqërisë civile, Binjakëzimi i qyteteve dhe Rrjetëzimet e qyteteve. Përmes programit IPA¹⁴ të BE-së, Ministria është bërë pjesë e disa projekteve, të cilat realizohen nga strukturat e kësaj ministrie, si dhe nga institucionet e varësisë në partneritet me organizata rajonale dhe ndërkombëtare.


Miratimi i ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” siguroi nivelin e mbrojtjes dhe zbatimin e të drejtave të autorit njësoj si në vendet e BE-së. Ky legjislacion është pjesë e një legjislacioni më të gjerë i njohur si pronësi intelektuale, i cili i referohet gjerësisht krijimeve të mendjes së njeriut. Ministria e Kulturës përmes Drejtorisë për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me to, është organi që monitoron këtë të drejtë, ndërsa monitorimi kolektiv në kuadër të ligjit kryhet nga agjencitë e administrimit kolektiv (AAK), fushëveprimi i punës së të cilave është grumbullimi i shpërblimit për përdorimin e punimeve dhe shpërndarjen e tyre ndaj bartësve të të

¹² <http://www.evropakrijuese.al/>

¹³ Traduki është një rrjet evropian për letërsi dhe libra, me fokus të veçantë përkthimet. (<http://english.traduki.eu/>)

¹⁴ Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA)

drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Organi vendimmarrës në fushën e të drejtës së autorit krijuar me ligjin nr. 35/2016 është Këshilli Kombëtar i të Drejtave të Autorit (KKDA) si organ i specializuar për përcaktimin e tarifave të shpërblimit ndaj përdoruesve të pronësisë artistike në tregun shqiptar. Trendi i detyrimeve të mbledhura dhe të shpërndara të bartësit e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga AAK-të gjatë periudhës 2015 - 2018 mund të shihet në grafikun 6.



Grafiku 6 (,000 lekë)


Programi “Edukimi përmes kulturës” ka nisur të formësohet në vitin 2014, kur edhe janë iniciuar projektet e para edukative në bashkëpunim me institucionet kulturore të varësisë, kryesisht në Tiranë. Kjo formë e qasjes ndaj ngritjes së njohurive dhe vetëdijes së brezave për rëndësinë dhe përfitimin nga arti, kultura dhe trashëgimia kulturore ka hasur në interesim të madh të pjesëmarrësve të grup-moshave të ndryshme. Përmes këtij programi është synuar njohja e brezave të rinj me artin dhe trashëgiminë kulturore në Shqipëri dhe nxitja e dëshirës për të krijuar dhe çmuar pasuritë kulturore. Gjatë vitit 2018 programi ka arritur përfshirjen e numrit rekord prej 55,000 nxënësish të moshave të ndryshme nga rreth 500 shkolla në gjithë vendin, me pjesëmarrje në rreth 700 aktivitete të organizuara nga institucionet kulturore të varësisë. Përmes programit Edukimi Përmes Kulturës është punuar edhe në identifikimin e talenteve të reja, si dhe është krijuar baza e qëndrueshme për publikun e së ardhmes. Ndikimi pozitiv i zbatimit të këtij programi dëshmohet nga rritja prej 55% e numrit të vizitorëve në institucionet kulturore, përmes pjesëmarrjes në aktivitete kulturore dhe edukuese në këto institucione, tendencë e cila shihet me prioritet për zhvillim më të gjerë.

Zbatimi i teknologjisë në funksion të një menaxhimi të qëndrueshëm dhe të produkteve dhe shërbimeve më cilësore ka qenë një nga prioritetet e Ministrisë së Kulturës gjatë periudhës 2014 – 2018. Krijimi i platformës WebGIS për menaxhimin e veprimtarisë arkeologjike në terren, të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik (ASHA)¹⁵ për vitet 2008–2015; ndërtimi i një aplikimi WebGIS për hartëzimin dhe inventarizimin e objekteve të përcaktuara si monument kulture; digjitalizimi i fondeve të Bibliotekës Kombëtare; digjitalizimi i fototekës për Muzeun Marubi, janë disa aplikimet e teknologjisë në kulturë dhe trashëgimi.

Gjithashtu, përmes sistemit të ri teknologjik për administrimin e pasurive kulturore, Qendra Kombëtare për Inventarizimin e Pasurive Kulturore (QKIPK) ka kryer regjistrimin në bazën e dhënave

¹⁵ Agjencia për Shërbime Arkeologjike

‘Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore’ të objekteve pasuri kulturore në pronësi publike dhe private në Republikën e Shqipërisë, të cilat i nënshtrohen ligjeve të shtetit shqiptar dhe konventave ndërkombëtare. Ky sistem ka mundësuar unifikimin e katalogëve në një bazë të vetme të dhënash, ku objektet identifikohen me kod unik dhe klasifikohen lehtësisht përmes kategorive në disa nivele. Sistemi, i qasshëm për pronarët e objekteve të regjistruara dhe qytetarët tjerë, ka lehtësuar procesin e shërbimit me publikun për regjistrimin, vlerësimin, sigurimin dhe qarkullimin kombëtar dhe ndërkombëtarë të pasurive. Sistemi ndërvepron me institucione të tjera shtetërore kompetente për monitorimin dhe kontrollin e objekteve në rast të denoncimeve për vjedhje apo grabitje të pasurive në vend, si dhe në rast të denoncimeve nga institucionet ndërkombëtare. Numri i objekteve të regjistruara gjatë periudhës 2013–2018 është 203,294,¹⁶ paraqitur në grafikun 7 ndarë sipas viteve.



Grafiku 7

Bashkëpunëtorë dhe partnerë të tjerë të Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve kulturore, të cilët kontribuojnë direkt apo indirekt te sektori i arteve, kulturës dhe trashëgimisë kulturore në Shqipëri janë institucione të tjera publike, si: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Shtetit për Diasporën, Akademia e Studimeve Albanologjike dhe Institutet e kërkimit shkencor, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, sistemi universitar, Akademia e Studimeve Antropologjike, Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, INSTAT etj.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë në administrimin e tyre një numër të konsiderueshëm të institucioneve kulturore si muze, teatro, qendra kulturore, biblioteka e galeri.

Janë dokumentuar mbi 280¹⁷ festa dhe aktivitete kulturore tradicionale dhe bashkëkohore të organizuara në tërë vendin nën patronazhin e institucioneve qendrore dhe vendore, operatorëve të pavarur, si dhe të grupeve të vogla që mbajnë gjallë traditat lokale, disa prej të cilave datojnë disa shekuj më parë.

Janë rreth 20 institucione arsimore para universitare dhe universitare, publike dhe private që ofrojnë arsim dhe veprimtari krijuese në fushën e artit dhe kulturës, të trashëgimisë kulturore dhe të arkitekturës. Rreth 300 grupe joformale dhe organizata jofitimprurëse¹⁸ që i përkasin industrisë kulturore dhe krijuese.

Buxheti shtetëror i Ministrisë u rrit gradualisht duke shkuar deri 150% nga ai i vitit 2013, edhe pse në raport me PBB¹⁹-në përqindja e tij nuk ndryshoi (tabela 6.).

¹⁶ Numri i objekteve i gjeneruar me 18 shtator 2019 nga baza e të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore” (RKPK)

¹⁷ <http://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/05/Kalendari-2019.pdf>

¹⁸ Ligji nr. 8788, 7.5.2001 neni 2, pika 3. “Organizata jofitimprurëse” kuptohet shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti.

¹⁹ Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB).



Vitet	Shuma në lekë	Përqindja në raport me PBB-në
2013	1,422,912	0.10%
2014	1,516,000	0.11%
2015	1,487,160	0.10%
2016	1,654,309	0.11%
2017	1,687,900	0.11%
2018	2,090,000	0.13%

Tabela 6

Sot Ministria e Kulturës ka buxhetin më të ulët nga të gjitha ministrat e linjës, me 2,165,867,000 lekë për vitin 2019, apo 0,68% të buxhetit shtetëror. Në varësi të saj ka 28 institucione të fushës së artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore të cilat thithin rreth 50% të buxhetit, ndërkohë që pjesa tjetër shfrytëzohet për realizimin e aktiviteteve të organizuara nga MK si dhe operatorët e pavarur përmes projekteve me thirrje.

Institucionet e varësisë të Ministrisë së Kulturës janë:

1. Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Tiranë
2. Teatri Kombëtar, Tiranë
3. Teatri Kombëtar Eksperimental ‘Kujtim Spahivogli’, Tiranë
4. Galeria Kombëtare e Arteve²⁰, Tiranë
5. Biblioteka Kombëtare, Tiranë
6. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Tiranë
7. Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Tiranë
8. Cirkus Kombëtar, Tiranë
9. Qendra Kombëtare për Librin dhe Leximin²¹, Tiranë
10. Qendra Kombëtare e Kinematografisë²², Tiranë
11. Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Tiranë
12. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore²³, Tiranë
13. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore²⁴, Tiranë

²⁰ Me ligjin e ri nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë emërtohet ‘Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura’”.

²¹ Themeluar me 7 janar 2019

²² Varësia e përmbytjes nga MK-ja ndërsa varësia financiare nga Kryeministria.

²³ Themeluar me VKM nr. 364, datë 29.05.2019 me shkriren e IMK-së dhe ASHA-së

Faqe | 16998

14. Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë
15. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethë”, Tiranë
16. Muzeu Kombëtar ‘Gjergj Kastrioti Skënderbeu’ dhe Muzeu Etnografik, Krujë
17. Muzeu Kombëtar Ikonografik “Onufri” dhe Muzeu Etnografik, Berat
18. Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Muzeu i Arsimit dhe Arkeologjik, Korçë
19. Muzeu Kombëtar i Fotografisë MARUBI, Shkodër
20. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Vlorë
21. Zyra për Administrimin dhe Koordinimin e Parqeve Arkeologjike Apoloni dhe Bylis, Fier
22. Zyra për Administrimin dhe Koordinimin e Parkut Kombëtar të Butrintit, Sarandë
23. Drejtoria Rajonale për Trashëgimi Kulturore Shkodër
24. Drejtoria Rajonale për Trashëgimi Kulturore Tiranë
25. Drejtoria Rajonale për Trashëgimi Kulturore Korçë
26. Drejtoria Rajonale për Trashëgimi Kulturore Berat
27. Drejtoria Rajonale për Trashëgimi Kulturore Gjirokastrë
28. Drejtoria Rajonale për Trashëgimi Kulturore Vlorë

Problemët dhe sfidat e sektorit të kulturës

Pavarësisht investimeve të realizuara në pesë vitet e fundit në sektorin e kulturës, përkrahjes politike të nivelit të lartë dhe koordinimit të mirë ndërministror, vazhdimësisë dhe stabilitetit të politikave të Qeverisë edhe në fushën e kulturës, motivimit të lartë në menaxhim, zhvillim dhe përditësimin e sektorit me trendet bashkëkohore, janë identifikuar probleme dhe sfida, të cilat

²⁴ Themeluar me VKM nr. 432, datë 26.06.2019 me rristrukturimin e QKIPK-së



synohen të trajtohen përmes masave të propozuara në këtë dokument strategjik.

1. Shteti financuesi kryesor i institucioneve kulturore dhe operatorëve të pavarur

Pjesa integrale e buxhetit të institucioneve kulturore publike që shkon për shpenzimet operacionale, pagat dhe programet ka burim kryesor fondin shtetëror. Vetëm 30% e të ardhurave të realizuara nga institucionet kulturore të varësisë të Ministrisë së Kulturës (pa kaluar tavanin prej 2 milionë lekë përcaktuar nga MFE-ja) mbahen në fondin e institucioneve për shpenzime specifike²⁵. Përfshirja në Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, e cila administron 90% të të ardhurave të krijuara, të cilat klasifikohen si të ardhura jashtë tavanit të përcaktuar nga MFE-ja²⁶. Institucionet, edhe pse janë të lira të thithin fonde nga donatorët, sponsorizimet dhe projektet e bashkëpunimit, nuk arrijnë kapacitetin optimal. Operatorët e pavarur kulturorë janë kryesisht të fokusuar në thithjen e fondeve nga Ministria e Kulturës, ndërkohë që buxheti i përcaktuar për projekte me thirrje nuk mjafton për të financuar të gjitha projektet konkurruese. Në mungesë të aftësive dhe informacionit për qasje në fonde tjera, shumë operatorë të pavarur kanë burim të vetëm financimin nga shteti.

Ndryshimi i qasjes ndaj Ministrisë së Kulturës nga institucionet kulturore të varësisë dhe operatorët e pavarur si financuesi i vetëm i sektorit të kulturës duke ruajtur funksionin e saj politikëbërës në mbështetje të zhvillimit të sektorit dhe krijimit të mundësive për pavarësim krijues, artistik dhe institucional është sfida e cila synohet të arrihet me fuqizimin e reformave ligjore, stimulim të institucioneve dhe operatorëve të pavarur dhe stabilitetit financiar të veprimtarisë kulturore.

2. Zbatimi dhe ndërgjegjësimi për kuadrin rregullator

Prurjet e reformave ligjore me synim mirëfunksionimin dhe zhvillimin e fushës së kulturës krijojnë kushte juridike, ku përveç

artistëve, krijuesve dhe profesionistëve të fushës dhe fushave të ndërlidhura që përfitojnë nga veprimtaria e tyre janë edhe institucionet, organizatat, fondacionet dhe bizneset ato që mund të mbështesin dhe zbatojnë projekte të rëndësishme në fushën e kulturës. Reforma ligjore krijon hapësirë dhe oferta koherente për të tërhequr vizitorë, si dhe investitorët për partneritete publiko-private drejt mirëmbajtjes dhe rijetëzimit të trashëgimisë kulturore, si dhe zhvillimit të shërbimeve të turizmit kulturor. Nevoja për njohje dhe ndërgjegjësim për format e zbatimit të kuadrit rregullator që mbulon fushën e kulturës janë elemente që identifikohen kryesisht gjatë aplikimit të ligjeve, nga institucionet publike, ekspertë dhe qytetarët e thjeshtë, të cilët në një mënyrë ose tjetër preken nga kuadri rregullator.

Sfida ka të bëjë me zbatimin e kuadrit rregullator, ndërgjegjësimin për mundësitë e krijuara përmes reformave ligjore, si dhe modelet e zhvillimit të sektorit kulturor për risitë që do venë në lëvizje modernizimin e institucioneve kulturore, krijimin e hapësirave të reja për treg formal të artit dhe trashëgimisë kulturore, por edhe fuqizimin e krijuesit individual.

Një aspekt është ai i formalizimit të tregut të artit dhe pasurive kulturore, licencimi i ekspertëve për vlerësim të veprave të artit dhe pasurive kulturore, krijimi i qendrave për tregtim, krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit mes krijuesve dhe koleksionistëve, investime të reja në kulturë dhe konsum kulturor duke krijuar rregulla dhe stimulim/ lehtësira atraktive për investitorët privatë, rrjedhimisht forcim të sektorit të pavarur në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

3. Kapacitetet njerëzore të institucioneve kulturore dhe operatorëve të pavarur

Megjithëse nuk mungojnë idetë kreative në fushën e artit, të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, zgjerimi i spektrit të aktiviteteve që lidhen me kulturën dhe krijimtarinë krijon nevojën për trajnime, ngritje kapacitetesh dhe aftësim për punë, sipas kërkesave të ekonomisë së tregut dhe konsumit bashkëkohor të produkteve kulturore.

Problemi me të cilin ballafaqohen institucionet kulturore të varësisë si dhe operatorët e pavarur është mungesa e aftësive të transversale²⁷ për t'u

²⁵ Udhëzimi i përbashkët nr. 52, datë 9.2.2015 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të Ministrisë së Kulturës”.

²⁶ Sipas VKM-së nr. 928, datë 28.12.2011 të ardhurat e krijuara nga Parku Kombëtar i Butrintit përdoren në masë 90% nga ky institucion dhe klasifikohen si të ardhura jashtë limitit.

²⁷ Ekspertiza (*soft skills*)



përballur me aspekte të ndryshme të procesit të zbatimit të projekteve kulturore, nisur që nga thithja e fondeve, menaxhimi i projekteve, njohja e ligjeve dhe rregulloreve që aplikohen për fusha të ndryshme të veprimit, aftësi sipërmarrëse në sektorin e kulturës etj. Gjithashtu, mungesa brenda vendit e ofertave për trajnime specifike, vështirëson ose bën të pamundur ngritjen e kapaciteteve njerëzore pa qenë e nevojshme dalja jashtë shtetit.

Nevoja për ndërkombëtarizim dhe rrjetëzim, aftësimi për mobilizim të burimeve të financimit drejt rritjes së pavarësisë financiare, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe produkteve kulturore janë disa nga elementet përbërëse të sfidës për hartim dhe zbatim të programeve të kualifikimit të vazhdueshëm për aftësimin e stafit të institucioneve kulturore publike, të operatorëve të pavarur si dhe për ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të fushave të ndryshme që ndërlidhen direkt apo indirekt me sektorin e artit dhe kulturës.

4. Institucionet kulturore jashtë normave standarde

Problematikat me të cilat ballafaqohen institucionet kulturore në përgjithësi dhe ato të varësisë së Ministrisë së Kulturës në veçanti janë ambientet e degraduara dhe pajisjet e amortizuara, të cilat krijojnë vështirësi në ushtrimin e veprimtarisë dhe misionit të institucionit, por dhe vënë në rrezik objektet e artit dhe trashëgimisë që ato trajtojnë.

Sfida ka të bëjë me vështirësinë financiare për investime kapitale në të gjitha institucionet kulturore të varësisë, njëherazi me qëllim ndërhyrjet infrastrukturore, rindërtimet dhe përditësimin e pajisjeve të teknologjisë sipas standardeve moderne, në përshtatje të funksionit të institucioneve në një ekonomi tregu të formatit të ri të konsumit kulturor.

5. Bashkëpunimi i pamjaftueshëm mes institucioneve qendrore dhe vendore

Decentralizimi dhe delegimi i kompetencave nga niveli qendror te niveli vendor, ka rezultuar në ndarje të institucioneve të kulturës që menaxhohen dhe financohen nga këto dy instanca, duke krijuar kështu mangësi në aspektin e bashkëpunimit të institucioneve kulturore të dyja niveleve, por edhe në ndikimin dhe autoritetin e Ministrisë së Kulturës si organi politikëbërës në fushën e kulturës.

Rivendosja e bashkëpunimit të ngushtë mes dy pushteteve, me qëllim mirëkoordinimin e

aktiviteteve dhe angazhimeve, në shërbim të qytetarëve në përgjithësi dhe grupeve të ndryshme të interesit në veçanti, është sfida që do të trajtohet përmes planeve të veprimit për zbatim të dokumentit strategjik dhe projekteve të përbashkëta në zbatim të politikave qendrore dhe vendore në fushën e kulturës dhe turizmit kulturor.

6. Përcaktimi i industrisë kulturore dhe krijuese në Shqipëri

Industria kulturore dhe krijuese sipas UNESCO-s përcaktohet si veprimtari ‘me qëllim kryesor prodhimin ose riprodhimin, promovimin, shpërndarjen dhe/ose komercializimin e produkteve, shërbimeve dhe aktiviteteve të natyrës kulturore, artistike dhe të trashëgimisë kulturore. Bazuar në gjetjet e raportit “Kohët kulturore”,²⁸ ku janë analizuar 11 sektorë²⁹ në 5 rajone³⁰ botërore, rezulton që në vitin 2015 industritë kulturore dhe krijuese kanë krijuar të ardhura prej 2.250 miliardë dollarë dhe kanë hapur 29,5 milionë vende pune në botë. Raportohet se industria kulturore dhe krijuese është nxitësi kryesor për zhvillim ekonomik të vendeve të zhvilluara dhe të atyre në zhvillim, si dhe konsiderohen sektorë me rritjen më të madhe në tërë botën.

Për zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë kulturore dhe krijuese kërkohet formalizimi dhe stimulimi i rritjes së tregut të punës përmes planifikimit ndërinstitutional për vlerësimin e nevojave dhe kërkesave. Operatorët privatë në vend që ofrojnë produkte dhe shërbime, të cilat hyjnë në sferën e industrive kulturore dhe krijuese, janë të ekspozuar ndaj konkurrencës ndërkombëtare (modë, dizajn, zeje, muzikë, audiovizuale, film, botime) për sa kohë që tregu vendor është i kufizuar me një infrastrukturë jo të zhvilluar, e që kufizon investimet në art dhe prodhime kulturore. Nga ana tjetër në mungesë të përcaktimit formal të aktivitetit dhe profesioneve të këtij sektori, vështirësohet matja e madhësisë së

²⁸ Cultural times The first global map of cultural and creative industries (<https://en.unesco.org/creativity/sites/creativity/files/cultural-times-the-first-global-map-of-cultural-and-creative-industries.pdf>)

²⁹ 1. Arkitekturë, 2. Marketing (Reklamë), 3. Botim, 4. Video lojëra, 5. Muzikë, 6. Kinematografi, 7. Gazeta dhe magazina, 8. Arti skenik, 9. Radio, 10. TV dhe 11. Arti vizual

³⁰ Evropa, Azia – Paqësori, Afrika dhe Lindja e Mesme, Amerika Latine dhe Karaibet, si dhe Amerika Veriore



sektorit, efekti “spillover”³¹ në sektorë të tjerë, ndikimi në PBB, si dhe numri i vendeve të punës që ky sektor krijon. Kjo pamundëson artikullimin e nevojave dhe kërkesave të sektorit për ballafaqim me problematikat që has industria, ngritje kapacitetesh, mbështetje financiare për mirëfunksionim dhe konkurrim në tregun vendas dhe ndërkombëtar.

Pozicionimi i shtetit për nxitjen e zhvillimit të industrisë kulturore dhe krijuese, që buron kryesisht nga edukimi dhe praktikat kulturore artistike, fillon nga identifikimi dhe përcaktimi i të tyre në terma ligjorë. Hartimi i një strategjie për zhvillim të vazhdueshëm të industrisë është sfida e radhës që duhet të trajtohet përmes bashkëpunimit të ngushtë mes aktorëve të rëndësishëm për orientim të politikave kulturore dhe reformave ligjore për stimulim dhe lehtësim financiar, ndërlidhur fort me teknologjinë digjitale, duke synuar drejt ndërtimit të kapaciteteve për prodhim dhe shpërndarje të shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese.

7. Sistemi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës statistikor

Ndikimi i kulturës në ekonomi, jetën kulturore dhe sociale, edukim si dhe njohjen e Shqipërisë, midis tjerash duhet të jetë matësi kryesor i reformave ligjore, i rezultateve të projekteve, produkteve dhe shërbimeve kulturore që ndërmerr Ministria e Kulturës dhe çdo institucion tjetër publik dhe privat.

Ndikimi i kulturës lidhet me numrin e personave të punësuar në sektorin e kulturës, numrin e bizneseve me fushë veprimtarie që lidhet me sektorin e kulturës (të krijuara apo të mbështetura), të ardhurat nga sektori dhe ndikimi direkt apo indirekt i tyre në fushën e kulturës dhe PBB-së, pjesëmarrja e qytetarëve në projekte të kulturës, ndikimi i vizitave në site të trashëgimisë dhe institucione kulturore, si dhe shpenzimet familjare për kulturën përveç të tjerash. Të dhënat ekzistuese statistikore të publikuara zyrtarisht nga INSTAT-i mbështeten vetëm te të dhënat e institucioneve të varësisë të Ministrisë së Kulturës, por mungojnë të dhënat e institucioneve kulturore

të nivelit vendor. Gjithashtu, këto publikime nuk përfshijnë të dhënat për industrinë kulturore (botuesit, muzikantët dhe audiovizive) dhe krijuese (videolojërat, dizajni, moda, arkitektura etj.)³² e kontributin e tyre në ekonomi dhe punësim.

Në funksion të kësaj sfide është përmirësimi i sistemit statistikor duke zgjeruar indikatorët e kulturës bazuar në të dhënat nga fushat që kanë lidhje direkte apo indirekte me sektorin, në nivelin qendror dhe vendor, drejt krijimit të një sistemi të qëndrueshëm statistikor, mbështetur nga kërkimet dhe platformat për regjistrimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave. Ngritja e këtij sistemi do të bëjë të mundur matjen e ndikimit të sektorit të kulturës në PBB.

8. Teknologjia digjitale në produktet dhe shërbimet kulturore

Bazuar në raportin e progresit të BE-së për Shqipërinë³³, depërtimi i linjës fikse të internetit është i ulët me afërsisht 30% të familjeve të lidhura, ndërsa depërtimi i internetit mobil prek rreth 80% të qytetarëve. Kjo shifër tregon se pavarësisht qasjes tepër të lartë të popullsisë për teknologjinë mobile, produktet apo shërbimet kulturore që ofrohen nëpërmjet kësaj teknologjie janë të ulëta.

Përdorimi i teknologjisë bashkëkohore për produkte dhe shërbime kulturore me qëllim promovimin e pasurive kulturore, monumenteve të kulturës, fondeve muzeore, si dhe për të zgjidhur problematikat të ndryshme të fushës është ende në nivel të ulët me praktika sporadike. Ekziston potencial i madh për bashkëpunimit midis ministrive të linjës dhe njërive vendore si dhe operatorëve të pavarur për të prodhuar dhe promovuar produkte dhe oferta të përbashkëta kulturore dhe artistike, por sfida qëndron te bashkëveprimi efikas dhe shmangia e mbivendosjes së produkteve dhe shërbimeve.

3. Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019–2025

Dokumenti strategjik ka si synim vazhdimësinë e investimeve në zhvillimin, mbrojtjen dhe

³¹ Procesi në të cilin industritë kulturore dhe krijuese kanë ndikim më të gjerë të vazhdueshëm në një vend, shoqëri ose ekonomi përmes shpërndarjes së koncepteve, ideve, aftësive, njohurive dhe llojeve të ndryshme të kapitalit (<https://ccspillovers.weebly.com/spillovers.html>)

³² <https://rm.coe.int/a-cultural-strategy-for-albania-implanting-the-cultural-bug/1680794665>

³³ EC Communication on Albania. Albania report 2018 – Communication from the European Commission in April 2018 SWD (2018) 151 Final (<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>).



promovimin e artit dhe trashëgimisë kulturore, duke punuar përveç tjerash edhe në fuqizimin e industrisë krijuese si trend bashkëkohor i zhvillimit përmes kombinimit të aftësive krijuese, biznesit dhe aplikimit të teknologjisë, me qëllim krijimin e tregjeve të reja konkurruese me industrinë botërore.

3.1 Vizioni dhe misioni

Vizioni – Artet dhe trashëgimia kulturore e Shqipërisë, si forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Misioni – Krijimi i mjedisit të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese në sektorin publik dhe privat.

3.2 Treguesit e ndikimit dhe treguesit e rezultatit

Realizimi i objektivave dhe masave të planifikuara për pesë qëllimet politike do të kenë efekt në zhvillimin e sektorin të ilustruar përmes indikatorëve si në vijim:

Output 1. Raporti investimeve kundrejt buxhetit të Ministrisë së Kulturës.

Në vitin 2018 përqindja e investimeve kundrejt buxhetit të Ministrisë së Kulturës është 37,7 %, ndërsa në vitin 2025 do të jetë 24,6%³⁴.

Output 2. Kuadri institucional i politikave.

Vlera bazë për vitin 2018 është 0,4 ndërsa synimi për vitin 2025 0,76³⁵.

Output 3. Pasuritë kulturore të regjistruara.

Rritja e numrit të objekteve të trashëgimisë të regjistruara në regjistrin kombëtarë të pasurive kulturore nga 285688 pasuri kulturore të regjistruara në vitin 2018, në 600000 pasuri kulturore të regjistruara deri në vitin 2025.

Output 4. Të ardhurat e realizuara nga institucionet e kulturës.

Rritja e të ardhurave të institucioneve të kulturës nga 240,7 milionë, më 2018 në 338,0 milionë lekë më 2025.

Pjesa II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

Për realizimin e vizionit dhe misionit të paraqitur në këtë dokument strategjik, Ministria e

Kulturës ka përcaktuar qëllimin strategjikë ‘Më shumë vëmendje për artin dhe kulturën’, që ndërlidhet fort me objektivat specifike dhe masat e planifikuara për jetësimin e tyre. Janë identifikuar pesë qëllime politike, të cilat, përmes aplikimit të objektivave specifike synojnë përmbushjen e qëllimeve strategjike, si vijon:

4. Qëllimi i politikës 1: Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit, nga i cili do përfitojnë krijuesit, krijimtaria artistike dhe kulturore dhe trashëgimia kulturore

4.1. Objektiv i specifik 1: Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës

Për zhvillimin e sektorit të kulturës është i domosdoshëm krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional, i orientuar drejt reformimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator mbështetës. Ky objektiv fokusohet në hartimin e politikave për zhvillimin e fushës së artit, njohjen dhe funksionalizimin e industrisë krijuese, fuqizimin e tregut të artit dhe kulturës, reformimin e politikave për kinematografinë, si dhe përditësimeve të kuadrit ligjor të fushës me *Acquis*³⁶ të BE-së sipas PKIE³⁷-së.

Masat e planifikuara për reformim ligjor:

- Hartimi dhe miratimi i ligjit për pensionet e profesioneve të vështira, i cili trajton kërkesat e vazhdueshme të institucioneve dhe të artistëve për uljen e moshës së pensionit për disa kategori të punonjësve, në fusha të ndryshme të artit³⁸.

- Reformimi i ligjit të artit dhe kulturës me qëllim përfshirjen e kapitujve të rëndësishëm si stimujt financiar për aktivitetet kulturore, përjashtimin e të gjitha institucioneve, që kryejnë aktivitetet kulturore nga prokurimi publik për aktivitete kulturore, rregullimi i punës për qendrat e ankandeve të veprave të artit dhe procedurat e licencimit, rregullimi i funksionimit të fondacioneve

³⁶Acquis është organi i të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta që janë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

³⁷ Plani Kombëtar për Integrim Evropian - PKIE

1. ³⁸1. Artistë të baletit; 2. Akrobatë dhe gjimnastë të cirkut; 3. Solistë të operas, teatrove muzikale dhe të ansambleve shtetërore; 4. Muzikantë të veglave të frymës të orkestrave dhe të bandave shtetërore; 5. Artistët e valleve të ansambleve shtetërore dhe koristët e operas, të teatrove muzikore dhe të ansambleve shtetërore.

³⁴Buxheti deri në vitin 2022 është llogaritur sipas PBA-së, ndërsa për vitet 2023-2025 është me një trend rritjeje prej 5 %.

³⁵Indikatori merr vlerën në segmentin [0,1], ku 1 është rezultati optimal. Indikatori mbështetet tek Indiktorët e UNESCO-së për kulturën. CDIS.



kulturore në fushën e artit, njohjen e industrive kulturore dhe krijuese, licencimin e galerive të artit dhe vlerësuesit e artit, si dhe themelimin e Qendrës për hulumtime industrisë kulturore dhe kreative.

- Reformimi i ligjit për kinematografinë me qëllim, midis të tjerash, përfshirjen e stimuljeve për sektorin kinematografik për bashkëprodhim me kompani të huaja, me fokus në fuqizimin e sektorit në vend.

- Reformimi i ligjit për të drejtën e autorit dhe të tjera të ndërlidhura me to, me qëllim përditësimi sipas kuadrit ligjor, bazuar kërkesave të *Acquis*-ve, por dhe zgjidhjen e problematikave të shfaqura gjatë implementimit të ligjit aktual.

- Hartimi i akteve nënligjore për kuadrin rregullator, sipas prioriteteve me fokus të veçantë për ligjin “Për trashëgimi kulturore dhe muzetë” dhe aderimi në konventa ndërkombëtare që do të mundësojnë përveç të tjerash funksionalizimin e kuadrit rregullator në përgjithësi dhe fuqizimin e elementeve të specifike të përcaktuar me ligj, për menaxhimin e qëndrueshëm të pasurive kulturore kombëtare, në veçanti.

- Realizimi i fushatave për ndërgjegjësim dhe informim të grupeve të ndryshme të interesit dhe grup-moshave të ndryshme, me anë të cilave synohet komunikimi i drejtpërdrejt për njohje dhe zbatim të ligjeve në fushën e kulturës.

- Masat për përmirësimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe strategjik:

- Bashkëpunimi i drejtpërdrejtë mes institucioneve të nivelit qendror, vendor dhe të varësisë për hartimin e planeve të veprimit si ekstrakte të dokumentit SKK 2019–2025 për zbatim sipas specifikave përkatëse. Në planet e veprimit do të parashtrohet qartë angazhimi i të gjithë aktorëve, që kanë në fushë veprimtarie direkt apo indirekt sektorin e artit dhe kulturës, për organizimin dhe mirëfunksionimin e fushës së kulturës në nivele të ndryshme përkritazi me turizmin kulturor, industrinë krijuese, digjitalizimin dhe promovimin të artit dhe kulturës, përmirësimi të sistemit statistikor si dhe punësimit të fushën e kulturës.

- Hartimi i planeve të menaxhimit të pasurive kulturore, sipas specifikave të institucionit, që mbulojnë të përcaktuara në nenin 46 të ligjit nr. 27/2018³⁹ për administrim në mënyrë direkte dhe

indirekte, si risi që sjell Ligji i ri për Trashëgiminë Kulturore dhe muzetë synon ndryshimin në tërësi të qasjes së shoqërisë ndaj pasurive kulturore. Planet e planifikuara dhe jo vetëm janë për Parkun Arkeologjik Butrint, drafti i të cilit tashmë është hartuar me mbështetjen e partnerëve strategjikë dhe që është hedhur në diskutim publik për përmbajtjen. Ka filluar puna në hartimin e planit të menaxhimit për Qendrat Historike, Berat dhe Gjirokastrë, ndërsa në vijim do të punohet në hartimin e planit të menaxhimit të Parkut Arkeologjik Bylis, Apollonia, Kalaja Shkodër etj.

- Masat për zhvillimin e kapaciteteve në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kanë si qëllim ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe teknike, për t’iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave jo vetëm të zhvillimit të sektorit të kulturës, por edhe të trendeve bashkëkohore të tij:

- Hartimi i moduleve dhe programeve për kualifikim të vazhdueshëm për institucionet e angazhuara në fushën e kulturës dhe fusha të ndërlidhura me të. Ndërtimi i programeve bëhet në bashkëpunim me institucionet vendore dhe të huaja, të specializuara.

- Kualifikime sistematike në fushën e të drejtës së autorit, zbatimi i Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, trajnime për vlerësimin dhe tregtinë e veprave të artit dhe pasurive kulturore, trajnimin e nëpunësve të institucioneve kulturore të varësisë dhe profesionistëve të pavarur, puna e të cilëve lidhet direkt dhe/apo indirekt me sektorin e kulturës.

- Masat për vlerësimin, monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të dokumentit strategjik:

- Bashkëveprimi për zbatimin e aktiviteteve, masave dhe plotësimin e objektivave të përcaktuar dhe të miratuar në këtë dokument,

- Përditësimi i planit të veprimit në vitin 2022 me masat dhe aktivitete të reja, sipas kërkesave dhe nevojave të lindura gjatë zbatimit të strategjisë,

- Raportime të punës së KNZSKK⁴⁰ 2019 – 2025, këshillit strategjik, takimeve me grupe të

a) qendrat historike;

b) zonat dhe parqet arkeologjike;

c) grupin e vlerave të paluajtshme kulturore të rëndësisë kombëtare;

ç) vlerat e vetme të paluajtshme kulturore me rëndësi kombëtare dmth jo për të gjitha monumentet e kulturës

⁴⁰Komiteti Ndërmintor për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën

³⁹ Planet e menaxhimit hartohen për:



interesit, raporteve të vlerësimit, monitorimit dhe koordinimit të zbatimit të dokumentit strategjik, duke synuar rritjen e transparencës në fushëveprimin e kulturës.

Treguesit kryesorë dhe rezultatet e pritshme të objektivit të parë janë: aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara, plane të veprimit dhe plane të menaxhimit të hartuara, staf i trajnuar, programe trajnimi të hartuara, si dhe raportime për zbatimin e dokumentit strategjik.

5. Qëllimi i politikës 2- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore

5.1. Objektivi specifik 2 - Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve të rehabilituara

Me synim ruajtjen dhe mbrojtjen e integruar të tërësisë së vlerave të trashëgimisë kulturore, si dëshmi e vlerave të trashëguara nga e kaluara, si shprehje e identitetit kombëtar dhe si pasuri e traditës kolektive, dokumenti strategjik përcakton paketën e projekteve për restaurimin, ruajtjen dhe konservimin e objekteve- monument kulture, bazuar në programet dhe prioritetet sektoriale dhe qeveritare. Monumentet në risk, kthimi i vlerës së investuar, zhvillimi i zonës administrative, ku ndodhet monumenti, nëpërmjet turizmit, krijimit të bizneseve të reja, punësimit etj., janë disa nga kriteret në bazë të cilave përcaktohen prioritetet e restaurimeve të monumenteve. Pjesë e këtyre kriterëve, janë edhe projektet për rjetëzimin qendrave historike dhe qendrave muze, në pjesët urbane dhe rurale të vendit. Kjo masë përfshinë edhe aktivitetet e planifikuara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023⁴¹, përmes aktiviteteve që përkojnë me turizmin kulturor, rikonstruimin e objekteve karakteristike arkitektonike të kthyer në objekte kulturore dhe struktura akomoduese, përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe sinjalistikës në destinacionet e trashëgimisë kulturore. Masat dhe aktivitetet e planifikuara në këtë objektivë parasheh bashkëpunimin e ngushtë me të gjithë grupet e interesit, për të siguruar zhvillimin e itinerareve historike kulturore⁴², të rrugëve kulturore të Këshillit të Evropës në të cilat Shqipëria bën pjesë, angazhim për pjesëmarrjen në

rrugët tjera kulturore që përshkojnë rajonin ose në iniciativa të tjera rajonale që synojnë krijimin e rrugëve të reja kulturore, candidate për tu miratuar si rrugë kulturore të Këshillit të Evropës.

Dokumenti strategjik përcakton disa mekanizma për krijimin e kushteve për funksionimin e tregut të pasurive kulturore të luajtshme apo të paluajtshme. Inventarizimi, katalogimi, digjitalizimi dhe monitorimi i lëvizjeve të pasurive kulturore të luajtshme apo të paluajtshme do të shërbejnë jo vetëm për regjistrimin dhe digjitalizimin e fondeve të institucioneve publike, por edhe për rregullimin e regjimit të qarkullimit të pasurive kulturore në pronësi private. Me qëllim përmbushjen e standardeve të caktuara të cilësisë, edukimit, sigurisë, ruajtjes dhe mbrojtjes së vlerave kulturore, në përputhje me kuadrin ligjor dokumenti strategjik parasheh licencimin e subjekteve tregtare dhe ekspertëve vlerësues të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme, vlerësimin financiar të fondeve muzeore si dhe akreditimin e institucioneve muzeore kombëtare.

Treguesit kryesorë dhe rezultatet e pritshme të qëllimit të dytë politik janë: objekte të trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit të restauruara dhe mirëmbajtura kundrejt totalit, rritja e qasjes së publikut në muze, numri i monumenteve të kulturës dhe parqeve arkeologjike në funksion të turizmit kulturor, numri i objekteve të regjistruara në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore, numri i muzeve të akredituara, numri i subjekteve tregtare dhe ekspertëve vlerësues të pasurive kulturore të licencuar.

6. Qëllimi i politikës 3- Nxitja dhe përfaqësimi i vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave më të mira

6.1. Objektivi specifik 3– Promovimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore

Ky objektiv përcakton masat dhe aktivitetet specifike për promovimin dhe ndërkombëtarizimin e vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare në vend dhe në botë. Me anë të këtij objektivi synohet rigjallërimi i potencialit të madh, që përbën trashëgimia kulturore jomateriale, e përcjellë brez pas brezi dhe e krijuar në shekuj e në vijimësi dhe u jep atyre ndjenjën e identitetit dhe vazhdimësisë, duke ndihmuar kështu për

⁴¹ sipas VKM-së nr. 413, dt. 19.06.2019

⁴² Rruga e Besimit, Rruga e Kujtesës, Via Egnatia, Via Dinarica, Rruga e Verës dhe Ullirit, Rruga e Perandorëve Romakë dhe Rruga e 'Yjeve të Kuqe.'



promovimin e respektit për diversitetin kulturor dhe të krijimtarisë tradicionale njerëzore.

Masat përfshijnë organizimin e aktiviteteve të përvitshme, ekzistuese dhe të reja, brenda dhe jashtë vendit me synim ruajtjen, promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për potencialet reale që përbën dhe paraqet kjo trashëgimi. Këto masa zbatohen në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Ministrin e Shtetit për Diasporën, Agjencinë Kombëtare të Diasporës⁴³ si dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Me qëllim ndërkombëtarizimin e vlerave të artit, trashëgimisë kulturore do të sigurohet vazhdimësia e pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare, si dhe organizimi i aktiviteteve ndërkombëtare në vend. Këto aktivitete përveç që promovojnë kulturën shqiptare përmes shfrytëzimit të burimeve tjera, kontribuojnë rritjen e të ardhurave ekonomike të bizneseve të vogla dhe të mesme.

Me pjesëmarrje në programet ndërkombëtare për financim synohet thithja e fondeve për projekte kulturore për zbatim nga institucionet kulturore publike dhe operatorët e pavarur.

Për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare në vend do të përcaktohet mbështetja financiare e aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe studimore të kësaj trashëgimie me synim mbrojtjen dhe katalogimin e digjitalizimin për ruajtje të kulturës e identitetit të pakicave kombëtare dhe ndalimin e praktikave, që synojnë asimilimin e kulturës dhe të identitetit të tyre të dallueshëm. Ky aktivitet do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin e Pakicave Kombëtare⁴⁴.

Neni 5 i këtij projektvendimi parashikon shprehimisht “Edukimi përmes kulturës” parashikon dhe krijon kushtet e nevojshme për ruajtjen, promovimin, mbrojtjen, katalogimin e digjitalizimin për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës e të identitetit të personave që u përkasin pakicave

kombëtare si pasuri, vlerë dhe pjesë të trashëgimisë kulturore kombëtare.

Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale, që konsiderohen në risk do të bëhet fillimisht duke krijuar regjistrin e mbartësve të trashëgimisë jomateriale dhe përmes skemave për mbështetje financiare si dhe trajnimeve të krijohen mundësitë për transferimin e njohurive nga artizanët dhe zejtarët e konsoliduar te grupet e ndryshme të interesit. Ky aktivitet do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm mes Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale dhe Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.

Me qëllim përfshirjen e pasurive kombëtare kulturore në listat përfaqësues të trashëgimisë botërore të UNESCO⁴⁵ në bashkëpunim me profesionistët e fushës fillimisht do të hartohet lista e elementeve, me të cilat mund të kandidohet në bazë, të së cilës punohet dosjet nga ekspert të fushës.

Treguesit kryesorë dhe rezultatet e pritshme të qëllimit të tretë politik janë: numri i aktiviteteve të trashëgimisë kulturore jomateriale të organizuara në vend dhe jashtë vendit, numri i hulumtimeve dhe publikimeve për trashëgiminë kulturore të pakicave kombëtare, regjistrin e mbartësve të trashëgimisë jomateriale, numri i trajnimeve me qëllim ruajtjen e artizaneve dhe zejeve në risk, numri i vlerave materiale dhe jomateriale të regjistruara në listat përfaqësuese të UNESCO-së, numri i pjesëmarrjeve në aktivitete ndërkombëtare dhe numri i aktiviteteve ndërkombëtare të organizuara në vend, si dhe numri i projekteve pjesëmarrëse në programet ndërkombëtare të financimit.

7. Qëllimi i politikës 4 - Mbështetje e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike.

7.1. Objektivi specifik 4 – Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, produkteve si dhe cilësisë artistike

Ky objektivi parashikon ngritjen dhe ristrukturimin e institucioneve të reja për artin dhe kulturën, të cilat synojnë të plotësojnë dhe përditësojnë sektorin e kulturës me produkte dhe

⁴³Përqasja me Strategjinë Kombëtare të Diasporës në zbatimin e masave nr. 2, 6, 35, 45 dhe 56, ku Ministria e Kulturës është institucion përgjegjës për zbatim.

⁴⁴ Komiteti për Pakicat Kombëtare është organ përfaqësues i pakicave, sipas rregullimeve në VKM nr. 726, datë 12.12.2018 i cili ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe të promovimit të të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare.

⁴⁵Lista përfaqësuese të UNESCO-s: 1. World Heritage List, 2. The Representative list of the Intangible Cultural Heritage of Humanity, 3. The Register of Best Safeguarding Practices, 4. Memory of the World Register dhe 5.Tentative List of Albania



shërbime të reja. Ngritja e këtyre institucioneve mbështetet jo vetëm në nevojën e krijimit të produkteve dhe shërbimeve bashkëkohore, por edhe te kërkesat e grupeve të ndryshme të interesit.

Një nga këto institucione që synohet të ngritet është Qendra për Hulumtim e Industrisë Kulturore dhe Krijuese, e cila do të plotësojë hendekun e madh, që ekziston në lidhje me hulumtimet në fushën e kulturës dhe të indikatorëve e ndikimit që lidhen me to. Midis të tjerash kjo qendër do të ketë si objektiv të saj organizimin e trajnimeve dhe kërtimeve, thithje fondesh për zbatim projektesh vendore dhe ndërkombëtare, krijimin e një sistemi qendror statistikor për të dhënat e kulturës dhe të industrisë kreative në Shqipëri, grumbullimin dhe publikimin e të dhënave të kulturës nga të gjithë aktorët publik dhe privat, krijimin e platformave promovuese për turizmin kulturor etj.

Hartimi i projekt ideve për ngritjen e institucioneve të artit dhe trashëgimisë, si dhe qendrat e reja kulturore është masa e bazuar në politikat dhe prioritetet e qeverisë për zhvillim. Projektet që do hartohen janë: Biblioteka Kombëtare, Teatri i Kukullave, Qendra Hebraike dhe projekti për ri jetësimin e Burgut të Spaçit në një qendër të kulturës.

Politikat e reformimit infrastrukturor të institucioneve të kulturës përmes investimit në godina të reja bashkëkohore, si dhe modernizimi cilësor dhe teknologjik i godinave ekzistuese kanë për qëllim jo vetëm rritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve që ofrojnë institucionet e kulturës, por edhe një menaxhim me të mirë të tyre nëpërmjet rritjes së të ardhurave. Me synim vazhdimësinë e trendit pozitiv në rritjen e cilësisë së produktit kulturor dhe arkëtimeve financiare do të hartohen dhe zbatohen paketa të ndryshme të shërbimeve dhe produkteve kulturore.

Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të kulturës synohet përmes mbështetjes së krijuesve dhe veprimtarive kulturore dhe artistike me anë të programeve stimuluese, instrumenteve lehtësuese, financimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta⁴⁶. Rikonceptimi i skemës së financimit të projekteve me thirrje synon rritjen e cilësisë së produkteve dhe

shërbimeve kulturore, të ofruara nga operatorët e pavarur për tregun vendor dhe ndërkombëtar, rritjen e numrit të krijuesve pjesëmarrës në projekte, por edhe një shpërndarje gjeografike në të gjithë vendin të projekteve.

Aplikimi i teknologjisë digjitale për rritjen e cilësisë së shërbimeve, produkteve si dhe promovimin e artit dhe trashëgimisë kulturore zbaton politikat e qeverisë për digjitalizimin e shërbimeve dhe qasjes së qytetarëve ndaj institucioneve kulturore. Kryerja e shërbimeve nëpërmjet platformave online, digjitalizimi i fondeve të institucioneve, platformat promovuese etj. janë disa nga fushat, ku aplikimi i teknologjisë do të sjellë rritje të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve.

Përmes vlerësimit të nevojave për shërbime të punësimit dhe formimit profesional në fushën e industrisë kreative, së bashku me AKPA⁴⁷ do të hartohet dhe zbatohet plani i detajuar për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të individëve, operatorëve të pavarur kulturorë dhe të industrisë kreative për veprimtari në tregun e punës.

Treguesit kryesor dhe rezultatet e pritshme të qëllimit të katërt politik janë: krijimi i institucioneve të reja, rikonstruksioni i godinave, rritja e kapacitetit krijues dhe konkurrues të produkteve kulturore brenda dhe jashtë vendit, numri i aktiviteteve të artit dhe trashëgimisë kulturore në përgjithësi dhe aktiviteteve për promovimin dhe mbrojtjen e traditave, kulturës dhe identitetit kulturor të pakicave kombëtare në veçanti, rritja e të punësuarve në sektorin e kulturës dhe bashkëveprimit me sektorët tjerë⁴⁸, si dhe digjitalizimi i shërbimeve dhe produkteve kulturore.

8. Qëllimi i politikës 5 - Hartimi dhe zbatimi i një platforme arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit parauniversitar.

8.1. Objektivi specifik 5 – Edukimi përmes kulturës

Programi Edukimi Përmes Kulturës i zbatuar nga institucionet kulturore të varësisë në bashkëpunim të ngushtë me institucionet arsimore ka rezultuar të jetë mjaft i suksesshëm në nxitjen e nxënësve të sistemit parauniversitar për përfshirje në aktivitete edukuese në institucione kulturore dhe jashtë tyre. Programi synon që institucionet

⁴⁶ Anëtarësime në rrjete kulturore ndërkombëtare për të mundësuar qasjen e operatorëve të pavarur dhe institucioneve në mjete financiare për projekte të artit, kulturës dhe industrisë kreative.

⁴⁷ Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit

⁴⁸ Ekonomisë, turizmit, arsimit, etj.



arsimore dhe kulturore të ndihmojnë brezin e ri që të zhvillojë vetëbesimin, si individë dhe anëtarë të grupeve të ndryshme brenda shoqërisë; të inkurajoj ata për të zhvilluar një gamë të gjerë të aftësive dhe interesave të tyre; të identifikoj dhe nxis potencialin e tyre si dhe të zhvilloj kreativitetin e tyre. Ai gjithashtu synon njohjen e vlerave të trashëgimisë materiale dhe jomateriale të vendit nëpërmjet projekteve të ndryshme brenda programit.

Problematika e identifikuar gjatë zbatimit disavjeçar të programit është përqendrimi i aktiviteteve kryesisht në zonat urbane të vendit, e veçanërisht në qytetin e Tiranës, ku gjenden numri më i madh i institucioneve kulturore të varësisë.

Përmes këtij objekti synohet shtrirja e programit të edukimit në tërë vendin duke filluar nga projektet e ekzistuese të suksesshme, të cilat në bashkëpunim me nivelin vendor dhe institucionet e tyre të varësisë mund të realizohen në qytetet e tjera, por gjithashtu theksi do të vihet në hartimin e projekteve të reja sipas specifikave të identifikuara.

Programi i edukimit do të zgjerohet edhe tek operatorët e pavarur përmes projekteve me thirrje me qëllim pjesëmarrjen e gjerë të rinjve në vendet ku institucionet kulturore vendore dhe qendrore e kanë të vështirë të shtrijnë veprimtarinë e tyre.

Integrimi i personave me aftësi të kufizuara dhe pakicave kombëtare përmes programit Edukimi Përmes Kulturës është një nga masat e ndërmarra që do të zbatohet jo vetëm përmes projekteve ekzistuese, por edhe nëpërmjet projekteve të hartuara enkas për qasjen sipas nevojave të komuniteteve. Në përmbajtje programi parashikon dhe krijon kushtet e nevojshme për ruajtjen, promovimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e kulturës e të identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare si pasuri, vlerë dhe pjesë të trashëgimisë kulturore kombëtare.

Përgatitja dhe publikimi i raporteve të monitorimit dhe vlerësimit do të ndikojë në vazhdimësi në përmirësimin dhe përditësimin e projekteve të programit të edukimit duke iu përshtatur kushteve në terren, si dhe rrethanave në të cilat zhvillohen.

Treguesit kryesor dhe rezultatet e pritshme të qëllimit të pestë politik janë: rritja e numrit projekteve të edukimit në kuadër të institucioneve kulturore në nivelin vendor dhe qendror, shtrirja më e mirë gjeografike e programit në territor, rritja e numrit të pjesëmarrësve në programet e edukimit dhe kryerja e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit në kuadër të programit.

Pjesa III: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025 ka për qëllim përqendrimin e vëmendjes qeverisë tek arti dhe kultura, përmes transformimit të sektorit në industri kulturore dhe krijuese për të luajtur rol me rëndësi në zhvillimin ekonomik dhe social. Përmes politikave kulturore, ndërsektoriale dhe veprimeve të drejtpërdrejta në ngritjen e kapaciteteve njerëzore të sektorit do të synohet krijimi i kushteve të favorshme për rritjen e stimuljeve për sektorin kulturor dhe kreativ, si dhe inkurajimi i investimeve private në art, kulturë, trashëgimi kulturore dhe industri kreative.

Parashikimet e PBA 2020–2022 për programin e kulturës janë të paraqitura në tabelën 7. Për të arritur maksimumin e planifikimit strategjik do të jepet përparësi objektivave dhe politikave që kanë si rezultat pavarësinë dhe fuqizimin e sektorit të kulturës (operatorët e pavarur dhe bizneset private) nga buxheti shtetëror, si dhe gjenerimin e të ardhurave nga institucionet kulturore që ndikojnë në qëndrueshmërinë institucionale dhe rrisin buxhetin e ministrisë.

Viti	Shuma	Si % e totalit	Si % e PBB
2020	2,015,000,000	34,6%	0,12%
2021	2,025,000,000	32%	0,11%
2022	2,026,500,000	33.4%	0,11%
TOTAL	6,066,500,000		

Tabela 7- Parashikimet e PBA 2020–2022



Për realizimin e masave dhe objektivave të paraqitura në këtë dokument përveç buxhetit të Ministrisë së Kulturës janë parashikuar jo vetëm financimet nga buxhetet e institucioneve qendrore dhe vendore, veprimtaria e të cilave ndikon direkt apo indirekt në sektorin e kulturës, por edhe financimet nga Bashkimi Evropian dhe donatorët e ndryshëm. Parashikimet e përmbledhura në tabelën 8. paraqesin periudhën dhe koston e zbatimit të planit të veprimit për periudhën 2019–2025 të ndara sipas objektivave specifike.

OBJEKTIVAT SPECIFIK	Kosto totale	Buxheti	Donatorët	Hendeku
	(lek '000)	(lek '000)	(lek '000)	(lek '000)
TOTALI	9,608,638	6,088,965	3,041,439	478,234
1. Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës	233,199	72,643	70,074	90,482
2. Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve të rehabilituara	4,461,982	1,588,014	2,581,445	292,523
3. Promovimi i vlerave të artit dhe të trashëgimisë kulturore	621,769	318,885	299,885	3,000
4. Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, të produkteve, si dhe të cilësisë artistike	4,244,403	4,062,139	90,035	92,229
5. Ndërtimi i publikut / zhvillimi i audiencës	47,285	47,285		

Tabela 8

Institucionet e paraqitura në tabelën 9 kanë veprimtari dhe buxhete të cilat direkt apo indirekt ndikojnë në sektorin e kulturës.

Institucioni	Programi buxhetor
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	- Mbështetja për zhvillimin ekonomik - Mbështetja për mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturën e cilësinë dhe pronësinë industriale - Arsimi profesional - Tregu i punës
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	- Zhvillimi i turizmit
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	- Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin) - Arsimi i mesëm (i përgjithshëm) - Arsimi universitar
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	- Mbështetja e shqiptarëve jashtë vendit dhe përfshirja e tyre në zhvillimet brenda vendit
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	- Zhvillimi rural
Bashkitë	- Arti, kultura sporti
Agjencia e Kombëtare e Diasporës	- Krijimi i një kuadri të plotë të politikëbërjes për diasporën, krijimi i instrumenteve të dobishëm në ndihmë të qeverisë dhe aktorëve të tjerë për të fuqizuar bashkëpunimin me diasporën dhe migracionin e ligjshëm

Tabela 9. Institucionet me ndikim të drejtpërdrejtë apo indirekt në sektorin e kulturës

Metodologjia e kostimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit

Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e Planit të Veprimit janë llogaritur duke kostuar individualisht çdo aktivitet të pasqyruar te PKV-së. Për llogaritjen fillestare të shpenzimeve për aktivitetet kryesore është vepruar si më poshtë:

- Llogaritja e shpenzimeve për burime njerëzore bazohet në kohën e parashikuar për realizimin e veprimtarive dhe një pagë mesatare ditore të një kategorie të caktuar të nëpunësve civil.

- Llogaritja e shpenzimeve për shërbimet është bërë duke mbajtur parasysh kostot e shërbimeve të institucioneve përkatëse, bazuar në standardet e miratuara.

- Llogaritja e shpenzimeve për aktivitete që lidhen me hartimin dhe rishikimin e legjislacionit, monitorimin dhe funksionimin e strukturave të përhershme etj., është bërë duke mbajtur parasysh shpenzimet e vazhdueshme që parashikohen si: shpenzimet për pagat, kontributet e sigurimeve



shoqërore, shpenzimet për ekspertizë të huaj (kur është parashikuar në plan) dhe mjete konsumi.

- Llogaritja e shpenzimeve për “aktiviteteve specifike” ose i iniciativave specifike të ngjashme u bazua kryesisht në natyrën e aktiviteteve dhe kostot që ofron tregu për shërbime të tilla.

- Llogaritja e shpenzimeve për trajnime është bazuar kosto e trajnimit për një person. Si kosto për njësi janë përdorur kostot e ASPA-së dhe/ose kostot e aplikuara për trajnime të ngjashme në të shkuarën.

Për atë pjesë të aktiviteteve ku informacioni nuk është i plotë është ndjekur metoda e vlerësimit për analogji, d.m.th. janë marrë në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete ose produkte të ngjashme në PBA.

Zbatimi dhe monitorimi

Struktura koordinuese për zbatimin e Strategjisë përputhet me qasjen sektoriale të integruar për funksionimin e mekanizmit të Menaxhimit të Integruar të politikave për Mirëqeverisjen dhe sistemin e planifikimit të integruar. Zbatimi i qasjes sektoriale të integruar funksionin në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), i cili përbën sistemin kryesor që përcakton mjetet, rregullat dhe mekanizmat për një planifikim të integruar të politikave, duke siguruar një shpërndarje eficient dhe efektiv të burimeve financiare. Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave për Konkurrueshmërinë dhe Investimet drejton në përputhje me qasjen sistematike, zhvillimin, implementimin dhe monitorimin e reformave sektoriale në këtë sektor si me qëllim koordinimin midis politikave të sektorëve në përputhje me planifikimin strategjik të integruar dhe parimet e mirëqeverisjes.

1. Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) Grupi Tematik për Kulturën & Turizmin⁴⁹, do të jetë struktura raportuese, monitoruese dhe vlerësuese për dokumentin strategjik.

2. Drejtoria Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës përmes drejtorive përkatëse dhe institucioneve kulturore të varësisë do të ketë për detyrë ndërmarrjen e aktiviteteve të nevojshme për zbatimin e planit të veprimit dhe realizimin e

masave të parashikuara në dokumentin strategjik, si dhe raportimin periodik të zbatimit.

Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit dhe pjesëtarëve të sektorit të kulturës në procesin e zbatimit të dokumentit strategjik do të sigurohet përmes takimeve të rregullta me operatorë të pavarur, përfaqësues të shoqërisë civile vendase, universitete, njësi të qeverisjes vendore, si dhe komunitete lokale.

Meqenëse Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019–2025 mbulon një periudhë shtatëvjeçare, dokumenti strategjik do të jetë subjekt i rishqyrtimit çdo tre vjet, në varësi të qëllimeve të përcaktuara dhe nivelit të realizimit të masave të parashikuara. Procesi i përtëritjes së dokumentit inicihet nga propozimet dhe vendimet alternative të nxjerra në konsultim me KNZSKK, dhe grupet tjera të interesit.

Plani i veprimit, i hartuar për një periudhë shtatëvjeçare, përmban qëllimet e politikës, objektivat specifike përkatëse, masat dhe rezultatet për çdo objektiv të cilat shoqërohen me referencën me programin buxhetor, institucionet përgjegjëse për zbatim, afatet e zbatimit si dhe buxhetin përkatës.

Çdo gjashtë muaj do të përpilohen raportet për vlerësimin e nivelit të zbatimit të dokumentit strategjik, me informacione për indikatorët e përcaktuar, arritjet, problematikat, rreziqet dhe elementet tjera me rëndësi për procesin e zhvillimit të sektorit të kulturës. Bazuar në këto raporte do të rishikohet dhe përditësohet plani ekzistues për vitet në vijim, në frekuencë trevjeçare.

Rolin e sekretarisë për Komitetin Ndërmnistror e ka Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor. KNZSKK-ja mblidhet çdo dy muaj për të raportuar dhe njoftuar mbi nivelin e zbatimit të masave.

⁴⁹ si mekanizmi i miratuar me urdhër të Kryeministrit nr. 157, datë 22.11.2018 për qasje sektoriale të integruar.



Pjesa IV: PLANI I VEPRIMIT

PLANI I VEPRIMIT NE ZBATIM TE DOKUMENTIT STRATEGJIK 2019-2025										
I. QELLIMI STRATEGJIK: Më shumë vëmendje për artin dhe kulturën										
II. Qëllimi i Politikës: Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit nga i cili do të përfitojnë krijuesit, krijimtaria artistike dhe kulturore dhe trashëgimia kulturore										
III. PROGRAMI BUXHETOR QË KONTRIBUON PËR QELLIMIN E POLITIKËS: 'Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi', 'Arti dhe Kultura' dhe 'Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë'										
Nr.	OBJEKTIVI SPECIFIK 1 Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës	Referenca e Rezultatit me produktet e programit buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikativë (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit		Hendeku financiar
			Drejtues	Mbështetës	Afati Fillimit	Afati mbarimit		Buxhet Shteti	Financim i huaj	
1.1.	Konsolidimi i reformimit të kuadrit rregullator mbështetës						73 480	15 736	4 612	53 132
1.1.1.	Paketa e legjislacionit primar/ligjeve e finalizuar (reforma e ligjeve në fuqi/ligje të reja)	91201AA - Aktet ligjore të miratuara / PMA	MK Institucionet e varësisë	MFE/MD/QKK	II 2019	IV 2023	58 019	9 499		48 520
1.1.2.	Paketa e legjislacionit dytësor/e finalizuar (akte nënligjore)	91201AA - Aktet ligjore të miratuara / PMA	MK Institucionet e varësisë	MFE / MD/ MEPJ	I 2019	IV 2023	11 961	2 737	4 612	4612
1.1.3.	Fushata informuese/ndërgjegjësimi për paketën ligjore	91201AA - Aktet ligjore të miratuara / PMA	MK Institucionet e varësisë		IV 2019	IV 2025	3 500	3 500		
1.2.	Mekanizmat për zbatimin e kuadrit ligjor dhe strategjik të përmirësuar						70 274	41 609	18 900	9 765
1.2.1.	Planet e veprimit për zbatimin e strategjisë nga institucionet kulturore të varësisë të hartuara / të aprovuara	91201AA / 91203AA / 91203AB / 91203AC / 91203AD / 91203AE / 91203AK / 91202AB	MK Institucionet e varësisë		II 2020	I 2021	15 070	15 070		
1.2.2.	Planet e veprimit për zbatimin e strategjisë nga niveli vendor të hartuara / të aprovuara	91201AA - Aktet ligjore të miratuara / PMA	MK Institucionet e varësisë	Bashkitë / Ministrinë e linjës	III 2020	IV 2021	5 828	5 828		
1.2.3.	Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë në fushën e turizmit kulturor i hartuar / i aprovuara	91201AA - Aktet ligjore të miratuara / 91202AA	MK Institucionet e varësisë	MTM / MFE / MIE / MBZHR	II 2020	IV 2021	3 237	3 237		
1.2.4.	Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë në njohjen dhe funksionalizimin e industrisë krijuese i hartuar / i aprovuara	91201AA - Aktet ligjore të miratuara / PMA	MK Institucionet e varësisë	MFE / Drejtoria e Tatimeve	II 2021	IV 2021	7 767	1 702		6 065
1.2.5.	Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë përmes digjitalizimit të shërbimeve dhe produkteve i hartuar / i aprovuara	Aktet ligjore të miratuara / PMA / 91203AI	MK Institucionet e varësisë	AKSHI	II 2020	I 2025	5 994	5 994		
1.2.6.	Plani i veprimit për përcaktimin e burimeve dhe të dhënave statistikore për sektorin e kulturës	Plane të veprimit PMA, AK dhe TK	MK Institucionet e varësisë	INSTAT	I 2020	IV 2020	5 236	1 563		3 700



1.2.7.	Plani i menaxhimit të pasurisë kulturore i hartuara/aprovuara	Plane të veprimit PMA, AK dhe TK	MK Institucionet e varësisë	MTM / MFE / MBZHR / Bashkitë	II 2019	IV 2023	27 115	8 215	18 900	
1.3.	Zhvillimi i kapaciteteve në fushën e kulturës dhe trashëgimisë						75 519	1 372	46 562	27 585
1.3.1.	Paketa e trajnimeve profesionale e finalizuar	Stafi i trajnuar PMA, AK dhe TK	MK	ASPA /	II 2019	IV 2025	16 253		16 253	
1.3.2.	Programet e kualifikimit të vazhdueshëm në fushën e të drejtës së autorit të konsoliduar/aprovuara	Programe të hartuara PMA, AK dhe TK	MK / DDA	Shkolla e Magjistraturës / MD	I 2019	IV 2025	12 005			12 005
1.3.3.	Programet e kualifikimit të vazhdueshëm të gjyqësorit për aspektet kulturore të konsoliduar/aprovuara	Programe të hartuara PMA, AK dhe TK	MK Institucionet e varësisë	Shkolla e Magjistraturës / MD	I 2020	IV 2025	3 720			3 720
1.3.4.	Programet e kualifikimit të vazhdueshëm të ekspertëve për vlerësimin e veprave të artit dhe pasurive kulturore të konsoliduar/aprovuara	Programe të hartuara PMA, AK dhe TK	MK Institucionet e varësisë	MFE	I 2021	IV 2023	5 960			5 960
1.3.5.	Programet e kualifikimit të vazhdueshëm për tregtimin e pasurive kulturore dhe veprave të artit të konsoliduar/aprovuara	Programe të hartuara PMA, AK dhe TK	MK Institucionet e varësisë	MFE	I 2021	IV 2023	5 900			5 900
1.3.6.	Programet e kualifikimit të vazhdueshëm tekniko administrative për monitorimin e qarkullimit të pasurisë kulturore të zhvilluara	Trashëgimia materiale dhe jomateriale e inventarizuar / TK	QKIPK	DOGANÄ / POLICIA/ MFE / MD	IV 2019	IV 2021	30 309		30 309	
1.3.7.	Paketa e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione vendore dhe të huaja në fushën e kulturës finalizuar/nënshkruara	Marrëveshje të nënshkruara PMA, AK dhe TK	MK Institucionet e varësisë	UA/ MFE /etj.	II 2019	IV 2025	1 372	1 372		
1.4.	Vlerësimi, monitorimi dhe koordinimi i zbatimit të dokumentit strategjik						13 926	13 926		
1.4.1.	Raporte të vlerësimit, monitorimit dhe koordinimit të zbatimit të strategjisë të aprovuara	PMA	MK	Ministritë e linjës/ institucione varësie	IV 2020	IV 2025	4 368	4 368		
1.4.2.	Takime diskutimi me grupe të interesit për zbatimin e strategjisë	PMA	MK	Ministritë e linjës / institucione varësie	IV 2019	III 2025	6 500	6 500		
1.4.3.	Plani i veprimit i dokumentit strategjik sipas periudhës së përcaktuar i rishikuar	PMA	MK	Ministritë e linjës / institucione varësie	II 2021	IV 2021	1 292	1 292		
1.4.4.	Raporti përfundimtar për zbatimin e strategjisë kombëtare për kulturën i dorëzuar	PMA	MK	Ministritë e linjës / institucione varësie	III 2025	IV 2025	1 766	1 766		



II. Qëllimi i Politikës: Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore										
III. PROGRAMI BUXHETOR 1 QE KONTRIBUON PER QELLIMIN E POLITIKES: Programi Buxhetor i MK-së "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë"										
Nr.	OBJEKTIVI SPECIFIK Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve të rehabilituara	Referenca e Rezultatit me produktet e programit buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikativë (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit		Hendeku financiar
			Drejtues	Mbështetës	Afati Fillimit	Afati Mbarimit		Buxhet Shteti	Financim i Huaj	
2.1.	Mekanizmat për rehabilitim të trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit të konsoliduar						4 461 982	1 588 014	2 581 445	292523
2.1.1.	Paketa e projekteve restauruese bazuar në programet dhe prioritetet të hartuara / të miratuara	Objekte monument kulture të ruajtura dhe të mbrojtura / TK	IMK / DRKK-të / MK	MFE / MIE / MTM	II 2019	IV 2025	1 910 130	1 172 024	738 106	
2.1.2.	Paketa e projekteve për ruajtjen konservimin dhe restaurimin e objekteve monument kulture / të zbatuara	Objekte monument kulture të ruajtura dhe të mbrojtura / TK	IMK / DRKK-të / MK	MFE / MIE / MTM	II 2019	IV 2021	853 981	64 380	497 078	292 523
2.1.3.	Paketa e projekteve të rijetëzimit të trashëgimia kulturore / të zbatuara	Objekte monument kulture të ruajtura dhe të mbrojtura / TK	IMK / DRKK-të / MK	MFE / MIE / MTM	II 2019	IV 2021	1 697 871	351 610	1 346 261	
2.2.	Mekanizmat për rregullimin e regjimit të qarkullimi të pasurive kulturore në pronësi publike dhe private të përmirësuara / Mekanizmat për vlerësim e pasurive kulturore dhe akreditimin e muzeve të konsoliduar						13 932	13 932		
2.2.1.	Akreditimi i muzeve zbatuar	Trashëgimia materiale dhe jomateriale e inventarizuar TK	MK	Institucionet vendore / Bashkitë	III 2020	IV 2025	2 526	2 526		
2.2.2.	Ekspert vlerësues të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme të licencuar (të veprave të artit)	Trashëgimia materiale dhe jomateriale e inventarizuar TK	MK		II 2021	IV 2025	2 526	2 526		
2.2.3.	Subjektet tregtare të pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme të licencuara (dhe veprave të artit)	Trashëgimia materiale dhe jomateriale e inventarizuar TK	MK		II 2021	IV 2025	2 526	2 526		
2.2.4.	Raporte për vlerësim financiar lidhur me fondet muzeve të hartuara/aprovuara	Trashëgimia materiale dhe jomateriale e inventarizuar TK	MK		IV 2020	IV 2025	2 526	2 526		
2.2.5.	Raporte të vlerësimit dhe monitorimit të zbatimit të pasurimit të regjistrit të pasurive kulturore	Trashëgimia materiale dhe jomateriale e inventarizuar TK	QKIPK		III 2020	IV 2025	3 828	3 828		



II. Qëllimi i Politikës: Nxitja dhe përfaqësimi i vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave të mira

III. PROGRAMI BUXHETOR 1 QË KONTRIBUON PËR QËLLIMIN E POLITIKES: Programet Buxhetore të MK-së 'Arti dhe Kultura' dhe 'Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë'

Nr.	OBJEKTIVI SPECIFIK Promovimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore	Referenca e Rezultatit me produktet e programit buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikativë (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit		Hendeku financiar
			Drejtues	Mbështetës	Afati Fillimit	Afati Mbarimit		Buxhet Shteti	Financim i Huaj	
3.1.	Promovimi i trashëgimisë jomateriale kulturore						125 813	125 813		
3.1.1.	Krijimi dhe konsolidimi i një pakete aktiviteteve promovuese të përvitshme të trashëgimisë kulturore jomateriale	Aktivitetet të fushës së trashëgimisë TK	MK	MSHD ⁵⁰ AKD ⁵¹ MEPJ	II 2019	IV 2025	110 894	110 894		
3.1.2.	Hartimi dhe publikimi i hulumtimeve me qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare	Aktivitetet të fushës së trashëgimisë TK	MK	KPK ⁵²	II 2020	IV 2022	3 045	3 045		
3.1.3.	Skema e mbështetjeve financiare dhe trajnuese për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore që konsiderohen në risk	Aktivitetet të fushës së trashëgimisë TK	MK	DHKZ ⁵³	I 2020	IV 2025	11 874	11 874		
3.2.	Ndërkombëtarizimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore						495 957	193 072	299 885	3 000
3.2.1.	Kandidimi në listat përfaqësuese të UNESCO-së	vlera të trashëgimisë kulturore të përfaqësuar PMA, AK dhe TK	MK	MEPJ ASHSH ⁵⁴ ASA ⁵⁵	II 2019	IV 2022	8 616	4 616	1 000	3 000
3.2.2.	Paketa e përfaqësimeve shtetërore përmes pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare kulturore	Aktivitetet e fushës së artit dhe kulturës AK dhe TK	MK		II 2019	IV 2025	170 394	170 394		
3.2.3.	Paketa e aktiviteteve ndërkombëtare të organizuara në Shqipëri nga Ministria e Kulturës dhe institucionet kulturore të varësisë	Aktivitetet e fushës së artit dhe kulturës AK dhe TK	MK		II 2019	IV 2025	168 047	18 062	149 985	
3.2.4.	Paketa e pjesëmarrjeve në programe ndërkombëtare financimi me qëllim thithjen e fondeve për projekte kulturore	Aktivitetet e fushës së artit dhe kulturës AK dhe TK	MK		II 2019	IV 2022	148 900		148 900	

⁵⁰Ministri i Shtetit për Diasporën

⁵¹Ajencia Kombëtare e Diasporës

⁵²Komiteti i Pakicave Kombëtare

⁵³Dhoma Kombëtare e Zejtarisë

⁵⁴Akademia e Shkencave e Shqipërisë

⁵⁵Akademia e Studimeve Antropologjike



II. Qëllimi i Politikës: Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike										
III. PROGRAMI BUXHETOR 1 QE KONTRIBUON PER QELLIMIN E POLITIKES: Programet Buxhetore të MK-së 'Arti dhe Kultura' dhe 'Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë'										
Nr.	OBJEKTIVI SPECIFIK 4 Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, produkteve si dhe cilësisë artistike	Referenca e Rezultatit me produktet e programit buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikativë (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit		Hendeku financiar
			Drejtuës	Mbështetës	Afati Fillimit	Afati Mbarimit		Buxhet Shteti	Financim i Huaj	
4.1.	Ngritja dhe rikonceptimi i institucioneve kulturore të varësisë						3 785 055	3 715 172	50 383	19 500
4.1.1.	Analiza ligjore, funksionale dhe ndikimi buxhetor i hartuar/konsoliduar lidhur me riorganizimin e institucioneve të varësisë të artit dhe trashëgimisë kulturore	Institucione të reja të artit dhe Trashëgimisë PMA, AT dhe TK	MK Institucione të varësisë	MFE DAP	II 2019	IV 2022	7 652	7 652		
4.1.2.	Paketa e projekteve për ngritjen e institucioneve të artit dhe trashëgimisë të hartuara / të miratuara	Institucione të reja të artit dhe Trashëgimisë PMA, AT dhe TK	MK Institucione të varësisë				22 020	2 520		19 500
4.1.3.	Institucione të artit dhe trashëgimisë të ri konstruktura	Rikonstruksione ambientesh, godinash AT dhe TK	MK Institucione të varësisë	MFE MIE	II 2019	IV 2025	3 755 383	3 705 000	50 383	
4.2.	Mbështetja e veprimtarive kulturore dhe industrisë kreative përmes programeve stimuluese						339 624	339 624		
4.2.1.	Skema e financimit të projekteve me thirrje e ri konceptuar	Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur / AT dhe TK	MK		I 2019	I 2025	218 099	218 099		
4.2.2.	Instrumente stimuluese, lehtësuese dhe financuese për bashkëpunime ndër sektoriale të krijuara	Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur / AT dhe TK	MK	MFE	I 2019	IV 2025	46 921	46 921		
4.2.3.	Konsolidimi i anëtarësimeve në rrjetet kulturore ndërkombëtare	Anëtarësime At dhe TK	MK	MFE	I 2019	IV 2025	74 604	74 604		
4.3.	Aplikimi i teknologjisë digjitale për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve						100 381		39 652	60 729



4.3.1.	Platforma BILETARIA ONLINE e funksionalizuar	Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur / AT dhe TK	MK Institucionet e varësisë	AKSHI	II 2019	IV 2019	1 330		1 330	
4.3.2.	Fondet e institucioneve kulturore të varësisë të digjitalizuar	Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur / AT dhe TK	MK Institucionet e varësisë	AKSHI	II 2019	IV 2025	17 892		3 792	14 100
4.3.3.	Platformat për promovimin e trashëgimisë kulturore e funksionalizuar	Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur / AT dhe TK	MK Institucionet e varësisë	AKSHI	I 2019	III 2022	21 022		6 530	14 492
4.3.4.	Platformat për mbledhjen e statistikave për garantimin e cilësisë së indikatorëve për përbushjen e standardeve të funksionalizuara	Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur / AT dhe TK	MK Institucionet e varësisë	AKSHI	II 2020	II 2021	5 000			5 000
4.3.5.	Shërbime dhe aplikime të digjitalizuar në art dhe trashëgimi	Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur / AT dhe TK	MK Institucionet e varësisë	AKSHI	I 2020	IV 2023	27 137			27 137
4.3.6.	Platforma për digjitalizimin e trashëgimisë jomateriale	Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur / AT dhe TK	MK Institucionet e varësisë	AKSHI	III 2019	IV 2021	28 000		28 000	
4.4.	Vlerësimi i nevojave për shërbime të punësimit dhe të formimit profesional në fushën e industrisë kreative						19 343	7 343	0	12 000
4.4.1.	Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime punësimi dhe formimi profesional të identifikuar me rekomandime përkatëse	91201AA - Aktet ligjore të miratuara / PMA	MK	MFE / AKPA ⁵⁶	IV 2020	II 2021	2 314	2 314		
4.4.2.	Plani i detajuar për ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional	91201AA - Aktet ligjore të miratuara / PMA	MK	MFE / AKPA	II 2021	IV 2021	1 735	1 735		
4.4.3.	Instrumentet për kontraktimin e aktorëve për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara për formim profesional	91201AA - Aktet ligjore të miratuara / PMA	MK	MFE / AKPA	II 2021	IV 2022	1 560	1 560		
4.4.4.	Trajnimi i kapaciteteve të operatorëve të pavarur kulturore dhe të industrisë kreative për veprimtari në tregun e punës	91201AA - Aktet ligjore të miratuara / PMA	MK	MFE / AKPA	II 2021	IV 2022	12 000			12 000
4.4.5.	Raporte të vlerësimit dhe monitorimit të ngritjes së kapaciteteve dhe punësimit në industrinë kreative	91201AA - Aktet ligjore të miratuara / PMA	MK	MFE / AKPA	IV 2020	IV 2022	1 734	1 734		

⁵⁶ Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim



II. Qëllimi i Politikës: Hartimi dhe zbatimi i një platformë arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit parauniversitar

III. PROGRAMI BUXHETOR 1 QE KONTRIBUON PER QELLIMIN E POLITIKES: Programet Buxhetore të MK-së 'Arti dhe Kultura' dhe 'Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë'

Nr.	OBJEKTIVI SPECIFIK Ndërtimi i publikut / zhvillimi i audiencës	Referenca e produktit buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikativë (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit		Hendeku financiar
			Drejtues	Mbështetës	Afati Fillimit	Afati Mbarimit		Buxhet Shteti	Financim i Huaj	
5.1.	Zgjerimi i programit 'Edukimi Përmes Kulturës' në institucione arsimore në vend		MK	MASR			47 285	47 285		
5.1.1.	Programe të hartuara nga të gjitha institucionet kulturore të varësisë	Projektet e edukimit AT dhe TK	Inst. e varësisë	MASR Institucionet arsimore	III 2019	IV 2022	43 120	43 120		
5.1.2.	Raporte monitorimi/vlerësimit për programet të hartuara/aprovuara	Projektet e edukimit AT dhe TK	MK	MASR Institucionet arsimore	II 2020	I 2023	1165	1165		
5.1.3.	Qasja e personave me aftësi të kufizuar në programin Edukimi Përmes Kulturës e zbatuar	91203AC / 91203AF 91203AG / 91203AH 91203AJ / 91202AC 91202AD	MK	MASR MSHMS Institucionet arsimore	III 2020	IV 2022	3000	3000		
5.1.4.	Qasja e personave pakicave kombëtare në programin Edukimi Përmes Kulturës e zbatuar	91203AC / 91203AF 91203AG / 91203AH 91203AJ / 91202AC 91202AD	MK	MASR Institucionet arsimore KPK	III 2019	IV 2022				



Lista e Indikatorëve / Treguesve të Dokumenteve Strategjikë					
Shënim:					
	1. Për secilin indikator të përbërë nga nënindikatorë të përdoret një fletë pune / 2. Në rastin e indikatorëve të thjeshtë, mund të përdoret një fletë pune, në rreshta të veçantë				
#	META DATA për Indikatorët	Indikator 1	Indikator 2	Indikator 3	Indikator 4
1	Emërtimi i Indikatorit	Raporti investimeve kundrejt buxhetit të Ministrisë së Kulturës	Kuadri institucional i politikave	Rritja e numrit të pasurive kulturore të regjistruara në regjistrin kombëtarë	Rritja e të ardhurave të institucioneve të kulturës
2	Lloji i Indikatorit	Nivel i lartë	Nivel i lartë	Nivel i lartë	Nivel i lartë
3	Emërtimi i Dokumentit	Draft Strategjia për Kulturën 2019 -2025, SKZH	Draft Strategjia për Kulturën 2019 -2025, SKZH	Draft Strategjia për Kulturën 2019 -2025, SKZH	Draft Strategjia për Kulturën 2019 -2025, SKZH
4	Lidhja me SKZHI	6. Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit	6. Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit	6. Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit	6. Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit
5	Qëllimi Strategjik në SKZHI	Më shumë vëmendje për artin dhe kulturën	Më shumë vëmendje për artin dhe kulturën	Më shumë vëmendje për artin dhe kulturën	Më shumë vëmendje për artin dhe kulturën
6	Qëllimi i politikës korresponduese	Q.3. Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike	Q.1. Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit nga i cili do përfitojnë krijuesit, krijimtaria artistike dhe trashëgimia kulturore	Q.2. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore	Q.3. Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike
7	Objektivi Specifik me të cilin lidhet indikatorit/treguesi	O.S.3. Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike	O.S.1. Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës	O.S.2. Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve të rehabilituara	O.S.3. Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike
9	Përkatësia e Indikatorit	Kultura	Kultura	Kultura	Kultura
10	Lidhja me Acquis Communautaire	jo	Raportimi dhe miratimi i akteve të Acquis Communautaire të parashikuara në PKIE për Ministrinë e Kulturës në Kap. 7 "Pronësia Intelektuale" dhe Kap. 26 "Edukimi dhe Kultura."	Raportimi dhe miratimi i akteve të Acquis Communautaire të parashikuara në PKIE për Ministrinë e Kulturës dhe QKIPK për lëvizjen e lirë të pasurive kulture në Kap. 29 "Doganat."	jo



11	Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raportet zyrtare	Raportet zyrtare të planeve analitike	Raportet mujore për pasuritë e regjistruara	Raportet mujore për institucionet e varësisë
12	Institucionet përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave	INSTAT/TATIMET/Burime të huaja	Ministria e Kulturës	Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore	Institucionet e Varësisë
13	Përshkrimi i Metodologjisë	Rritja e Investimeve në sektorin e kulturës sipas fushave në NAÇE REV 2 në raport me vitin bazë	Indikatori llogaritet duke plotësuar tabelën e Standard Setting Frame work sipas CDIS/ UNESCO	Rritja krahasuar me vitin bazë	Rritja krahasuar me vitin bazë
14	Frekuenca e Matjes	Vjetore	Vjetore	Vjetore	Vjetore
15	Natyra e Indikatorit/treguesit: Kumulativ/Rritës	Kumulativ	Kumulativ	Kumulativ	Rritës
16	Input Direkt ose i Përbërë	I përbërë	I përbërë	i thjeshtë	I përbërë
17	Formula e llogaritjes	Buxheti deri në vitin 2022 është sipas PBA ndërsa për vitet 2023-2025 është me një trend rritës prej 5 %	Indikatori merr vlerën në segmentin [0,1], ku 1 është rezultati optimal.	Numri i pasurive kulturore të regjistruara	Rritja e të ardhurave është llogaritur me një trend rritës prej 5 % nga viti në vit.
18	Ndarja e të dhënave (për treguesit e përbërë)	Kontributi në sektorin e kulturës sipas fushave bazuar në ndarjen në NAÇE REV2 / INSTAT	-korniza e politikave -korniza institucionale		Të ardhura nga shitja e biletave Të ardhura nga shërbimet Të ardhura nga donatorët
19	Theksoni drejtimin e ndryshimit / trendit (tendencës) të ecurisë	Rritës	Rritës	Rritës	Rritës
20	Vlerat Bazë	2018 - % e investimeve kundrejt buxhetit të MK-së 37,7 %	2018 - vlera bazë 0,4	2018 – 285,688 pasuri kulturore të regjistruara	2018 - 240,7 milion lekë
21	Vlera e synuar/ Targeti	2025 - 24,6%	Synimi 2025 Vlera 0,76	2025 – 600,000 pasuri kulturore të regjistruara	2025 - 338,0 milion lekë
22	Vlera e synuar/Targeti i rishikuar:				
23	Vlera aktuale baze:				
24	SDG - Titulli i Qëllimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas OKB-së	11. Sustainable Cities and Communities - Make cities inclusive, safe, resilient and sustainable Target 11.4 calls for strengthening efforts to protect and safeguard the world's cultural and natural heritage.	11. Sustainable Cities and Communities - Make cities inclusive, safe, resilient and sustainable Target 11.4 calls for strengthening efforts to protect and safeguard the world's cultural and natural heritage.	11. Sustainable Cities and Communities - Make cities inclusive, safe, resilient and sustainable Target 11.4 calls for strengthening efforts to protect and safeguard the world's cultural and natural heritage.	11. Sustainable Cities and Communities - Make cities inclusive, safe, resilient and sustainable Target 11.4 calls for strengthening efforts to protect and safeguard the world's cultural and natural heritage.
25	Vlera e Synuar e treguesit të SDG				



VENDIM

Nr. 907, datë 24.12.2019

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. ASTRIT
SHUAIP HAFIZI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Astrit Shuaip Hafizi, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 30, datë 30.12.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 17, DATË
3.8.2016 “PËR PROCEDURAT DHE
KRITERET PËR NJOHJEN DHE
NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE,
CERTIFIKATAVE, GRADAVE
SHKENCORE DHE TITUJVE
AKADEMIKË TË LËSHUARA NGA
INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT
TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË
TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË
VENDIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 6, të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1, e kreut II, ndryshon si më poshtë:

“1. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare apo Evropiane të Kualifikimeve, si dhe të titujve akademikë kryhet vetëm *on-line* nëpërmjet portalit *e-albania*. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar duhet të depozitohet detyrimisht i skanuar gjatë aplikimit *on-line*.”.

b) Pika 1, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

“1. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave universitare të nivelit 5 deri në nivelin 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK), kryhet *on-line* sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *on-line* në portalin *e-albania*. Këtij formulari i ngarkohet në format elektronik (PDF), dokumentacioni i parashikuar në germenat “b”, “c”, “d” dhe “e” të kësaj pike.

b) diploma/certifikata, ose dokumenti zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, kopje e njësuar me origjinalin, si dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës;

c) lista e notave dhe/ose suplementi i diplomës (nëse ka), të njësuar me origjinalin, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës;

d) kopje e kartës së identitetit ose e pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);

e) mandatpagesa ose konfirmimi i pagesës *on-line*.”.

c) Pas pikës 1, të kreut III, shtohet pika 1/1, si më poshtë:

“1/1. Në rrugë postare (format *hard-copy*) pas kryerjes së aplikimit *on-line*, paraqitet një kopje e diplomës/certifikatës bashkë me listën e notave ose suplementin e diplomës (nëse ka), të njësuara me origjinalin, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e



Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës.”.

d) Pika 2, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

“2. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor”, kryhet *on-line* sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *on-line* në portalin *e-albania*. Këtij formulari i ngarkohet në format elektronik (PDF), dokumentacioni i parashikuar në gerrat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”, të kësaj pike.

b) diploma dhe suplementi i saj (nëse ka të tillë), lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, që dëshmon fitimin e gradës shkencore “Doktor”, kopje e njësuar me origjinalin, si dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës;

c) diploma e studimeve pararendëse universitare dhe/ose vërtetimi i njësimit të diplomës i lëshuar nga institucioni përgjegjës;

d) disertacioni i doktoratës;

e) fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës (për shtetasit e huaj);

f) mandatpagesa ose konfirmimi i pagesës *on-line*;

g) aplikanti duhet të depozitojë një kopje të disertacionit në Bibliotekën Kombëtare. Vërtetimi i depozitimit të këtij dokumenti do të sigurohet drejtpërdrejt nëpërmjet sistemit nga institucioni përkatës i njohjes së diplomave.”.

e) Pas pikës 2, të kreut III, shtohet pika 2/2, si më poshtë:

“2/2 Në rrugë postare (format *hard-copy*) pas kryerjes së aplikimit *on-line*, paraqitet një kopje e diplomës/certifikatës dhe suplementit (nëse ka të tillë), të njësuara me origjinalin, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës.”.

f) Pika 3, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

“3. Aplikimi për njohjen e titujve akademikë “Profesor” dhe “Profesor i asociuar”, kryhet *on-line* sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *on-line* në portalin *e-albania*. Këtij formulari i ngarkohet në format elektronik (PDF), dokumentacioni i parashikuar në gerrat “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h” dhe “i”, të kësaj pike;

b) dokumenti i fitimit të titullit akademik, kopje e njësuar me origjinalin si dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës.

c) diploma e studimeve pararendëse universitare dhe/ose vërtetimi i njësimit të diplomës i lëshuar nga institucioni përgjegjës;

d) vërtetimin e regjistrimit të titullit akademik në databazë në zbatim të kuadrit ligjor të vendit përkatës;

e) *Curriculum Vitae*;

f) fotokopja e kartës së identitetit apo pasaportës (për shtetasit e huaj);

g) deklarata/skeda e nënshkruar në të cilin të jepet informacion, për:

i. eksperiencën akademike në mësimdhënie;

ii. aktivitetin shkencor – lista e artikujve/botimeve shkencore, pjesëmarrje në simpoziume, konferenca, kongrese shkencore të shoqëruar me titujt e materialeve të paraqitura;

iii. botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare.

ii. informacioni i parashikuar në këtë skedë duhet të shoqërohet me dokumentacion provues përkatës;

h) mandatpagesa ose konfirmimi i pagesës *on-line*.”;

g) Pas pikës 3, të kreut III, shtohet pika 3/1, si më poshtë:

“3/1. Në rrugë postare (format *hard-copy*) pas kryerjes së aplikimit *on-line* paraqitet një kopje e dokumentit të fitimit të titullit akademik, e njësuar me origjinalin dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës dhe vula.”.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

**URDHËR****Nr. 438, datë 26.12.2019****PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT,
LICENCIMIT DHE PUBLIKIMIT NË
MËNYRË ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionin e Këshillit të Ministrave; të ligjit nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të nenit 70/2 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, të pikës 4, të nenit 36, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9880, datë 2.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ligjit nr. 10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”; VKM nr. 391, datë 3.5.2017, “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit”, vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Nga data 1.1.2020, shërbimet funksionale të QKB-së të përcaktuara në tabelën 1, lidhur me regjistrimin dhe licencimin e biznesit, do të ofrohen vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet sportelit elektronik në portalin e-albania, në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, ligjin për licencimin e biznesit, ligjin për nënshkrimin elektronik dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

2. Shërbimet funksionale të QKB-së të përcaktuara në tabelën 2, lidhur me regjistrimin dhe licencimin e biznesit, do të ofrohen vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet sportelit elektronik, nga data 30.6.2020.

3. Kushtet, procedurat për kryerjen e aplikimeve pranë regjistrimit tregtar, nëpërmjet sportelit elektronik, shqyrtimi i tyre nga QKB-ja, si dhe afatet e tyre janë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 391, “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

4. Kushtet dhe procedurat për kryerjen e aplikimeve për pajisjen me licence dhe leje që trajtohet nga apo nëpërmjet QKB-së, pranë Regjistrimit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, nëpërmjet sportelit elektronik, si dhe procedurat e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, janë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitave ligjore në fuqi.

5. Për aplikimet për pajisjen me licence dhe leje që trajtohet nga apo nëpërmjet QKB-së, pranë Regjistrimit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, nëpërmjet sportelit elektronik, aplikanti pasi verifikon se të dhënat e plotësuara në formular dhe dokumentet shoqëruese të ngarkuara në dosjen elektronike janë të sakta, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” dhe legjislacionit sektorial për licencimin, i konfirmon ato me mjete elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacënueshmerinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën nëpërmjet nënshkrimit elektronik të kualifikuar të formularit të aplikimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

6. Kushtet dhe mënyrat e pajisjes së individëve me të drejtat përkatëse të aksesit elektronik, procedurat e tyre, kushtet e sigurisë dhe të ruajtjes së komunikimeve elektronike, do të bëhet në përputhje me kreun IV, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 391, “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe akteve ligjore dhe nënligjore për nënshkrimin dhe dokumentin elektronik.

7. Vërtetimi i dokumenteve elektronike, të lëshuar nga QKB-ja do të ofrohet në përputhje me ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”; ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik” dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe zbatim të tyre.

8. Qendra Kombëtare e Biznesit në bashkëpunim me AKSHI-n do të kryej njoftime



publike lidhur me rastet e remonteve të planifikuara apo të incidenteve teknike të sportelit elektronik dhe të rasteve të ndërhyrjeve të paaautorizuara, referuar vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar dhe akteve të nxjerra në zbatim të tyre.

9. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij urdhri.

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 439, datë 26.12.2019

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË
FORMULARËVE TË APLIKIMIT VETËM
ON-LINE, TË STANDARDIZUAR NGA
AGJENCIA E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA), PËR
REGJISTRIMIN DHE LICENCIMIN
E BIZNESIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionin e Këshillit të

Ministrave; të VKM-së nr. 584, datë 27.7.2016 dhe të urdhrit të Kryeministrit nr. 153, datë 25.11.2019, “Për marrjen e masave për rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm *on-line* nga data 1.1.2020”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e përdorimit të formularëve të aplikimit vetëm *on-line*, të standardizuar nga Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), për regjistrimin dhe licencimin e biznesit, sipas listës që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Tabelë nr. 1

Nr.	Emërtimi i shërbimeve
1	Aplikim për regjistrim fillestar, person fizik
2	Aplikim për regjistrim fillestar për shoqëritë kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuar dhe të thjeshta
3	Aplikim për regjistrim fillestar për shoqëritë aksionare (sh.a.)
4	Aplikim për regjistrim fillestar të degëve ose zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja
5	Aplikim për ndryshim në të dhënat e regjistrimit të personit fizik
6	Aplikim për ndryshim në të dhënat e regjistrimit të shoqërive kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuar dhe të thjeshta
7	Aplikim për ndryshim në të dhënat e regjistrimit të shoqërive aksionare
8	Aplikim për ndryshim në të dhënat e regjistrimit të degëve ose zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja
9	Aplikim për depozitim të pasqyrave financiare dhe raportit të auditimit
10	Aplikim për regjistrim të vendimeve/akteve të gjykatës, zyrës përmbartimore ose autoriteteve të tjera publike



11	Certifikatë regjistrimi
12	Kërkesë për lëshim ekstrakti të thjeshtë
13	Kërkesë për lëshim ekstrakti historik
14	Aplikim për pajisje me leje/licencë
15	Lëshim titulli
16	Revokim vullnetar

Tabelë nr. 2

1	Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive të kursim-kreditit
2	Aplikim për regjistrimin fillestar të unionit të shoqërive të kursim-kreditit
3	Aplikim për bashkimin me krijimin e një shoqërie të re kursim-kreditit
4	Aplikim për bashkimin e SHKK-ve me përthithje
5	Aplikim për ndarjen e shoqërisë së kursim-kreditit, me krijim
6	Aplikim për ndarjen e shoqërisë së kursim-kreditit, me përthithje
7	Aplikim për shndërrimin e unionit në shoqëri të kursim-kreditit
8	Aplikim për çregjistrimin e unionit të shoqërive të kursim-kreditit
9	Aplikim për çregjistrimin e unionit të shoqërive të kursim-kreditit
10	Aplikim për fillimin e procedurës së likuidimit të unionit
11	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit të unionit të shoqërive të kursim-kreditit
12	Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor
13	Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive të bashkëpunimit reciprok
14	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit të shoqërive të kursim-kreditit
15	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor
16	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok
17	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit për shoqëritë aksionare (sh.a.)
18	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok
19	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit për shoqëritë e kursim-kreditit
20	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit për shoqëritë kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuara dhe të thjeshta
21	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor
22	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit të degëve ose zyra të përfaqësimit të shoqërive të huaja
23	Aplikim për çregjistrimin e personit fizik
24	Aplikim për çregjistrimin e personit juridik
25	Certifikatë çregjistrimi
26	Aplikim për shndërrimin e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok në shoqëri bashkëpunimi bujqësor
27	Aplikim për miratimin e shndërrimit
28	Kërkesë për korrigjimin e gabimeve
29	Kërkesë për rezervim emri
30	Kërkesë për plotësimin e ekstraktit historik
31	Aplikim për njoftimin e projektbashkimit me përthithje nga një shoqëri ekzistuese (bashkim i thjeshtë)
32	Aplikim për njoftimin e projektbashkimit me përthithje me krijimin e një shoqërie të re
33	Aplikim për miratimin e bashkimit me përthithje me krijimin e një shoqërie të re
34	Aplikim për miratimin e bashkimit me përthithje, nga një shoqëri ekzistuese (bashkim i thjeshtë)
35	Aplikim për miratimin e ndarjes (ndarje në favor të shoqërive ekzistuese), faza 2



36	Aplikim për miratimin e ndarjes (ndarje në favor të shoqërive të themeluara rishtazi), faza 2
37	Aplikim për njoftimin e projektndarjes (ndarje në favor të shoqërive të themeluara rishtazi), faza 1
38	Aplikim për njoftimin e projektndarjes (ndarje në favor të shoqërive ekzistuese), faza 1
39	Aplikim për thirrje të aksionarëve/ortakëve për miratimin e shndërrimit (shpallja 1)
40	Aplikim për thirrje të aksionarëve/ortakëve për miratimin e shndërrimit (shpallja 2)
41	Kërkesë për aktivizim aktiviteti
42	Aplikim për pezullimin e aktivitetit
43	Aplikim për transferimin e emrit të rezervuar
44	Veprimet përgatitore për bashkimin ndërkufitar
45	Miratim nga asambleja për bashkimin ndërkufitar
46	Lëshimi i dublikatës së certifikatës
47	Ankim administrativ
48	Aplikim për shtyrje afati
49	Aplikim për ndryshim leje/licence
50	Aplikim për rishikim kushtesh (të lejes mjedisore)
51	Aplikim për transferim të lejes
52	Riprintim titulli

URDHËR

Nr. 439/1, datë 31.12.2019

**PËR NJË SHITESË NË URDHRIN E
MINISTRIT TË FINANCAVE DHE
EKONOMISË NR. 439, DATË 26.12.2019
“PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË
FORMULARËVE TË APLIKIMIT VETËM
ON-LINE, TË STANDARDIZUAR NGA
AGJENCIA E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA), PËR
REGJISTRIMIN DHE LICENCIMIN
E BIZNESIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionin e Këshillit të Ministrave; pikës 4, të nenit 16, të ligjit nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe urdhrin të Kryeministrit nr. 153, datë 25.11.2019, “Për marrjen e masave për rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve *on-line* nga data 1.1.2020”,

URDHËROJ:

1. Titulli i urdhrin ndryshon si vijon:

“Për miratimin e përdorimit të formularëve të aplikimit vetëm *on-line*, për regjistrimin dhe licencimin e biznesit”.

2. Pika 1, ndryshon si vijon:

“1. Miratimin e përdorimit të formularëve të aplikimit vetëm *on-line*, për regjistrimin dhe licencimin e biznesit”.

3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 444, datë 31.12.2019

**PËR NJË SHITESË NË URDHRIN E
MINISTRIT TË FINANCAVE DHE
EKONOMISË NR. 438, DATE 26.12.2019,
“PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT,
LICENCIMIT DHE PUBLIKIMIT NË
MËNYRË ELEKTRONIKE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionin e Këshillit të Ministrave”; të ligjit nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të nenit 70/2, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të



ndryshuar; të pikës 4, të nenit 36, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9880, datë 2.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”; të ligjit nr. 10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”; të VKM-së nr. 391, datë 3.5.2017, “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pas pikës 5, shtohet pika 5/2, me përmbajtjen si vijon:

“5/2. Për aplikimet për pajisjen me licenca dhe leje që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB-së, pranë Regjistrimit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, nëpërmjet sportelit elektronik, nënshkrimi elektronik i formularëve të aplikimit do të zbatohet pas miratimit të akteve të nevojshme nënligjore.”

2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Tabelë nr. 1

Nr.	Emërtimi i shërbimeve
1	Aplikim për regjistrim fillestar, person fizik
2	Aplikim për regjistrim fillestar për shoqëritë kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuar dhe të thjeshta
3	Aplikim për regjistrim fillestar për shoqëritë aksionare (sh.a.)
4	Aplikim për regjistrim fillestar të degëve ose zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja
5	Aplikim për ndryshim në të dhënat e regjistrimit të personit fizik
6	Aplikim për ndryshim në të dhënat e regjistrimit të shoqërive kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuar dhe të thjeshta
7	Aplikim për ndryshim në të dhënat e regjistrimit të shoqërive aksionare
8	Aplikim për ndryshim në të dhënat e regjistrimit të degëve ose zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja
9	Aplikim për depozitimin e pasqyrave financiare dhe raportit të auditimit
10	Aplikim për regjistrim të vendimeve/akteve të gjykatës, zyrës përmbartimore ose autoriteteve të tjera publike
11	Certifikatë regjistrimi
12	Kërkesë për lëshim ekstrakti të thjeshtë
13	Kërkesë për lëshim ekstrakti historik
14	Aplikim për pajisje me leje/licencë
15	Lëshim titulli
16	Revokim vullnetar

Tabelë nr. 2

1	Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive të kursim-kreditit
2	Aplikim për regjistrimin fillestar të unionit të shoqërive të kursim-kreditit
3	Aplikim për bashkimin me krijimin e një shoqërie të re kursim-krediti
4	Aplikim për bashkimin e SHKK-ve me përthithje
5	Aplikim për ndarjen e shoqërisë së kursim-kreditit, me krijim
6	Aplikim për ndarjen e shoqërisë së kursim-kreditit, me përthithje
7	Aplikim për shndërrimin e unionit në shoqëri të kursim-kreditit
8	Aplikim për çregjistrimin e unionit të shoqërive të kursim-kreditit
9	Aplikim për çregjistrimin e unionit të shoqërive të kursim-kreditit



10	Aplikim për fillimin e procedurës së likuidimit të unionit
11	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit të unionit të shoqërive të kursim-kreditit
12	Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor
13	Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive të bashkëpunimit reciprok
14	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit të shoqërive të kursim-kreditit
15	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor
16	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok
17	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit për shoqëritë aksionare (sh.a.)
18	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok
19	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit për shoqëritë e kursim-kreditit
20	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit për shoqëritë kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuara dhe të thjeshta
21	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor
22	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit të degëve ose zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja
23	Aplikim për çregjistrimin e personit fizik
24	Aplikim për çregjistrimin e personit juridik
25	Certifikatë çregjistrimi
26	Aplikim për shndërrimin e shoqërisë së bashkëpunimit reciprok në shoqëri bashkëpunimi bujqësor
27	Aplikim për miratimin e shndërrimit
28	Kërkesë për korrigjimin e gabimeve
29	Kërkesë për rezervim emri
30	Kërkesë për plotësimin e ekstraktit historik
31	Aplikim për njoftimin e projektbashkimit me përthithje nga një shoqëri ekzistuese (bashkim i thjeshtë)
32	Aplikim për njoftimin e projektbashkimit me përthithje me krijimin e një shoqërie të re
33	Aplikim për miratimin e bashkimit me përthithje me krijimin e një shoqërie të re
34	Aplikim për miratimin e bashkimit me përthithje, nga një shoqëri ekzistuese (bashkim i thjeshtë)
35	Aplikim për miratimin e ndarjes (ndarje në favor të shoqërive ekzistuese), faza 2
36	Aplikim për miratimin e ndarjes (ndarje në favor të shoqërive të themeluara rishtazi), faza 2
37	Aplikim për njoftimin e projektndarjes (ndarje në favor të shoqërive të themeluara rishtazi), faza 1
38	Aplikim për njoftimin e projektndarjes (ndarje në favor të shoqërive ekzistuese), faza 1
39	Aplikim për thirrje të aksionarëve/ortakëve për miratimin e shndërrimit (shpallja 1)
40	Aplikim për thirrje të aksionarëve/ortakëve për miratimin e shndërrimit (shpallja 2)
41	Kërkesë për aktivizim aktiviteti
42	Aplikim për pezullimin e aktivitetit
43	Aplikim për transferimin e emrit të rezervuar
44	Veprimet përgatitore për bashkimin ndërkuftar
45	Miratim nga asambleja për bashkimin ndërkuftar
46	Lëshimi i dublikatës së certifikatës
47	Ankim administrativ
48	Aplikim për shtyrje afati
49	Aplikim për ndryshim leje/licence
50	Aplikim për rishikim kushtesh (të lejes mjedisore)
51	Aplikim për transferim të lejes
52	Riprintim titulli

**URDHËR**

Nr. 685, datë 19.12.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE
SHËNDETËSORE DHE KARANTINORE
TË DISA SPECIEVE ZOGJSH”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 51, pika 2, nenit 72 dhe nenit 129, germa “c”, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2019 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e kushteve shëndetësore dhe karantinore të disa specieve zogjsh”, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe të mbrojtjes së bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

RREGULLORE**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR
PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE
SHËNDETËSORE DHE KARANTINORE TË
DISA SPECIEVE ZOGJSH”****Neni 1****Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore përcakton kriteret e shëndetit dhe karantinës për importin e disa specieve zogjsh.

Neni 2**Qëllimi**

Kjo rregullore zbatohet vetëm për llojin shpendë.

Nuk zbatohet për:

- a) pulat;
- b) zogjtë e importuar në kuadër të programeve të ruajtjes (monitorimit), që janë miratuar nga ministri;
- c) shpendët që janë kafshë shtëpiake dhe shoqërohen nga pronari i tyre;
- d) zogj të destinuar për parqe zoologjike, cirqe, parqe dëfrimi ose eksperimente;
- e) zogj të destinuar për autoritete, institute ose qendra të miratuara;
- f) pëllumba garash, të cilët futen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një vend fqinj dhe më pas lirohen menjëherë që të fluturojnë përsëri për në vendin e origjinës.

Neni 3**Përkufizime**

Për qëllime të kësaj rregullore do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Shpendë” nënkupton zogjtë, gjelat e detit, zogjtë guinea, rosat, patat, shkurtëzat, pëllumbat, fazanët, thëllëza dhe zogj jofluturues, të rritur ose të mbajtur për prodhim, mbarështim, prodhim mishi ose vezësh për konsum ose për të ripopulluar zogjtë e egër;

b) “Zogj” nënkupton kafshët e llojeve të shpendëve, përveç atyre të përmendura në paragrafin e dytë të nenit 2;

c) “Njësi e miratuar për mbarështim”, do të thotë:

- një ndërtesë e përdorur ekskluzivisht për mbarështimin e zogjeve; dhe

- që është inspektuar dhe miratuar nga autoriteti kompetent për përmbushjen e kushteve të parashikuara në nenin 4 dhe nenet 23 dhe 24;

d) “Zogjtë e mbajtur në kafaze” nënkuptojnë zogjtë që nuk janë kapur nga gjendja e tyre e lirë në natyrë, por kanë lindur dhe janë rritur në kafaze nga tufa prindërore pas çiftëzimit natyral ose si pasojë e inseminimit artificial;

e) “Unazë e mbyllur pa shkoputje” është një unazë ose shirit me një rreth të vazhdueshëm, pa asnjë ndërprerje ose nyje, e cila nuk është dëmtuar në asnjë pjesë të madhësisë së saj, e cila nuk mund të largohet nga këmba e zogut, kur këmbët e tij janë rritur plotësisht, pas vënies së saj në ditët e para të jetës së shpendit, e cila është prodhuar për qëllim tregtar;



f) “Zogj sentinel” janë shpendët që përdoren për qëllime diagnostike gjatë karantinës;

g) “Qendër e miratuar e karantinës” nënkupton vendin ku/që:

i. bëhet karantina e zogjve të importuar;

ii. përmbajnë një numër njësisish, të cilat janë të ndara fizikisht dhe në aspektet e veprimtarive të tyre nga njëra-tjetra dhe në të cilat secila njësi përmban vetëm zogj të së njëjtës ngarkesë me të njëjtin status shëndetësor dhe që përfshihen në një njësi të vetme epidemiologjike;

iii. është inspektuar dhe miratuar nga shërbimi veterinar për përmbushjen e kushteve minimale, të parashikuara në nenin 6 dhe nenet 23 dhe 24;

h) “Manual diagnostikues” nënkupton Manualin Diagnostik për influencën e shpendëve.

Neni 4

Stabilimentet e miratuara të mbarështimit

Stabilimentet e miratuara të mbarështimit duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

a) njësia e mbarështimit miratohet sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 19 dhe të ketë një numër miratimi;

b) emri dhe numri i miratimit i subjektit të mbarështimit duhet të paraqitet në listën e subjekteve të mbarështimit, të aprovuara nga Shërbimi Rajonal Veterinar ARSHVMB;

c) licenca ose leja e subjektit të mbarështimit duhet të pezullohet ose të ndërpritet menjëherë nga Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar, në rast të kushteve të përcaktuara në nenet 19, 20, 21 dhe 22.

Neni 5

Kushtet e importit

Importi i zogjve do të autorizohet vetëm nëse zogjtë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) zogjtë janë zogj të rritur në kafaze;

b) zogjtë duhet të jenë me origjinë nga vendet ose rajonet e tyre të referuara në aneksin I;

c) zogjtë vijnë nga qendrat e miratuara të mbarështimit që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4;

d) zogjtë i janë nënshtruar 7 deri në 14 ditë përpara dërgesës, testit të zbulimit të virusit në laborator, për sëmundjen e influencës aviare dhe *Newcastle*, me rezultate negative për praninë e këtyre viruseve;

e) zogjtë nuk janë vaksinuar kundër gripit të shpendëve;

f) zogjtë shoqërohen nga një certifikatë shëndetësore në përputhje me modelin e përcaktuar në aneksin II (certifikatën shëndetësore);

g) zogjtë identifikohen me një numër identifikimi individual me anë të një unaze të mbyllur në këmbë ose një mikroçip;

h) numri individual identifikues i unazave të këmbëve ose mikroçipave të parashikuar në germën “g” duhet të përmbajë të paktën:

- kodin ISO të vendit eksportues që ka kryer identifikimin;

- një numër serial unik;

i) numrin individual identifikues parashikuar në germën “g”, i cili duhet të regjistrohet në certifikatën e shëndetit;

j) zogjtë transportohen në kontejnerë të rinj të cilët janë të identifikuar individualisht nga ana e jashtme me një numër identifikimi korrespondues me numrin e identifikimit të treguar në certifikatën e shëndetit.

Neni 6

Objektet dhe qendrat karantinore të aprovuara

Objektet dhe qendrat karantinore të aprovuara duhet të jenë në përputhje me kushtet minimale të përcaktuara në nenet 23 dhe 24.

Shërbimi veterinar duhet të hartojë dhe të mbajë të përditësuar një listë të njësive dhe qendrave të miratuara të karantinës dhe numrat e miratimit të tyre të cilat të jenë publike.

Neni 7

Transporti i menjëhershëm i zogjve në qendrat ose njësitë karantinore të miratuara

Zogjtë duhet të transportohen direkt nga pikat e inspektimit kufitar në një njësi ose në një qendër karantinore të miratuar, në kafaze ose arka të transportit të zogjve. Koha e udhëtimit nga pika e inspektimit kufitar në njësinë ose qendrën e karantinës, normalisht nuk duhet të zgjasë më shumë se nëntë orë.

Në rast se ky udhëtim mundësohet nga automjete transporti, atëherë, këto automjete duhen kyçur dhe vulosur nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës.



Neni 8 Vërtetimi

Importuesit ose përfaqësuesit e tyre duhet të jenë të pajisur me një vërtetim të shkruar, edhe në gjuhën shqipe, vërtetim i cili të jetë i nënshkruar nga personi përgjegjës i njësisë ose i qendrës karantinore që vërteton se zogjtë do të pranohen për hyrjen e tyre në karantinë.

Ky vërtetim, duhet:

- a) të tregojë qartë emrin, adresën dhe numrin e miratimit të objektit ose qendrës së karantinës;
- b) të arrijë në pikën e inspektimit kufitar 24 orë para datës së mbërritjes së ngarkesës në territorin e vendit tonë ose të paraqitet importuesi apo përfaqësuesi i tij para lëshimit të zogjve nga pika e inspektimit kufitar.

Neni 9 Transitimi për në Republikën e Shqipërisë

Kur zogjtë hyjnë në Republikën e Shqipërisë, duhet të merren të gjitha masat për të siguruar që dërgesa të arrijë në vendin e synuar të destinacionit.

Neni 10 Monitorimi i transportit të zogjve

1. Monitorimi e zogjve nga pika e inspektimit kufitar në objektin e miratuar të karantinës ose qendrën në vendin e destinacionit bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi dhe siguron shkëmbimet e mëposhtme të informacionit:

a) inspektori veterinar përgjegjës për pikën e inspektimit kufitar, njofton autoritetin përgjegjës për Pikën e inspektimit kufitar PIK, si dhe ministrinë dhe ARSHVMB për njësinë ose qendrën karantinore të miratuar në vendin e destinacionit të ngarkesës, vendin e origjinës dhe vendin e destinacionit të zogjve nëpërmjet sistemit Trace;

b) personi përgjegjës për objektin e miratuar të karantinës ose qendrës së destinacionit duhet të njoftojë menjëherë, veterinerin zyrtar përgjegjës të miratimit të objektit karantinor ose qendrës në vendin e destinacionit të mbërritjes së dërgesës.

2. Nëse që nga konfirmimi i dhënë nga autoriteti kompetent përgjegjës për pikën e inspektimit kufitar, zogjtë e deklaruar konform pranimi në njësinë e karantinës nuk kanë mbërritur ende në destinacionin e tyre, pas tri ditësh pune të datës së

deklaruar për dorëzim në qendrën karantinore, shërbimi veterinar duhet të marrë masat e duhura dhe të menjëhershme kundrejt personit përgjegjës për dërgesën.

Neni 11 Masat karantinore

1. Zogjtë duhet të vendosen në karantinë për të paktën 21 ditë në një objekt ose qendër karantine të miratuar.

2. Të paktën në fillim dhe në fund të karantinës për secilën ngarkesë, veterinarin zyrtar duhet të inspektojë kushtet e karantinës, evidentimin e ngordhjeve, si dhe të kryejë inspektimin klinik të zogjve të pranishëm në karantinë apo në njësitë përbërëse të karantinës.

Megjithatë, në varësi të situatës infektive veterinarin zyrtar duhet të kryejë inspekte më të shpeshta.

Neni 12 Ekzaminimi, kampionimi dhe testet që kryhen gjatë periudhës karantinore

1. Pas futjes së zogjve në karantinë duhet kryer ekzaminimi klinik, marrja e mostrave për testimin e sëmundjes së gripit të shpendëve dhe sëmundjen e *Newcastle*, të përcaktuara në nenin 26.

2. Në rastet e përdorimit të zogjve të llojit sentinel, duhet të përdoret një minimum prej 10 syresh, në një karantinë ose për çdo njësi përbërëse të një qendre karantine.

3. Zogjtë e llojit sentinelë që përdoren për ekzaminimin, marrjen e mostrave dhe procedurat e testimit duhet të jenë:

a) të paktën me moshë trejavëshe dhe të përdoren vetëm një herë për atë qëllim;

b) të kenë të lidhur shiritin e këmbës për qëllime identifikimi ose të identifikohen me një mjet tjetër të palëvizshëm identifikimi;

c) të pavaksinuar dhe sero-negative kundrejt gripit të shpendëve dhe sëmundjes së *Newcastle* brenda një periudhe prej 14 ditësh para datës së hyrjes në karantinë;

d) të vendosur në një objekt të miratuar të karantinës ose në një njësi të qendrës së karantinës së miratuar, përpara ardhjes së zogjve, si dhe në të njëjtën hapësirë ajrore me ta në mënyrë që të mundësohet kontakti i drejtpërdrejt i zogjve sentinel me jashtëqitjet e zogjve të ngarkesës.



Neni 13

Masat që merren në rastin e dyshimit të sëmundjeve në qendrat ose njësitë e miratuara karantinore

1. Nëse gjatë karantinës, në një objekt karantine të miratuar, dyshohet se një ose më shumë zogj dhe/ose zogj sentinelë janë të infektuar me gripin e shpendëve ose sëmundjen e *Newcastle*, duhet të merren masat e mëposhtme:

a) shërbimi veterinar duhet të vendosë objektin e karantinës së aprovuar nën mbikëqyrje zyrtare;

b) mostrat për ekzaminimin viral sipas pikës 2, të nenit 26, duhet të merren nga zogj dhe zogj sentinelë dhe të analizohen në përputhje me rrethanat;

c) asnjë zog nuk duhet të hyjë ose të largohet nga objekti i karantinës së miratuar derisa dyshimi të përjashtohet.

2. Nëse vërtetohet dyshimi i pranisë së gripit të shpendëve ose sëmundjes së *Newcastle* në objektin e miratuar karantinor të përmendur në paragrafin 1, duhet të merren masat e mëposhtme:

a) të gjithë zogjtë dhe zogjtë sentinelë në objektin e miratuar të karantinës duhet të eliminohen dhe të asgjësohen;

b) objekti i karantinës i miratuar duhet të pastrohet dhe dezinfektohet;

c) asnjë zog nuk duhet të hyjë në objektin e karantinës së miratuar, deri në 21 ditë pas pastrimit dhe dezinfektimit, përfundimtar të karantinës.

3. Nëse gjatë karantinës në një qendër karantine të miratuar dyshohet se një ose më shumë zogj dhe/ose zogj sentinelë në një njësi të qendrës së karantinës janë të infektuar me gripin e shpendëve ose sëmundjen e *Newcastle*, duhet të merren masat e mëposhtme:

a) shërbimi veterinar vendos qendrën e miratuar karantinore nën mbikëqyrje zyrtare;

b) mostrat për ekzaminimin viral sipas pikës 2, të nenit 26 do të merren nga zogjtë e ngarkesës dhe zogjtë sentinelë dhe do të analizohen në përputhje me rrethanat;

c) asnjë zog nuk duhet të hyjë ose të largohet nga qendra e miratuar e karantinës derisa dyshimi të përjashtohet.

4. Nëse vërtetohet dyshimi i pranisë së gripit të shpendëve ose sëmundjes së *Newcastle* në njësinë e

prekur të qendrës së karantinës së aprovuar, siç referohet në paragrafin 3, duhet të merren masat e mëposhtme:

a) të gjithë zogjtë dhe zogjtë sentinelë në njësinë e prekur të qendrës së karantinës së aprovuar duhet të eliminohen dhe të asgjësohen;

b) njësia në fjalë duhet pastruar dhe dezinfektuar;

c) do të merren mostrat e mëposhtme:

i. kur përdoren zogjtë sentinelë, jo më herët se 21 ditë pas pastrimit përfundimtar dhe dezinfektimit të njësisë në fjalë, mostrat për ekzaminimin serologjik të përcaktuar në nenin 26 duhet të merren nga zogjtë sentinelë të pranishëm në njësitë e tjera të karantinës; ose

ii. kur nuk përdoren zogj sentinelë 7 deri në 15 ditë pas pastrimit dhe dezinfektimit përfundimtar, mostrat për ekzaminim viral siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 26, duhet të merren nga zogjtë në njësitë e tjera të karantinës;

d) Asnjë zog nuk duhet të largohet nga qendra e karantinës së miratuar derisa rezultatet e mostrave të parashikuara në pikën c, të jenë konfirmuar si negative.

5. ARSHVMB-të, të informojnë ministrinë për çdo masë të ndërmarrë sipas këtij neni.

Neni 14

Masat që merren në rastet pozitive të gjetjeve të sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të ulët dhe pseudopestit (*Newcastle*) në qendrat ose njësitë e miratuara karantinore

1. Nëse gjatë karantinës zbulohet se një ose më shumë zogj dhe/ose zogj sentinelë të infektuar me shtame me patogjenitet të ulët të gripit të shpendëve (LPAI) apo sëmundjes së *Newcastle*, në varësi të riskut, shërbimi veterinar mund të marrë një apo disa nga masat e përcaktuara në nenin 13, pika 2, germa “a” dhe pika 4, germa “a” të kësaj rregulloreje, me kusht që këto masa të marra të mos ndryshojnë kontrollin e sëmundjes. Shërbimi veterinar rajonal të informojë menjëherë ministrinë për çdo lloj mase të marrë.

2. Në rastet kur veterineri zyrtar, gjatë inspektimit të objektit ose qendrës së karantinës, për të cilën ka marrë një nga masat, zbulon se një ose më shumë zogj dhe/ose zogj sentinelë janë infektuar me shtame me patogjenitet të ulët të



gripit të shpendëve ose pseudopestit (*Newcastle*), duhet të zbatohet masat e përcaktuara në paragrafët 3 deri 7.

Shërbimi veterinar rajonal të informojë menjëherë autoritetin kompetent për çdo masë të marrë.

3. Në rastin e pozitivitetit për LPAI (shtame me patogjenitet të ulët të gripit të shpendëve), në vend të mostrave standarde siç parashikohet në manualin diagnostik, duhet të merren mostrat e mëposhtme për testimin laboratorik, 21 ditë pas datës së gjetjes së fundit pozitive për LPAI LPAI (shtame me patogjenitet të ulët të gripit të shpendëve) në objektin karantinor të miratuar ose nga çdo njësi në qendrën e miratuar të karantinës në intervale prej 21 ditësh:

a) mostra të secilit zog dhe/ose zogjsh sentinelë të ngordhur, të pranishëm në momentin e marrjes së mostrave;

b) tamponë trakealë/rofarinealë dhe kloakal prej të paktën 60 zogjve ose prej të gjithë zogjve nëse në karantinë janë të pranishëm më pak se 60 zogj në objektin e karantinës të aprovuar ose në njësinë përkatëse të qendrës së karantinës së aprovuar.

Në rastet e zogjve ekzotikë duhen marrë mostra nga feçet e freskëta.

c) marrja e mostrave dhe testimet laboratorike të mostrave të tilla duhet të vazhdojnë derisa të merren dy rezultate laboratorike negative të njëpasnjëshme, të cilat duhet të merren më së paku në interval prej 21 ditësh. Shërbimi veterinar mund të marr masa mbi sasinë e mostrave sipas përcaktimeve të këtij paragrafi, bazuar në vlerësimin e riskut.

4. Në rastin e gjetjes së rezultatit pozitiv për praninë e sëmundjes së pseudopestit (*Newcastle*), shërbimi veterinar mund të marrë vetëm një masë me kusht që në 30 ditë pas ngordhjes ose shërimit klinik të rastit të fundit të kësaj sëmundje, marrja e mostrave në përputhje me pikat 1 dhe 2 të nenit 26, duke mos marrë parasysh referencën për periudhën kohore të përcaktuar, ka rezultuar negative.

5. Zogjtë nuk duhet të largohen nga karantina derisa të ketë kaluar së paku periudha e testimit laboratorik të parashikuar në paragrafin 3.

6. Objekti i karantinës së miratuar ose njësi në fjalë e qendrës së karantinës së aprovuar duhet të pastrohet dhe të dezinfektohet pasi të jetë zbratur. Çdo lëndë ose mbetje që ka gjasa të kontaminohet,

si dhe të gjitha mbeturinat që janë grumbulluar gjatë periudhës së testimit laboratorik të parashikuar në paragrafin 3 duhet të largohen me qëllim që të sigurohet mospërhapja e patogjenëve dhe të shkatërrohet në atë mënyrë që garanton shkatërrimin e virusit të pranishëm të LPAI (shtame me patogjenitet të ulët të gripit të shpendëve) ose të sëmundjes së pseudopestit (*Newcastle*).

7. Ripopullimi i objektit ose qendrës së karantinës së miratuar nuk duhet të bëhet për një periudhë prej 21 ditësh pas datës së përfundimit të pastrimit përfundimtar dhe dezinfektimit siç parashikohet në paragrafin 6.

Neni 15

Masat që merren në rastet e dyshimta për sëmundjen e klamidiozës

Nëse gjatë karantinës ose qendër karantine të miratuar, dyshohet ose konfirmohet se psittaciformët (papagajtë) janë të infektuar me *Chlamydia psittaci*, të gjithë zogjtë e ngarkesës duhet të trajtohen me një metodë të miratuar nga shërbimi veterinar dhe karantina do të zgjatet për të paktën dy muaj pas datës së rastit të fundit të regjistruar.

Neni 16

Largimi nga karantina

Zogjtë largohen nga karantina e një objekti karantinor të aprovuar ose në qendër karantine, pas autorizimit me shkrim nga një veteriner zyrtar.

Neni 17

Kërkesat për raportimin dhe njoftimin e sëmundjeve

1. Shërbimi veterinar rajonal t'i komunikojnë ministrinë brenda 24 orëve çdo rast të gripit të shpendëve ose sëmundjes *Newcastle* të zbuluar në një mjedis ose qendër karantine të miratuar.

2. Shërbimi veterinar rajonal t'i komunikojnë ministrisë informacionin e mëposhtëm në trajtën e raportimeve vjetore:

a) numri i zogjve të importuar nëpërmjet objekteve dhe qendrave karantine të miratuara për specie dhe për vendqëndrime të miratuara të origjinës së mbarështimit;



b) informacion në lidhje me shkallën e vdekshmërisë për zogjtë e importuar nga procedura e certifikimit të shëndetit të kafshëve në vendin e origjinës deri në fund të periudhës së karantinës;

c) numri i rasteve të gjetjeve pozitive për gripin e shpendëve, sëmundjes së pseudopestit (*Newcastle*) dhe klamidiozës *Chlamydophila psittaci* në mjediset ose qendrat karantimore të miratuara.

Neni 18

Kostot e karantinës

Të gjitha kostot e karantinës të shkaktuara nga zbatimi i kësaj rregulloreje, barten nga importuesi.

Neni 19

Miratimi i qendrave të mbarështimit

Në mënyrë që të jepet miratimi siç parashikohet në nenin 4, një njësi mbarështuese duhet të përmbushë kushtet e përcaktuara në këtë nen.

1. Stabilimenti i mbarështimit duhet të jetë i kufizuar qartësisht dhe të jetë i veçuar nga mjedisi rreth tij ose kafshët që janë afër tyre dhe të vendosura në të nuk duhet të paraqesin rrezik për shëndetin e kafshëve që ndodhen në stabiliment, gjendja shëndetësore e të cilëve mund të rrezikohet.

2. Duhet të ketë mjete të përshtatshme për kapjen, kufizimin dhe izolimin e kafshëve dhe të disponojë lehtësira dhe procedura të miratuara të miratuara të karantinës për kafshët që vijnë nga stabilimentet që nuk janë të miratuar.

3. Personi përgjegjës për stabilimentin e mbarështimit duhet të ketë përvojën e duhur në mbarështimin e zogjve.

4. Objekti i mbarështimit duhet të jetë i lirë nga gripi i shpendëve, sëmundja e *Newcastle* dhe *Chlamydophila psittaci*. Në mënyrë që të shpallet i lirë objekti, nga këto sëmundje, shërbimi veterinar duhet t'i vlerësojë të dhënat mbi statusin e shëndetit të kafshëve të mbajtura për të paktën tre vitet e mëparshme para datës së aplikimit për miratim nga objekti dhe rezultatet e testeve klinike dhe laboratorike nga kafshët që ndodhen në të. Megjithatë, stabilimentet e reja të mbarështimit miratohen vetëm në bazë dhe pas rezultateve e testeve klinike dhe laboratorike të kryera mbi kafshët në këto stabilimente.

5. Duhet të mbajnë shënime të përditësuara që tregojnë, për:

a) numrin dhe identitetin (mosha, gjinia, specia, lloji dhe numri individual i identifikimit kur është i mundur) e kafshëve të secilës specie të pranishme në subjektin e mbarështimit;

b) numrin dhe identitetin (moshën, gjininë, specien dhe numrin individual të identifikimit kur është e mundur) e zogjve që mbërrijnë në stabilimentin e mbarështimit ose që e kanë lënë atë, së bashku me informacionin mbi origjinën ose destinacionin e tyre, transportin nga vijnë ose mjedisin e mbarështimit dhe gjendjen shëndetësore të zogjve;

c) rezultatet e testeve të gjakut ose të ndonjë procedure tjetër diagnostikuese;

d) rastet e sëmundjeve dhe kur është e mundur trajtimi që i është bërë;

e) rezultatet e ekzaminimeve *post mortem*, mbi zogjtë që kanë ngordhur në objektin e mbarështimit, duke përfshirë zogjtë e porsaçelur;

f) vëzhgimet e bëra gjatë izolimit ose periudhës së karantinës.

6. Stabilimenti i mbarështimit duhet të ketë një marrëveshje me një laborator kompetent për të kryer ekzaminime *post mortem* ose të ketë një ose më shumë mjedise të përshtatshme, ku ekzaminimet e tilla mund të kryhen nga një person kompetent nën autoritetin e veterinerit zyrtar.

7. Stabilimenti i mbarështimit duhet të zbatojë rregullat e duhura, të ketë lehtësira për asgjësimin e trupave të kafshëve që ngordhin nga një sëmundje ose që janë eliminuar me eutanazi.

8. Objekti i mbarështimit duhet të sigurojë me anë të kontratës ose ndonjë instrumenti tjetër ligjor shërbimet e një veterineri zyrtar të miratuar i cili është nën kontrollin e autoritetit kompetent të vendit eksportues, i cili:

a) siguron aplikimin e programit të duhur të survejancës dhe kontrollit në lidhje me situatën e sëmundjes të vendit sipas aprovimit nga autoriteti kompetent dhe të aplikuar në stabilimentin e mbarështimit.

Masat e tilla do të përfshijnë:

i. një plan vjetor për survejancën e sëmundjeve duke përfshirë kontrollin e duhur të zoonozave të kafshëve;

ii. testimet klinike, laboratorike dhe *post mortem* të kafshëve të dyshuara për t'u prekur nga sëmundjet e transmetueshme;

iii. vaksinimin e kafshëve të prekshme nga sëmundjet ngjitëse sipas rastit, në përputhje me



Manualin e Testit Diagnostik dhe Vaksinave për Kafshët Tokësore të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve (OIE);

b) të sigurojë që çdo ngordhje e dyshuar ose pranie e çdo simptome tjetër që sugjeron se shpendët janë prekur me gripin e shpendëve, sëmundjen e *Newcastle* ose *Chlamydophila psittaci* duhet të njoftohet menjëherë tek autoriteti kompetent;

c) të sigurojë që kafshët që hyjnë në objektin e mbarështimit janë izoluar sipas nevojës dhe në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe udhëzimet, nëse ka, të dhëna nga autoriteti kompetent;

d) të jetë përgjegjës ditë pas dite për përmbushjen e detyrave të përditshme të kërkesave të shëndetit të kafshëve, të kësaj rregulloreje dhe të legjislacionit për mirëqenien e kafshëve gjatë transportit.

9. Nëse stabilimenti i mbarështimit rrit kafshë të dedikuara për laboratorët eksperimental, kujdesi dhe akomodimi i përgjithshëm i këtyre kafshëve duhet të jetë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Neni 20

Mirëmbajtja e stabilimenteve të mbarështimit të miratuara

Stabilimentet e mbarështimit duhet të mbeten të miratuara si të tilla vetëm nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë nen.

1. Objekti është nën kontrollin e një veterineri zyrtar të ARSHVMB-së, i cili duhet:

a) të sigurojë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë rregullore;

b) të vizitojë ambientet e stabilimentit të mbarështimit të paktën një herë në vit;

c) të kontrollojë veprimtarinë e veterinerëve të miratuar dhe zbatimin e planit vjetor të vëzhgimit të sëmundjes;

d) të verifikojë se rezultatet e testeve klinike, *post mortem* dhe laboratorike në kafshë nuk kanë zbuluar ndonjë shfaqje të gripit të shpendëve, *Newcastle* ose *Chlamydophila psittaci*.

2. Vetëm kafshët që vijnë nga një stabiliment tjetër i miratuar mbarështimi futen në stabilimentin e mbarështimit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

3. Stabilimenti i mbarështimit duhet të mbajë të dhënat e përmendura në pikën 5, të nenit 19 pas datës së miratimit, për një periudhë prej së paku 10 vjetësh.

Neni 21

Karantina e zogjve të futur nga burime të tjera nga stabilimente të miratuara të mbarështimit

Me anë të masës së pikës 2, të nenit 20, zogjtë e futur nga burime të tjera, nga stabilimentet e miratuara të mbarështimit, mund të futen në një stabiliment mbarështues, pas aprovimit për një hyrje të tillë, nga shërbimi veterinar, me kusht që ata të kalojnë karantinën në përputhje me udhëzimet e dhëna përpara se të futen në stabilimentin mbarështues. Periudha e karantinës duhet të jetë së paku 21 ditë.

Neni 22

Pezullimi, heqja ose rimarrja e miratimit të qendrave të mbarështimit

Procedurat për pezullimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen ose rimarrjen e lejes së miratimit të stabilimenteve mbarështuese, duhet të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë nen.

1. Kur shërbimi veterinar konstaton se një stabiliment mbarështimi nuk i plotëson më kushtet e përcaktuara në nenet 19 dhe 20, ose ka pasur një ndryshim në përdorim ku nuk përdoret më vetëm për mbarështimin e zogjve, pezullon ose tërheq miratimin e këtij stabilimenti.

2. Kur shërbimi veterinar ka marrë një njoftim, për dyshim të gripit të shpendëve, *Newcastle* ose *Chlamydophila psittaci*, ajo pezullon miratimin e stabilimentit të mbarështimit, derisa dyshimi zyrtarisht të përjashtohet.

Shërbimit veterinar rajonal merr masat e nevojshme për të konfirmuar ose përjashtuar dyshimin në mënyrë që të shmangët çdo përhapje e sëmundjes, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore në fuqi, që rregullojnë masat që duhen ndërmarrë ndaj sëmundjes në fjalë dhe mbi tregtinë e kafshëve.

3. Kur konfirmohet sëmundja e dyshuar, autoriteti kompetent mund ta miratojë njësinë e mbarështimit në përputhje me nenin 19, si vijon:

a) është çrrënjësuar sëmundja dhe burimi i infeksionit në stabilimentin e mbarështimit;



b) pastrimin dhe dezinfektimin e përshtatshëm të stabilimentit të mbarështimit;

c) përmbushjen e kushteve të përcaktuara në nenin 19, me përjashtim të pikës 4.

4. Shërbimi veterinar njoftojnë menjëherë ministrinë për pezullimin, tërheqjen ose rimarrjen e miratimit të çdo stabilimenti mbarështimi.

Neni 23

Ndërtimi dhe pajisja e objekteve apo qendrave të karantinës

1. Njësia ose qendra karantinore duhet të jetë një ndërtesë/a të cilat janë të ndara nga ndërtesat e tjera të shpendëve dhe zogjve me një distancë të përcaktuar, bazuar në një vlerësim risku i cili merr parasysh epidemiologjinë e gripit të shpendëve dhe sëmundjes së *Newcastle*. Dyert hyrëse/dalëse duhet të jenë të mbyllshme me shenja që tregojnë: “KARANTINË” – nuk pranohen personat e paautorizuar.

2. Çdo njësi karantine e qendrës karantinore duhet të zërë një hapësirë ajrore të ndarë.

3. Objekti ose qendra e karantinës së zogjve, duhet të jetë e siguruar nga zogjtë e egër dhe agjentëve parazitarr, si dhe të jetë e mbyllur në mënyrë që të lejojë fumigimin.

4. Objekti i karantinës së aprovuar dhe secila njësi e një qendre karantine të aprovuar duhet të pajiset me pajisje për larjen e duarve.

5. Dyert e hyrjes dhe daljes në objektin e miratuar të karantinës dhe secilës njësi të një qendre karantine të aprovuar duhet të kenë sisteme me dy dyer.

6. Barrierat e higjienës duhet të instalohen në të gjitha hyrjet/daljet në objektin e miratuar të karantinës dhe në njësitë e ndryshme të një qendre karantine të miratuar.

7. Të gjitha pajisjet duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që të mund të pastrohen dhe të dezinfektohen.

8. Magazinat e ushqimit të zogjve duhet të sigurohen që të jenë të lirë nga brejtësit dhe të jetë e mbrojtur nga insektet.

9. Të disponohet një kontejner për vendosjen e mbeturinave i cili të jetë i mbyllur dhe i papërshkrueshëm nga zogjtë dhe brejtësit.

10. Të kenë një frigorifer dhe/ose ngrirës për mbajtjen e karkasave.

Neni 24

Kërkesat e menaxhimit

1. Objektet dhe qendrat e karantinës së aprovuar, duhet:

a) të kenë një sistem efikas kontrolli për të siguruar mbikëqyrje adekuatë të kafshëve;

b) të jenë nën kontrollin dhe përgjegjësinë e veterinerit zyrtar;

c) të pastrohen dhe të dezinfektohen në përputhje me programin e miratuar pas të cilit do të ketë një periudhë pushimi të përshtatshme;

d) dezinfektantët e përdorur duhet të jenë të aprovuar për këtë qëllim.

2. Për secilën ngarkesë të zogjve të karantinuara:

a) objekti ose njësia e miratuar e karantinës e një qendre karantine të miratuar duhet të pastrohet dhe dezinfektohet dhe pastaj të mbahet e lirë nga zogjtë për të paktën shtatë ditë përpara se të futen zogjtë e importuar;

b) dërgesa e zogjve duhet të vijë nga një njësi e vetme e miratuar e mbarështimit në vendin e origjinës dhe të futet brenda një periudhe jo më të gjatë se 48 orë;

c) periudha e karantinës duhet të fillojë kur të futet zogu i fundit;

d) objekti i miratuar i karantinës ose njësia e një qendre karantine të aprovuar duhet të zbrazet nga zogjtë, të pastrohet dhe të dezinfektohet në fund të periudhës së karantinës.

3. Duhet marrë masa paraprake për të parandaluar kontaminimin e kryqëzuar ndërmjet ngarkesave hyrëse dhe dalëse.

4. Personat e paautorizuar nuk duhet të hyjnë në objektin ose qendrën karantinore të miratuar.

5. Personat që hyjnë në objektin ose qendrën karantinore të miratuar duhet të veshin rroba mbrojtëse duke përfshirë këpucë.

6. Nuk duhet të ketë asnjë kontakt midis personelit, gjë e cila që mund të shkaktojë ndotje midis objekteve të miratuara të karantinës ose njësive të qendrave të karantinës të aprovuara.

7. Duhet të jenë të disponueshme pajisjet e duhura për pastrim dhe dezinfektim.

8. Nëse përdoret identifikimi me anë të mikroçipit, duhet të jetë i disponueshëm një lexues i përshtatshëm i mikroçipit në objektin ose qendrën karantinore të miratuar.

9. Pastrimi dhe dezinfektimi i kafazeve ose arkave të përdorura për transport duhet të kryhet



në objektin ose qendrën karantinore të miratuar, përveç rasteve kur ato janë shkatërruar. Nëse ripërdoren, ato duhet të përbëhen nga një material që lejon pastrimin dhe dezinfektimin efektiv.

Kafazet dhe arkat duhet të shkatërrohen në mënyrë të tillë që të shmangët përhapja e agjentëve sëmundje shkaktes.

10. Mbeturinat dhe materialet e mbeturinave duhet të grumbullohen rregullisht, të ruhen në kontejnerin e mbeturinave dhe më pas të trajtohen në mënyrë të tillë që të shmangin përhapjen e agjentëve sëmundje shkaktes.

11. Karkasat e zogjve, duhet të ekzaminohen në laboratorin e referencës në ISUV.

12. Analizat dhe trajtimet e nevojshme të zogjve duhet të kryhen në konsultim me dhe nën kontrollin e veterinerit zyrtar.

13. Veterineri zyrtar duhet të informohet për sëmundjet dhe ngordhjeve e zogjve dhe/ose zogjve sentinel gjatë periudhës së karantinës.

14. Personi përgjegjës për objektin ose qendrën karantinore të miratuar duhet të mbajë një regjistër për:

a) datën, numrin dhe speciet e zogjve që hyjnë dhe dalin për secilën ngarkesë;

b) kopjet e certifikatave të shëndetit të zogjve dhe dokumenteve të zakonshme veterinarë, të hyrjes që shoqërojnë zogjtë e importuar;

c) numrat individual të identifikimit të zogjve të importuar dhe në rast të identifikimit me mikroçip detajet e llojit të mikroçipit dhe lexuesit të përdorur duhet të regjistrohen;

d) nëse në objektin e karantinës ose në qendrën e karantinës përdoren zogj sentinele, duhet të dihet numri dhe vendosja e zogjve sentinele në objektin ose qendrën e karantinës;

e) çdo vëzhgim domethënës: rastet e sëmundjes dhe numri i ngordhjeve në baza ditore;

f) datat dhe rezultatet e testeve;

g) llojet dhe datat e trajtimeve;

h) personat që hyjnë dhe dalin nga objekti ose qendra e karantinës.

15. Të dhënat e përmendura në pikën 14, duhet të mbahen për të paktën 10 vjet.

Neni 25

Pezullimi, tërheqja ose rimarrja e miratimit të objekteve dhe qendrave të karantinës

Procedurat për pezullimin e pjesshëm ose të

plotë, tërheqja ose rimarrja e lejes së miratimit të objekteve dhe qendrave të karantinës duhet të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë nen.

1. Kur Shërbimi veterinar rajonal konstaton se një strukturë apo qendër e karantinës nuk i përmbush më kushtet e përcaktuara në nenin 23 dhe 24, ose ka pasur një ndryshim, i cili nuk është më në përputhje me nenin 3, germa “g”, ai informon ministrinë për këtë fakt.

Këto objekte ose qendra të karantinës nuk duhet të përdoren për importet në përputhje me këtë rregullore.

2. Miratimi mund të rimerret vetëm nga objekte ose qendra karantine kur plotësohen përsëri kushtet e përcaktuara në nenet 23 dhe 24.

Neni 26

Ekzaminimi, marrja e mostrave dhe procedurat e testimit për gripin e shpendëve dhe sëmundjen e pseudopestit (*Newcastle*)

1. Gjatë karantinës, zogjtë sentinelë, ose nëse zogjtë sentinelë që nuk përdoren dhe zogjtë e importuar, duhet t'u nënshtrohen procedurave të mëposhtme:

a) marrjen nga zogjtë sentinelë, të:

i. mostrave të gjakut për ekzaminimin serologjik duhet të merren nga të gjithë zogjtë sentinelë jo më pak se 21 ditë pas hyrjes së tyre në karantinë dhe të paktën tri ditë para përfundimit të karantinës;

ii. nëse zogjtë sentinelë tregojnë rezultate serologjike pozitive ose të dyshimta për mostrat e përmendura në germën “I”, zogjtë e importuar duhet t'i nënshtrohen ekzaminimit viral duhet të merren të paktën 60 zogj ose të gjithë zogjtë, nëse ngarkesa është më pak se 60 zogj;

iii. në rastet kur nuk përdoren zogj sentinelë, zogjtë e importuar duhet të ekzaminohen virologjikisht (testimi serologjik nuk është i përshtatshëm). *Tampona trakeale/orofaringeale* dhe/ose *cloacale* (ose feçe) duhet të merren nga të paktën 60 zogj ose nga të gjithë zogjtë nëse ngarkesa është më pak se 60 zogj, përgjatë 7 deri në 15 ditëve të para të karantinës.

2. Përveç testeve të përcaktuara në pikën 1, duhet të merren mostrat e mëposhtme për kontrollin viral:



a) tamponët kloakal (ose feçe) dhe tamponët e trakeal/rotharyngeal, nëse është e mundur, nga zogjtë e sëmurë klinikisht ose zogjtë sentinelë të sëmurë;

b) përmbajtje të zorrëve, trurit, trakesë, mushkërive, mëlçisë, shpretkës, veshkave dhe organeve të tjera klinikisht të prekura sa më shpejt që të jetë e mundur pas vdekjes nga:

i. zogjtë sentinelë të ngordhur dhe të gjithë zogjtë e ngordhur në mbërritje dhe ata që ngordhin gjatë karantinës; ose

ii. në rastin e vdekshmërisë së lartë në zogjtë e vegjël të dërgesave të mëdha nga të paktën 10% e zogjve të ngordhur.

3. Të gjitha testimet virologjike dhe serologjike të mostrave të marra gjatë karantinës duhet të kryhen në laboratorët e ISUV-së duke përdorur procedurat diagnostike në përputhje me manualin diagnostik për gripin e shpendëve dhe Manualin e

Testimeve Diagnostike dhe Vaksinave për Kafshët Tokësore të OIE-së për sëmundjen e *Newcastle*. Për ekzaminimin virologjik lejohet bashkimi i mostrave deri në maksimum prej pesë mostra të zogjve individual në një kampion. Materiali fekalor duhet të grumbullohet e ndahet nga mostrat e tjera të organeve dhe indeve.

4. Izolimet e virusit duhet të dorëzohen në laboratorin kombëtar të referencës ISUV.

ANEKSI I


LISTA E VENDEVE TË TRETA NGA TË CILAT AUTORIZOHEN IMPORTET E ZOGJVE TË KAFAZIT TË MBARËSHTUAR:

1. Tabela 1;
2. Argjentina;
3. Filipine: Rajoni i kryeqytetit.

ANEKSI I

Lista e vendeve të treta, territoreve, zonave ose kompartimenteve

Kodi ISO dhe emri i vendit të tretë ose territorit	Kodi i vendit të tretë, territorit, zones ose kompartimentit	Përshkrimi i vendit të tretë, territorit, zones ose kompartimentit	Certifikata Veterinare		Kushtet specifike	Kushtet specifike		Statusi i survejancës për Influençën Aviare	Statusi i vaksinimit për Influençën Aviare	Statusi i kontrollit të Salmonelës
			Modeli	Garancitë shtesë		Data e mbylljes	Data e hapjes			
1	2	3	4	5	6	6A	6B	7	8	9
AL — Shqipëria	AL-0	I gjithë vendi	EP, E							
AR — Argjentinë	AR-0	I gjithë vendi	SPF					A		
			POU, RAT, EP, E							
			WGM	VIII						
AU — Australi	AU-0	I gjithë vendi	SPF							P1
			EP, E							
			BPP, DOC, HEP, SRP							
			BPR	I						
			DOR	II						
			HER	III						
BR — Brazil	BR-0	I gjithë vendi	SPF							
	BR-1	Shteti i: Rio Grande do Sul, Santa Catarina, Paraná, São Paulo and Mato Grosso do Sul	RAT, BPR, DOR, HER, SRA							P1
	BR-2	Shteti i: Mato Grosso, Paraná, Rio Grande do Sul, Santa Catarina and São Paulo	BPP, DOC, HEP, SRP							



			Rrethi Federal dhe Shteti i	WGM	VIII					
	BR-3		Goiás, Minas Gerais, Mato Grosso do Sul, Paraná, Rio Grande do Sul, Santa Catarina and São Paulo	EP, E						
BW — Botswana	BW-0	I gjithë vendi		SPF						
				EP, E						
				BPR	I					
				DOR	II					
				HER	III					
				RAT	VII					
				SPF						
				EP, E						
CA — Kanada	CA-0	I gjithë vendi		BPR, BPP, DOC, DOR, HEP, HER, SRA, SRP						
				WGM	VIII					
				RAT						
CH — Zvicër	CH-0	I gjithë vendi		(3)						
				SPF						
				EP, E,						P1
CL — Kili	CL-0	I gjithë vendi		BPR, BPP, DOC, DOR, HEP, HER, SRA, SRP						
				WGM	VIII					
				RAT						
CN — Republika Popullore e Kinës	CN-0	I gjithë vendi		EP						
	CN-1	Provinca e Shandong		E		P2	6.2.2004	—		
GL — Greenland	GL-0	I gjithë vendi		SPF						
				EP, WGM						
HK — Hong Kong	HK-0	I gjithë territori Rajonit Administrativ të Hong Kong Special		EP						



HR — Kroacia	HR-0	I gjithë vendi	SPF BPR, BPP, DOR, DOC, HEP, HER, SRA, SRP EP, E, RAT, WGM								P1
IL — Izrael	IL-0	I gjithë vendi	SPF BPR, BPP, DOC, DOR, HEP, HER, SRP WGM EP, E, RAT EP							A	
IN — India	IN-0	I gjithë vendi	SPF								
IS — Island	IS-0	I gjithë vendi	WGM EP, E, RAT EP, E								
KR — Kore	KR-0	I gjithë vendi	EP, E								
ME — Mali i Zi	ME-0	I gjithë vendi	EP								
MG — Madagaskar	MG-0	I gjithë vendi	SPF EP, E, WGM								
MY — Malajzi	MY-0	—	— EP								
	MY-1	I gjithë territory i Western Peninsular	E				P2	6.2.2004			
Maqedonia											
MX — Meksika	MX-0	I gjithë vendi	SPF EP								
NA — Namibia	NA-0	I gjithë vendi	SPF BPR DOR HER RAT, EP, E								
NC — Kaledonia e Re	NC-0	I gjithë vendi	EP								
NZ — Zeelanda e Re	NZ-0	I gjithë vendi	SPF BPR, BPP, DOC, DOR, HEP, HER, SRA, SRP WGM EP, E, RAT								P1



PM — St Pierre dhe Miquelon	PM-0	Whole country	SPF						
RS — Serbia ⁽⁵⁾	XS-0 ⁽⁵⁾	I gjithë vendi	EP						
RU — Federata Ruse	RU-0	I gjithë vendi	EP						
SG — Singapor	SG-0	I gjithë vendi	EP						
TH — Tailandia	TH-0	I gjithë vendi	SPF, EP						
			WGM	VIII	P2	23.1.2004			
			E, RAT		P2	23.1.2004			
			SPF						
TN — Tunizia	TN-0	I gjithë vendi	DOR, BPR, BPP, HER						
			WGM	VIII					
			EP, E, RAT						
			SPF						
TR — Turqia	TR-0	I gjithë vendi	E, EP						
			SPF						
US — Shtetet e Bashkuara të Amerikës	US-0	I gjithë vendi	BPR, BPP, DOC, DOR, HEP, HER, SRA, SRP						
			WGM	VIII					
			EP, E, RAT						
UY — Uruguai	UY-0	I gjithë vendi	SPF						
			EP, E, RAT						
			SPF						
			EP, E						
ZA — Afrika e Jugut	ZA-0	I gjithë vendi	BPR	I					
			DOR	II					
			HER	III					
			RAT	VII					
			RAT	VII					
			EP, E						
ZW — Zimbabve	ZW-0	I gjithë vendi							

(1) Mallrat, përfshirë edhe ato të transportuara në dete të larta, të prodhuara para kësaj date mund të importohen në Komunitet gjatë një periudhe prej 90 ditësh nga kjo datë.

(2) Vetëm mallrat e prodhuar pas kësaj date mund të importohen në Komunitet.

(3) Certifikatat në përputhje me marrëveshjen midis Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane për tregtinë e produkteve bujqësore (OJ L 114, 30.4.2002, f. 132 i ndryshuar së fundmi).

**Modeli i certifikatave veterinare****Modeli:**

- ‘BPP’: Modeli i certifikates veterinare për rritje dhe prodhim të shpendëve ose zogjve joflaturues
- ‘BPR’: Modeli i certifikates veterinare për rritje ose prodhim i zogjve joflaturues
- ‘DOC’: Modeli i certifikates veterinare për shpenët 1-ditor ose zogjve joflaturues
- ‘DOR’: Modeli i certifikates veterinare për shpendët 1-ditor të zogjve joflaturues
- ‘HEP’: Modeli i certifikates veterinare për shpendët për vezë ose i zogjve joflaturues
- ‘HER’: Modeli i certifikates veterinare për shpendët për vezë të zogjve joflaturues
- ‘SPF’: Modeli i certifikates veterinare për pategjenët specifik të lire të vezve
- ‘SRP’: Modeli i certifikates veterinare për shpendët për therje dhe zogjve të zbukurimit ose zogjve joflaturues
- ‘SRA’: Modeli i certifikates veterinare për therjen e zogjve joflaturues
- ‘POU’: Modeli i certifikates veterinare për mishin e shpendëve
- ‘POU-MI/MSM’: Modeli i certifikates veterinare për mishin e grirë dhe mishin e ndarë mekanikisht të shpendëve
- ‘RAT’: Modeli i certifikates veterinare për mish i zogjve joflaturues të fermave për konsum human
- ‘RAT-MI/MSM’: Modeli i certifikates veterinare për mishin e grirë dhe mishin e ndarë mekanikisht për konsum human i zogjve joflaturues i fermave
- ‘WGM’: Modeli i certifikates veterinare për mish i zogjve të egër
- ‘WGM-MI/MSM’: Modeli i certifikates veterinare për mishin e grirë dhe të ndarë mekanikisht i zogjve të egër
- ‘E’: Modeli i certifikates veterinare për vezë



‘EP’: Modeli i certifikates veterinare për produktet e vezëve

Garancitë Shtesë (AG):

‘I’: Garancitë për rritjen dhe prodhimin e zogjve joflaturues që vijnë nga vendet e treta, territoret ose zonat jo të lira nga Pseudopesti (Newcastle), e certifikuar në përputhje me modelin e certifikatës BPR

‘II’: Garancitë për zogjtë 1-ditor të zogjve joflaturues që vijnë nga vendet e treta, territoret ose zonat jo të lira nga Pseudopesti (Newcastle), e certifikuar në përputhje me modelin e certifikatës DOR

‘III’: Garancitë për shpendët për venzë të zogjve joflaturues që vijnë nga vendet e treta, territoret ose zonat jo të lira nga Pseudopesti (Newcastle), e certifikuar në përputhje me modelin e certifikatës HER

‘IV’: Garancitë për therjen e zogjve joflaturues që vijnë nga vendet e treta, territoret ose zonat jo të lira nga Pseudopesti (Newcastle), e certifikuar në përputhje me modelin e certifikatës SRA

‘V’: Garancitë shtesë që mbulojnë mishin e fermave të zogjve joflaturues për konsum për njerzit, certifikuar në përputhje me modelin e certifikatës RAT

‘VI’: Garancitë shtesë për mishin e zogjve të egër certifikuar në përputhje me modelin e certifikatës WGM



ANEKSI II

Certifikata e shëndetit të kafshëve, siç referohet në germën “F”, të nenit 5, për importet e zogjve të caktuar

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË HEALTH CERTIFICATE FOR MOVEMENTS OF PET BIRDS CERTIFIKATA SHËNDETËSORE PËR LËVIZJEN E ZOGJVE TE SHOQËRIMIT					
Part I : Details of consignment / Pjesa I : detaje te dorezimit	I.1. Consignor Dërguesi Name Emri Address Adresa Tel.No Nr Tel.		I.2. Certificate reference num. Numri i referencës së Çertifikates		I.2a.
			I.3. Central competent Authority Autoriteti Kompetent Qëndror		
			I.4. Local Competent Authority Autoriteti Kompetent Lokal		
	I.5. Consignee Marrësi Name Emri Address Adresa Postal code Kodi postar		I.6		
	I.7. Country of origin Shteti i origjinës	ISO code kodi ISO	I.8. Region of origin Rajoni i origjinës	I.9. Country of destination Shteti i destinacionit	I.10
	I.11. Place of origin Vendi i origjinës Holding ☐ Stabilimenti Name Emri		I.12. Place of destination vendi i destinacionit Name Emri Address Adresa		Approval number Numri i Aprovimit
	I.13. Place of loading Vendi i ngarkesës Address Adresa		I.14. Date of departure Data e nisjes		Time of departure Koha e nisjes
	I.15. Means of transport Mjeti i transportit Aeroplane ☐ Aeroplan ☐ Road vehicle ☐ Automjet ☐ Identification : Identifikimi		I.16. Entry border inspection post (BIP) Hyrja nw Pikën e Inspektimit Kufitar (PIK) I.17. No.(s) of CITES Nr. i qyteteve		
	I.18. Description of commodity Përshkrimi i mallit/artikullit		I.19. Commodity code (HS code) Kodi i mallit/artikullit (kodi HS)		
	I.21.		I.22. Number of packages Numri i pakove		I.24.
I.23. Identification of container/Seal number Identifikimi i kontenerit /numri i vules		I.25. Commodity certified for : ☐ Mall i çertifikuar për:		Quarantine Karantinë	
I.26.		I.27. For import or admission into AL ☐ Për import dhe dërgim në			
I.28. Identification of the commodity Identifikimi i mallit Species (scientific name) Speciet (emri shkencor)		Identification system Sistemi i identifikimit	Identification Number Numri i identifikimit	Quantity Sasia	



Part II / Pjesa II : Certification / Pjesa II : Çertifikata

II. 1 Health information Informacion shëndetësor	II.a. Certificate reference number Çertifikate me numer reference	II.b.
--	---	--------------

I, undersigned official veterinarian of.....(insert name of third country) certify that:
 Unë, i nënshkruari veteriner zyrtar i.....(emri i vendit të tretë) çertifikoj që:

II.1.1. The birds have been kept in a breeding establishment approved by the competent authority for that purpose on the territory of the exporting country for at least 21 days or since hatching.
 Zogjtë janë mbajtur në një stabiliment mbarështimi të aprovuar nga autoriteti kompetent për atë qëllim në territorin e vendit eksportues për të paktën 21 ditë ose që nga dita e shtrimit të vezëve për inkubim.

II.1.2. The birds are captive bred (the birds have not been caught in the wild and have been born and bred in captivity from parents that mated or had gametes otherwise transferred in captivity).
 Zogjtë janë mbajtur në kafaze (zogjtë nuk janë kapur të egra, janë lindur dhe mbajtur në kafaze dhe janë origjinuar nga prindërit që janë çiftëzuar në kafaze).

II.1.3 The birds described in point I.28 have been subjected either today, within 48 hours, or on the last working day prior to dispatch, to a clinical inspection and found free of obvious signs of disease
 Zogjtë e përshkruar në pikën I.28 i janë nënshtruar sot ose brenda 48 orëve ose një ditë para nisjes, inspektimit klinik dhe kanë rezultuar të lire nga shenjat e dukshme të sëmundjes.

II.1.4 Newcastle disease and avian influenza in poultry and other birds kept in captivity and psittacosis in psittaciforms ⁽¹⁾ are notifiable diseases.
 Sëmundja e Newcastle dhe Influenca aviare në shpendë dhe zogjëve të tjerë të mbajtur në kafaze dhe psitakoza në Psitaciformët (Papagajtë) ⁽¹⁾ janë sëmundje të raportueshme.

II.1.5 The birds come from a holding, which is not under animal health restrictions in connection with any diseases referred to in II.1.4.
 Zogjtë vijnë nga stabilimente, të cilat nuk janë nën kufizime të shëndetit të kafshëve në lidhje me çdo sëmundje të përmendur në pikën II.1.4.

II.1.6 Avian Influenza and Newcastle disease outbreaks have not been notified either in the holding of origin or in surrounding area within a radius of 10 km for at least 30 days.
 Shpërthime të sëmundjes së Influenca aviare dhe Newcastle nuk janë njoftuar në stabilimentin e origjinës ose zones përreth me rreze 10 km për të paktën 30 ditë.

II.1.7 Only in the case of psittaciforms (1): outbreaks of psittacosis have not been reported in the breeding establishment during the last 60 days.
 Vetëm në rastin e Psitaciformëve (1); shpërthimet e psitakozës nuk janë raportuar në stabilimentin e mbarështimit gjatë 60 ditëve të fundit.

II.1.8 The birds were subjected to a laboratory virus detection test 7 to 14 days prior to shipment with negative results for any avian influenza and Newcastle disease virus.
 Zogjtë janë analizuar nga laboratorit me testin e dedektimit të virusit, 7 deri 14 ditë para dërgesës, ku kanë rezultuar negative për praninë e virusit e sëmundjes së Newcastle dhe Influenca Aviare.

II.1.9 The birds have not been vaccinated against avian influenza
 Zogjtë nuk janë vaksinuar kundër Influenca Aviare.

II.1.10. The birds have:
 Zogjtë :

(2) [not been vaccinated against Newcastle Disease.]
 [nuk janë vaksinuar kundër sëmundjes Newcastle.]

or
 ose

(2) [have been vaccinated against Newcastle Disease using:
 [janë vaksinuar ndaj sëmundjes Newcastle duke përdorur:

.....

.....

(name and type (live or inactivated) of Newcastle disease virus strain used in vaccine(s)) at age ofweeks.]
 (emri dhe tipi (e gjallë ose e inaktivizuar) lloji i virusit të sëmundjes së Newcastle të përdorur në vaksinë në moshënjavë.]

II.2 Transport of the birds
 Transporti i zogjve

II.2.1 In case of CITES- listed species the birds will be transported according to 'CITES guidelines for transport'.
 Në rastin e specieve të listës CITES, zogjtë do të transportohen sipas 'udhëzimeve të transportit CITES'.

II.2.2 The birds described in this certificate are transported in crates or cages, which:
 Zogjtë e përshkruar në këtë çertifikatë janë transportuar me arka ose kafazë, të cilat:



- (a) **Contain only birds coming from the same breeding establishment**
Përbajnë zogj të ardhur nga i njëjti stabiliment
- (b) **Contain only birds of the same species or which consist of different compartments, each compartment containing only birds of the same species;**
Përbajnë vetëm zogj të së njëjtës specie ose të cilat konsistojnë në ndarje të ndryshme, ku çdo ndarje përmban vetëm zogj të së njëjtës specie;
- (c) **bear the name and the address of establishment of origin and specific registration number of the establishment and a specific identification number of the individual crate or cage;**
mbajnë emrin dhe adresën e stabilimentit të origjinës dhe numrin specifik të regjistrimit të stabilimentit dhe një numër specifik identifikimi i arkës ose kafazit individual;
- (d) **are constructed in such a way so as to :**
Janë të ndërtuar në atë mënyrë ku:
- (i) **Preclude the loss of excrement and to minimize the loss of feathers during transport;**
(i) Parandalojnë daljen e jashtëqitjes si dhe minimizojnë mundësinë e humbjes së pendëve gjatë transportit;
 - (ii) **Allow visual inspection of the birds;**
(ii) Lejon inspektimin vizual të zogjve;
 - (iii) **Allow cleansing and disinfection;**
(iii) Lejojnë pastrimin dhe dezinfektimin;

II.a. Certificate reference number
Çertifikatë me numër reference

II.b.

- (e) **are being used for the first time and have been, as well as the vehicle in which they are loaded, cleaned and disinfected before loading in accordance with the instructions of the competent authority;**
janë përdorur për herë të parë, si dhe automjeti që janë transportuar ka qënë i pastruar dhe dezinfektuar përpara ngarkimit, në përputhje me instruksionet e autoritetit kompetent;
- (f) **in the case of air transport, are at least in accordance with the most recent IATA (International Airline Transport Association) rules governing the transport of live animals,**
në rastin e transportit ajror, janë në përputhje me rregullat më të hershme të IATA (Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror) që rregullon transportin e kafshëve të gjalla,

Notes Shënime

Part I Pjesa I

- **Box reference : I.11: Place of origin: the holding can only be a breeding establishment according to the definition of Commission Implementing Regulation (EU) No 139/2013.**
Kutia me nr.reference : I.11: Vendi i origjinës: mbajtja mund të jetë vetëm një stabiliment mbarështimi sipas definicionit të Rregullores Implementuese e Komisionit (BE) Nr 139/2013.
- **Box reference I.15: Registration number (railway wagons or containers and lorries), flight number (aircraft) or name (ship). Separate information is to be provided in the event of unloading and reloading.**
Kutia me nr.reference I.15: Numri i regjistrimit (vagonë hekurudhor ose kontejnerë dhe kamionë), numri i fluturimit (aeroplanët) ose emri (anija). Duhet të sigurohet informacion i veçantë në rast të shkarkimit dhe ngarkimit të tij.
- **Box reference I.19 : use the appropriate HS codes : 01.36.31,01.06.32,01.06.39**
Kutia me nr.reference I.19: përdorni kodet e duhura HS: 01.36.31,01.06.32,01.06.39
- **Box reference I.23: Identification of container: each crate/cage/compartment must be identified.**
Kutia me nr.reference I.23: Identifikimi i kontejnerit: çdo arkë / kafaz / ndarje duhet të identifikohet.

Part II Pjesa II

- (a) **Only applicable in case of psittaciforms**
E aplikueshme vetëm në rastet e Psitaciformëve
- (a) **Keep as appropriate.**
Mbajeni sic duhet..
- **Note for the importer: this certificate is only for veterinary purposes and has to accompany the consignment until it reaches the border inspection post,**
Shënim për importuesin: kjo certifikatë është vetëm për qëllime veterinare dhe duhet të shoqërojë dërgesën derisa të arrijë në pikën e inspektimit kufitar,
- **After the import control at the border inspection post, this consignment must be transported directly to an approved quarantine facility or centre,**
Pas kontrollit të importit në pikën e inspektimit kufitar, kjo dërgesë duhet të transportohet direkt në një strukturë ose qendër të aprovuar karantine,
- **The certificate is valid for 10 days. In case of transport by boat the validity is prolonged by the time of the sea voyage,**
Certifikata është e vlefshme për 10 ditë. Në rastin e transportit me anije, vlefshmëria zgjatet me kohën e udhëtimit të detit,

Official veterinarian or official inspector Veterineri zyrtar ose inspektori zyrtar

Name (in capital letters):
Emri (me gema kapitale)

Qualification and title:
Kualifikimi dhe titulli

Local veterinary unit:
Njësia veterinare lokale

Date:
Data

Signature:
Firma

Stamp
Vula

**VENDIM****Nr. 210, datë 18.12.2019****MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“WONDER” SHPK DHE KËRKESËN E
SHOQËRISË “HYDROPOWER-SAS”
SHPK PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT
TË BORDIT TË ERE-s NR. 171,
DATË 7.11.2019**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 3, pika 7, germa “a” dhe germa “b”, nenit 33, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 7, pika 1, të “Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave”, nenit 17 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 114/12 prot., datë 10.12.2019, e përparitur nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Drejtoria e Licencimit, Autorizimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Wonder” sh.p.k. dhe kërkesën e shoqërisë “Hydropower-SAS” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 7.11.2019,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 171, datë 7.11.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur të mosfillojë procedurën për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë koncesionare “Energo-SAS” sh.p.k., me nr. 41, seria NPM06K, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 27.11.2006, për një afat 30-vjeçar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Sasaj”, të shoqëria “Hydropower-SAS” sh.p.k., mbështetur në dokumentet e aplikimit dhe relacionin e përparitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes.

- Në kuptim të sa më sipër, shoqëria “Hydropower-SAS” sh.p.k., me shkresën nr. 6 prot., datë 19.11.2019, protokolluar në ERE me nr. 562/3 prot., si dhe shoqëria “Wonder” sh.p.k., me shkresën nr. 292 prot., datë 19.11.2019, protokolluar në ERE me nr. 562/4 prot., datë 21.11.2019, kanë paraqitur në ERE kërkesën për

rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 7.11.2019, me arsyetimin se ky vendim është marrë mbi bazë të analizave të gabuara ligjore, duke keqinterpretuar pozitën e kërkuarit, koncesionarit “Wonder” sh.p.k., pronar i koncesionit, vetëm si ortak i shoqërisë koncesionare, si dhe në kundërshtim me nenin 12.5 të licencës që posedon shoqëria “Energo-SAS” sh.p.k., ku përcaktohet taksativisht heqja e licencës “nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksioneri që kontrollon interesat ndryshohet pa një autorizim të veçantë nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe e anulueshme dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënien e licencave”.

- Referuar nenit 3, pika 7, germa “a” dhe germa “b”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, “Palë” është:

a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose

b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj të ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.

- Siç referon kjo dispozitë, në nenin 33 të ligjit nr. 44/2015, përcaktohet si vijon:

1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedurës administrative.

Në kushtet e konstatimeve të mësipërme dhe në zbatim të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, duke qenë se shoqëritë “Wonder” sh.p.k. dhe “Hydropower SAS” sh.p.k., kanë paraqitur të njëjta pretendime, në kuptim të këtij vendimi i referohemi si ankimesit dhe shpjegojmë si në vijim.

- Ankimesit pretendojnë se është keqinterpretuar pozicioni i kërkuarit, koncesionarit “Wonder” sh.p.k., duke u trajtuar vetëm si ortak i shoqërisë koncesionare.

- Referuar përcaktimeve ligjore të nenit 17, pika 1, të rregullores së sipërcituar, e vetmja palë që



legitimohet (legjitimiteti aktiv) për të kërkuar transferimin e plotë ose të pjesshëm të një licence të dhënë nga ERE, është pala e licencuar, pra pala që e ka fituar tashmë këtë të drejtë dhe është mbajtëse e licencës, kjo dhe në zbatim të përkufizimeve të nenit 3 të kësaj rregulloreje, ku përcaktohet se “i licencuar” do të thotë një person i pajisur me licencë për aktivitete të energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Pretendimi për keqinterpretimin e pozitës së shoqërisë “Wonder” sh.p.k., nuk qëndron, sepse të qenit i licencuar si shoqëri nga ERE, është parakusht për të nisur procedurën për një transferim licence.

- Ankimuesit pretendojnë se vendimi nr. 171, datë 9.11.2019, është marrë në kundërshtim me nenin 12.5 të licencës që gëzon shoqëria “Energo-SAS” sh.p.k., ku përcaktohet taksativisht heqja e licencës “nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksioneri që kontrollon interesat ndryshohet pa një autorizim të veçantë nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe e anulueshme dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënien e licencave”.

- Në këtë rast, para se të aplikohen procedurat për shpalljen të pavlefshme ose të anulueshme të licencës (ndryshimi i statusit ligjor dhe aksionerit që kontrollon interesat), duhen analizuar dy kushtet e vendosura në licencë, për ndryshimin e të cilave shoqëria është e detyruar, sipas rastit, të raportojë/të marrë miratimin në ERE dhe rastet e shkeljes së tyre.

- Në bazë të nenit 4, pika 4.6, germa “F”, të licencës me nr. 41, seria NPM06K, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 27.11.2006, mbajtëse e së cilës është shoqëria “Energo-SAS” sh.p.k., “i licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për ndryshimin e strukturës së aseteve mbi 10%”.

- Nga sa konstatuar, shitja e 26.5% të kuotave të shoqërisë “Energo-SAS” sh.p.k., e realizuar nëpërmjet kontratës nr. 1592 rep., nr. 704 kol, datë 23.4.2014, nuk është raportuar në ERE, në referim dhe zbatim të kushteve të licencës, gjë e cila është evidentuar dhe cituar më herët nga ana jonë në informacionin relatuar në mbledhjen e datës 14.10.2019.

- Në lidhje me shitblerjen e aksioneve të paraportuar nga shoqëria “Energo-SAS”, në zbatim të detyrimeve të kushteve të licencës dhe masat përkatëse që mund të zbatohen në rast shkeljesh të këtyre kushteve, sqarojmë si vijon:

Në nenet 106 dhe 107, pika 1, germa “I”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohet si më poshtë:

- Neni 106: ERE, në përmbushje të detyrimeve të saj, sipas nenit 19, të këtij ligji, në bazë të fakteve të siguruara për shkeljen e dispozitave të këtij ligji, mund të vendosë fillimin e hetimit administrativ për këto shkelje të evidentuara.

- Neni 107:1. Shkeljet e mëposhtme, të kryera prej të licencuarve, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen nga ERE me gjobë nga 0,1 për qind deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit: shkelja e detyrimeve dhe kushteve të licencës, si dhe rregullave të ERE-s që nuk janë përmendur në pikat e mësipërme.

- ERE mund të fillojë një hetim për ndëshkim me gjobë, në rastet kur:

a) ka marrë kryesisht dijeni për një shkelje;

b) vihet në dijeni nga një i licencuar tjetër apo nga një subjekt i interesuar për një shkelje;

c) ka dyshimin e arsyeshëm se kushtet e licencës janë shkelur.

- Në referim të nenit 7, “Shqyrtimi fillestar”, pika 1, të rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave, parakusht i nisjes së një procedure hetimi për vendosje gjobe për një nga shkeljet e përcaktuara në këtë rregullore është fakti që kjo shkelje nuk duhet të jetë parashkruar. se: ERE nuk mund të vendosë për fillimin e një procedure për vendosje gjobe, nëse shkelja e pretenduar apo konstatuar pas hetimit rezulton se ka më shumë se 5 vjet që ka ndodhur.

- Kontrata e shitjes së kuotave, me nr. 1592 rep., nr.704 kol., mban datën 23.4.2014 (ky fakt i konstatuar edhe më herët), në zbatim të nenit 4, pika 4.6, germa “F”, të licencës me nr. 41, seria NPM06K, shoqëria “Energo-SAS” sh.p.k., ka pasur detyrimin që brenda 10 ditëve, pra brenda datës 5.5.2014, të njoftonte ERE-n mbi këtë ndryshim të strukturës së aseteve që kalon masën 10%.

- ERE ka evidentuar këtë lëvizje të aksioneve vetëm pas paraqitjes së kërkesës së koncesionarit “Wonder” sh.a. për transferim të licencës, kërkesë e



cila mban datën 16.9.2019, vlerësohet se jemi në kushtet ku ERE nuk mund të niste apo të nisë një procedurë për vendosje gjobe a ndëshkim të shoqërisë, për arsye se në çastin e marrjes dijeni të shkeljes kanë kaluar 5 vjet nga koha kur kjo shkelje ka ndodhur (përlllogaritja e afateve të parashkrimit ka filluar më 6.5.2014) dhe kjo shkelje është parashkruar tashmë.

- Referuar nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, kjo shitblerje aksionesh është evidentuar dhe në informacionin e relacionin përkatës argumentues mbi kërkesën e shoqërisë “Wonder” sh.p.k., në vijim të të cilit është marrë dhe vendimi i Bordit të ERE nr. 171, datë 7.11.2019, dhe në këtë kontekst nuk përbën provë të re, për të ndërmarrë iniciativën ligjore për rishikimin e këtij vendimi, ndaj edhe ky pretendim i shoqërisë “Wonder” sh.p.k., nuk qëndron.

- Ankimuesit pretendojnë se në marrjen e vendimit nr. 171, datë 7.11.2019, është arsyetuar gabim dhe në kundërshtim me dokumentet e koncesionit, si dhe qëndrimet e OSHA-së, lidhur me shitblerjen e kuotave në shoqërinë “Energo-SAS” sh.p.k.

- Pjesë përbërëse e këtij aplikimi është bërë dhe shkresa nr. 6070/1 prot., datë 2.7.2019, me lëndë “Kthim përgjigje”, e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, drejtuar shoqërisë “Wonder” sh.p.k., ku ndër të tjera shprehet se “Bazuar në nenin 5 dhe 26, të marrëveshjes së koncesionit, miratuar me VKM-në nr. 501, datë 23.7.2004, MIE, si pjesë e OSHA-së ka detyrimin për t’iu mbështetur dhe për këtë shkak jep mbështetjen e saj për pajisjen e koncesionarit “Wonder” sh.p.k., me licencë për prodhimin e energjisë elektrike”.

- Theksojmë se tashmë ndodhemi përpara faktit të kryer, ku koncesionari, pas marrjes së koncesionit, në zbatim të dispozitave përkatëse dhe detyrimeve të përcaktuara në nenin 4 të Marrëveshjes së Koncesionit, miratuar me VKM-në nr. 501, datë 23.7.2004, “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOO”, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, si organ shtetëror i autorizuar (OSHA), dhe shoqërisë “Wonder” sh.p.k. për ndërtimin e hidrocentralit të Sasaj”, brenda afatit të përcaktuar prej 30 ditësh ka krijuar shoqërinë koncesionare “Energo-SAS” sh.p.k. Kjo shoqëri më pas ka

aplikuar në ERE për licencë dhe aktualisht është mbajtëse e licencës nr. 41, seria NPM06K, dhënë me vendimin e Bordit nr. 83, datë 27.11.2006 dhe modifikuar më tej, me vendimin nr. 6, datë 16.1.2012.

- Në këto kushte, janë ezauruar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja koncesionare, ndaj nuk rezulton që shoqëria “Hidropower SAS” sh.p.k., të jetë krijuar si zbatim i detyrimit të kësaj pike të kontratës së koncesionit dhe as brenda afateve të parashikuara në këtë kontratë.

- Gjithashtu, shoqëria “Wonder” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për të paraqitur para Bordit të ERE-s direkt relatimet, qëndrimet dhe provat e saj.

- Në lidhje me këtë kërkesë dhe në bazë të neneve 10–13, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, përveç mbledhjeve lidhur me çështje që janë objekt i brendshëm i ERE-s, të gjitha mbledhjet e Bordit janë të hapura në kuptim të këtij ankimi, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

- Në këtë mbledhje, në përputhje me njoftimin e mbledhjes, të publikuar nga ERE, u paraqit përfaqësuesi i shoqërisë “Energo-Sas” sh.p.k., parashtrimet e të cilit, nuk i shërbyen kësaj vendimmarrje.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Hydropower SAS” sh.p.k., për rishikim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 7.11.2019, si të pambështetur në prova të reja, të tilla që mund të çojnë Bordin e ERE-s në ndryshimin e këtij vendimi.

2. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Wonder” sh.p.k., për rishikim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 7.11.2019, si të pambështetur në prova të reja, të tilla që mund të çojnë Bordin e ERE-s në ndryshimin e këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 211, datë 18.12.2019

**MBI SHTYRJEN E PERIUDHËS
TRANZITORE PËR BËRJEN E FAKTIVE
TË TRANSFERIMIT TË LICENCAVE TË
OPERIMIT TË SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE
SHA), TË SHOQËRIA OPERATORI I
SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA
(OSSH SHA); LICENCËS SË
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE DHE DETYRIMIT TË
SHËRBIMIT UNIVERSAL TË
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE
SHA), TË SHOQËRIA FURNIZUESI I
SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA
(FSHU SHA))”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, ghermat “c”, “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neni 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 i “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 118 prot., datë 13.12.2019, mbi shtyrjen e periudhës tranzitore deri në datën 31.12.2019, për bërjen e efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes të energjisë

elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), të shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.),

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018, vendosi:

1. Përcaktimin e një periudhe tranzitore prej 12 muajsh, për bërjen e efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), të shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.); miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018; licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të Furnizimit të Energjisë Elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), të shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 215, datë 11.10.2018.

2. Deri në përfundimin e periudhës tranzitore prej 12 muajsh, veprimtaritë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike; furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, do të vazhdojnë të kryhen nga OSHEE sh.a.

- Në lidhje me këtë vendimmarrje, ERE ka vijuar komunikimet me OSHEE sh.a. për të marrë informacion mbi këtë proces dhe së fundmi i është drejtuar me shkresën nr. 719 prot., datë 7.11.2019, me anë të së cilës i është kërkuar informacion mbi ecurinë e procesit të ndarjes së OSHEE sh.a.

- OSHEE sh.a. i është përgjigjur me shkresën nr. 23524/1 prot., datë 3.12.2019, protokolluar në ERE me nr.719/1, datë 6.12.2019, nëpërmjet së cilës i kërkon ERE shtyrjen e periudhës tranzitore deri në datën 31.12.2019, duke sqaruar se:

- në vijim të punës përgatitore të OSHEE sh.a. për procesin e ndarjes së shoqërisë, si dhe në kuadër të orientimeve, takimeve, diskutimeve të zhvilluara në zbatim të urdhrit nr. 341, datë 17.9.2019, “Për ngritjen e grupit të punës për ndarjen e OSHEE sh.a.”, të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është në pritje të ndryshimeve të nevojshme të akteve ligjore dhe nënligjore, në mënyrë që të vijohet me finalizimin e procesit të ndarjes së OSHEE sh.a. dhe që



operatorët e krijuar të jenë plotësisht operative në datën 1.1.2020.

- Duke qenë se nga ana e OSHEE sh.a. dhe MIE janë marrë masat e nevojshme për lehtësimin dhe përfundimin e procesit të ndarjes efektive të OSHEE-së, përpara janarit 2020.

- Duke marrë në konsideratë që periudha tranzitore, miratuar me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018, të Bordit të ERE-s, përfundon në datën 21.12.2019.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 164, datë 4.11.2019, është shprehur “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nga data 21.12.2019.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e periudhës tranzitore deri në datën 31.12.2019, për bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), të shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.); miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018; licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), të shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 215, datë 11.10.2018.

2. Deri në përfundimin e periudhës tranzitore, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, veprimtaritë e operimit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike; furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, do të vazhdojnë të kryhen nga OSHEE sh.a.

3. Për efekt të llogaritjes së afateve të shtrirjes së fuqisë juridike të licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.), në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, ky afat rivendoset sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë OSHEE sh.a. dhe MIE për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 212, datë 18.12.2019

MBI LLOGARITJEN E PAGESAVE RREGULLATORE PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 17, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 14, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, “Rregulloren për përcaktimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin nr. 190, datë 23.11.2017, të Bordit të ERE-s, nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, ERE, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 115/6 prot., datë 13.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2019,

konstatoi se:

- Në zbatim të përcaktimeve të legjislationit, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 23.11.2017, ka miratuar “Rregulloren për përcaktimin e pagesave rregullatore”.

- ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, por dhe të gazit natyror në përputhje me këtë rregullore.

- Duke iu referuar bazës së të dhënave të Drejtorisë së Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, rezultojnë 300 të licencuar nga ERE, të cilët janë subjekt i pagesave rregullatore sipas klasifikimit në vijim:

- Licenca prodhimi – 133;
- Licenca për prodhim eolike – 6;
- Licenca për prodhim fotovoltaike – 11;



- Licenca për transmetim të energjisë elektrike/ gazit natyror – 2;

- Licenca për shpërndarje të energjisë elektrike/ gazit natyror – 2;

- Licenca për furnizim të energjisë elektrike/ gazit natyror – 36;

- Licenca për tregtim të energjisë elektrike/ gazit natyror – 110.

- Me shkresën nr. 91 prot., datë 28.1.2019, të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror janë njoftuar për detyrimin ligjor që ata kanë për të paraqitur pranë ERE-s, brenda datës 31 janar 2019, pasqyrat financiare për vitin 2018, e më tej dorëzimin e këtyre pasqyrave konform legjislacionit në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, së bashku me raportet e auditit, brenda datës 30 qershor 2019.

- Kësaj kërkesë iu përgjigjën vetëm një pjesë e të licencuarve, duke dorëzuar pranë ERE-s pasqyrat financiare për vitin 2018.

- Në vijim, në mungesë të pasqyrave financiare për vitin 2018 prej të licencuarve, bazuar në kërkesën e sipërcituar, ERE, me anë të shkresës nr. 91/196, deri 91/349 prot., datë 27.9.2019, iu drejtua përsëri shoqërive të licencuara, të cilat nuk iu përgjigjën kërkesës paraprake, por dhe atyre të licencuarve, të cilët nuk kishin përcjellë në ERE pasqyrat financiare të audituara, duke sjellë në vëmendje të tyre tejkalimin e afatit mbi detyrimin që lind në zbatim të nenit 46, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; pikës 3, të nenit 30, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe kushteve të licencave respektive për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- Rezulton përsëri se disa subjekte nuk kanë dërguar pasqyrat financiare të audituara në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

- Gjendur në këto kushte, në zbatim të pikës 6.4, të “Rregullores për përcaktimin e pagesave rregullatore”, për të licencuarit që nuk kanë paraqitur pasqyrat financiare për vitin 2018, informacioni për llogaritjen e pagesave rregullatore është siguruar nga publikimet zyrtare (QKB), raportimet nga OSHEE sh.a. në lidhje me prodhimin e energjisë elektrike dhe raportimet e OST sh.a. mbi transaksionet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike.

- Në mungesë të publikimeve të pasqyrave financiare në QKB prej subjekteve të licencuara në

sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, për përcaktimin e pagesave rregullatore të vitit 2019, ERE është bazuar në të dhënat financiare të vitit 2017, të cilat kanë shërbyer për përcaktimin e pagesave rregullatore të vitit 2018.

- Ende rezulton se ka shoqëri që kanë zhvilluar dy ose më shumë aktivitete të licencuara e nuk kanë paraqitur ndarje të llogarive sipas aktiviteteve, ashtu sikurse kërkohet në nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe pikës 3, të nenit 30, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

- Gjatë verifikimit të pasqyrave financiare, të dërguara nga të licencuarit në përgjigje të shkresave të ERE-s, konstatohet se shumë nga të licencuarit i kanë paraqitur përsëri pasqyrat financiare të pacertifikuara sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe neni 30, pika 1, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

- Për të licencuarit që në vitin 2018 nuk kanë zhvilluar aktivitet apo që në momentin e llogaritjes së pagesës rregullatore nuk e kanë filluar aktivitetin për të cilin janë licencuar, në zbatim të dispozitave 5.2 dhe 6.3 të “Rregullores për përcaktimin e pagesave rregullatore”, pagesa rregullatore është përcaktuar në shumën fikse prej 40 mijë lekësh.

- Për të licencuarit të cilët kanë ushtruar aktivitetin e licencuar gjatë vitit 2018, llogaritja e pagesës rregullatore është kryer në zbatim të dispozitave 5.3, 6.1 dhe 6.2 të “Rregullores për përcaktimin e pagesave rregullatore”, të cilat përcaktojnë se pagesa duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar dhe llogariten në bazë të peshës specifike që zënë të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës nga aktiviteti i çdo të licencuari ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2019, sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Diferencat që rezultojnë nga pasqyrat financiare të certifikuara për vitin 2018, të



konsiderohen në llogaritjen e pagesave të rregullimit të periudhës pasardhëse.

3. Nëse i licencuari nuk kryen pagesën rregullatore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ERE ka të drejtë të aplikojë masat administrative, në përputhje me parashikimet e nenit 107, të ligjit nr. 43/2017 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

4. Drejtoria e Financës dhe IT-së të njoftojë të licencuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2019
1	“Albanian Green Energy” sh.p.k	406,603
2	“Balkan Green Energy” sh.p.k	626,702
3	“EMIHEL 2003” sh.p.k	39,453
4	“Amal” sh.p.k	27,686
5	“Spahiu Gjanç” sh.p.k.	130,641
6	“Wonder power” sh.a.	126,347
7	“Hec i Tervolit” sh.p.k	462,634
8	“HIDROALBANIA Energji” sh.p.k	511,751
9	“HEC Bishnica 1,2” sh.p.k	118,269
10	“Dishnica Energy” sh.p.k.	7,619
11	“Elektro Lubonje” sh.p.k.	4,661
12	“Selca Energji” sh.p.k.	55,480
13	“Projeksion Energji” sh.a.	40,000
14	“Sarolli” sh.p.k.	15,042
15	“Juana” sh.p.k	12,455
16	“WTS Energji” sh.p.k	8,027
17	“Marjakaj” sh.p.k	13,343
18	“Maksi Elektrik” sh.p.k	11,364
19	“Favina 1” sh.p.k	147,984
20	“EN-KU” sh.p.k	40,000
21	“Hidroinvest 1” sh.p.k	246,895
22	“PURE ENERGY STEBLEVA” sh.p.k	40,000
23	“Malido-Energji” sh.p.k	42,439
24	“Termocentrali Vlore” sh.a.	2,426
25	KESH sh.a.	20,943,781
26	“Teodori 2003” sh.p.k	106,883
27	“Energji Ashta” sh.p.k	3,005,283
28	“Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k	449,253
29	“C & S Construction Energy” sh.p.k	443,972
30	“Hydro Energy” sh.p.k	193,457
31	“Wenerg” sh.p.k (HEC Dardha)	124,787
32	“Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k	157,603
33	“Ansara Koncension” sh.p.k	3,624
34	“Energy Plus” sh.p.k	452,322
35	“Hec Vlushe” sh.p.k	558,854
36	“Energy partners AF” sh.p.k	270,837
37	“Korkis 2009” sh.p.k	2,705
38	“Ferar Energy” sh.p.k	40,000
39	“Hec-i Dragoshtunje” sh.p.k	40,000
40	“HP OSTROVICA” sh.p.k	226,040
41	“Hidropower Elektrik” sh.p.k	91,235
42	“DN & NAT Energy” sh.p.k	23,482
43	“Selishte” sh.p.k	73,779
44	“Idro Energia Pulita” sh.p.k	135,561
45	“Bekim Energjitik” sh.p.k	41,705
46	“ERMA MP” sh.p.k	42,893
47	“Dosku Energy” sh.p.k	28,927
48	“DITEKO” sh.p.k	1,919,512
49	“Hec Lanabregas” sh.a.	371,167
50	“Kurum International” sh.a.	2,148,925



	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2019
51	"Hydro Salillari Energy" sh.p.k	61,402
52	"Peshku Picar 1" sh.p.k	7,347
53	"Albanian Power" sh.p.k	192,200
54	"Hydro power Plant Of Korca" sh.p.k	149,398
55	"Henz Energji" sh.p.k	40,000
56	"Hydro Borshi" sh.p.k	120,815
57	"Lu & Co Eco Energy" sh.p.k	12,172
58	"Ergo – Sas" sh.p.k	305,826
59	"Snow Energy" sh.p.k	84,405
60	"Stravaj Energji" sh.p.k	144,886
61	"Gjo Spa Power" sh.p.k	513,535
62	"Erdat Lura" sh.p.k	516,778
63	"E.T.H.H." sh.p.k	57,070
64	"Rej Energji" sh.p.k	109,354
65	"SA-GLE Kompani" sh.p.k	56,543
66	"Caushi Energji" sh.p.k	25,718
67	"Energji Xhaci" sh.p.k	16,949
68	"DUKA T2" sh.p.k	7,014
69	"Tucep" sh.p.k	31,830
70	"TRUEN" sh.p.k	88,610
71	"Hec-Treske" sh.p.k	139,210
72	"Hidro Energy Sotire" sh.p.k	106,350
73	"Shutina energji" sh.p.k	30,811
74	"HIDROCENTRALI CANGONJ" sh.p.k	40,000
75	"Zall Herr Energji 2011" sh.p.k	44,334
76	"Hec Qarr & Kaltan" sh.p.k	64,028
77	"Bardhgjani" sh.p.k	44,791
78	"Gjoka Konstruktion Energji" sh.p.k	118,693
79	"MTC Energy" sh.p.k	116,849
80	"EN Rel Hydro" sh.p.k	40,000
81	"Gurshpat Energy" sh.p.k	114,030
82	"Bistrica 3 Energy" sh.p.k	102,632
83	"Gjore Rec" sh.p.k	185,994
84	"SA'GA-MAT" sh.p.k	14,817
85	"Hidropowerplant Construction" sh.p.k.(Komp Energji)	99,424
86	"UKKO" sh.a.	21,793
87	"Fatlum" sh.p.k	8,119
88	"Ayen As Energji" sh.a.	2,957,654
89	"Koxherri Energji" sh.p.k	19,985
90	"Euron Energy" sh.p.k	605,301
91	"Alb-Energy" sh.p.k	763,175
92	"Energal" sh.p.k	275,035
93	"Kisi-Bio-Energji" sh.p.k	86,613
94	"Gama Energy" sh.p.k.	103,709
95	"Hec Kabash Porocan" sh.p.k	57,127
96	"Lengarica & Energy" sh.p.k	296,954
97	"Mesopotam Energy" sh.p.k	44,131
98	"Denas Power"	58,539
99	"Strelca Energy" sh.p.k	180,824
100	"HP Ujaniku Energy" sh.p.k	87,361



	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2019
101	"C & S Energy" sh.p.k	414,009
102	"Nishova Energy" sh.p.k	27,058
103	Perparimi SK sh.p.k	37,511
104	Dragobia Energy sh.p.k	40,000
105	Ballenja Power Martanesh sh.p.k	45,032
106	Hec Lashkiza sh.p.k	40,000
107	Liria Energji sh.p.k	36,036
108	Devoll Hydropower sh.a.	2,499,332
109	Reka Energy sh.p.k	40,000
110	Gavran Energy sh.p.k	221,083
111	Prell Energy sh.p.k	489,004
112	XHENGU ENERGJI sh.p.k	40,000
113	DAAB ENERGY GROUP sh.p.k.	6,372
114	"M.C INERTE LUMZI" sh.p.k	267,052
115	"ENERGJI UNIVERS" sh.p.k	11,516
116	"Albtek Energy" sh.p.k	-
117	"SKATINË - HEC" sh.p.k	40,000
118	"EUROBIZNES" sh.p.k.	21,733
119	"THE BLUE STAR" sh.p.k	17,882
120	"AFRIMI K" sh.p.k	-
121	"SIMA-COM" sh.p.k	-
122	"HEC LLËNGË" sh.p.k	17,715
123	"ALESIO – 2014" sh.p.k., 2 licenca	40,000
124	"ALESIO – 2014" sh.p.k., 2 licenca	80,000
125	"LUÇENTE - KONÇESIONARE " sh.p.k	40,000
126	"Hydro Seta" sh.p.k	40,000
127	"Favina 1" sh.p.k Voskopoje	40,000
128	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	40,000
129	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	40,000
130	"MALËSIA SOLAR 1" sh.p.k	40,000
131	"MALËSIA SOLAR 2" sh.p.k	40,000
132	"MALËSIA SOLAR 3" sh.p.k	40,000
133	SEMAN 1 SOLAR	40,000
134	"SEMAN2SUN" sh.p.k	40,000
135	"SONNE" sh.p.k	40,000
136	"AED SOLAR" sh.p.k	40,000
137	DOMI TEC sh.p.k	40,000
138	"BLAC ENERGY" sh.p.k	40,000
139	DERBI-E sh.p.k	40,000
140	EDIANI sh.p.k	40,000
141	AEE	40,000
142	"OSOJA HPP" sh.p.k.	40,000
	Total I	49,555,879



II	Liçensë për ndërtim, instalim dhe prodhim	Pagesa Rregullatore 2019
1	"Muso HEC Qyteze" sh.p.k	40,000
2	"Remi" sh.p.k	40,000
3	"Ers-08" sh.p.k	40,000
4	"E-Vento srl Albania" sh.p.k	40,000
5	"Albanian Green Energy" sh.p.k	40,000
6	"Hera" sh.p.k	40,000
7	"Alb Wind Energy" sh.p.k	40,000
8	"Biopower Green Energy" sh.p.k	40,000
	Total II	320,000
III	Liçensë për transmetim të energjisë elektrike/gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2019
1	OST sh.a	8,718,230
2	"Albgaz" sh.a. (Gaz natyror)	14,421
	Total III	8,732,651
IV	Liçensë për shpërndarje të energjisë elektrike/gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2019
1	"Operatori I Sistemit te Shperndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.) (OSHEE sh.a.)	69,948,209
2	"Albgaz" sh.a. (Gaz natyror)	40,000
	Total IV	69,988,209
V	Liçensë për furnizim të energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2019
1	FURNIZUERSI I TREGUT TE LIRE ("FTL" sh.a.)	-
2	"Albpetrol" sh.a.	1,243,224
3	FURNIZUERSI I I SHERBIMIT UNIVERSAL	-
4	"GSA" sh.p.k	7,430,160
5	"GEN-I Tirana" sh.p.k	7,105,386
6	"Energy Supply" shpk	354
7	"Albanian Green Energy" sh.p.k	40,000
8	"Kurum international" sh.a 2 licencat	40,000
9	"Alpiq Energy Albania" sh.p.k	40,000
10	"AXPO Albania" sh.a.	31,842
11	"AYEN Energy Trading" sh.a.	4,956,893
12	"Ayen As Energji" sh.a.	40,000
13	"Noa Energy Trade" sh.p.k	40,000
14	"Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k	40,000
15	"Hidropower Elektrik" sh.p.k	40,000
16	"Future Energy AL" sh.p.k	40,000
17	"Devoll Hydropower" sh.a.	40,000
18	"Albanian Energy Supplier" sh.p.k	2,919,246
19	"Gaea-Energjia alternative e gjelber" shpk	40,000
20	"Electral" sh.p.k	40,000
21	"Lengarica & Energy" sh.p.k	40,000
22	Energjia D O O Veterniksh.p.k	40,000
23	"Energia Gas and Power" sh.p.k (Le Trading Albania sh.p.k)	40,000
24	Dragobia Energy sh.p.k	40,000
25	Ballenja Power Martanesh sh.p.k	40,000
26	"Phoenix Petroleum" sh.a. (Gaz Natyror)	40,000
27	XHENGO ENERGJI sh.p.k	40,000
28	"Albanian General Electricity" sh.a	40,000
29	"Grid Energy" sh.p.k	40,000
30	"ALB ENERGY MARKET" sh.p.k	40,000
31	"Energy Financing Team Tirana" sh.p.k	40,000
32	"Energji Ashta" shpk	40,000
33	"WIND POWER ALBANIA" sh.p.k	40,000
34	"DON – UCD" sh.p.k	40,000
35	"ENER TRADE" sh.p.k	40,000
36	"ReNRGY Trading Group" sh.p.k	40,000
	Totali V	24,767,104



VI	Liçensë për tregtim te energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2019
1	"GSA"sh.p.k	40,000
2	"Gen – I Tirana" sh.p.k	40,000
3	KESH sh.a.	40,000
4	"Wonder Power" sh.a.	40,000
5	"Axpo Albania" sh.a.	40,000
6	"Alpiq Energy Albania" sh.p.k	40,000
7	"Hydro Energy" sh.p.k	40,000
8	"Energy partners AP" sh.p.k	40,000
9	"YLLIAD" sh.p.k	33,730
10	"ENERGY PLUS" sh.p.k	40,000
11	"Energy Supply" sh.p.k	40,000
12	"Hec Vluse" sh.p.k	40,000
13	"Hec Dragoshtunje" sh.p.k	40,000
14	"Erma MP" sh.p.k	40,000
15	"Diteko" sh.p.k	40,000
16	"Hec Lanabregas" sh.a.	40,000
17	"Hydro Salillari Energy" sh.p.k	40,000
18	"Albpetrol" sh.a.	40,000
19	"Malido Energji" sh.p.k	40,000
20	"Albanian Power" sh.p.k	40,000
21	"SNOW ENERGY" sh.p.k	40,000
22	"Stravaj Energji" sh.p.k.	40,000
23	"Hp Ostrovica Energy" shpk	40,000
24	"BINDI" sh.p.k	40,000
25	"Energji Ashta" sh.p.k	40,000
26	"Erdat Lura" sh.p.k	40,000
27	"Danske Commodities Albania" sh.p.k	1,509,011
28	"Rej Energji" sh.p.k	40,000
29	"Wenerg" sh.a.	40,000
30	"Henz Energy" sh.p.k	40,000
31	"Shutina Energji" sh.p.k	40,000
32	"Zall Herr Energji 2011" sh.p.k	40,000
33	"Gjoka Konstruktion-ENERGY" sh.p.k	40,000
34	"Spahiu Gjanc" sh.p.k	40,000
35	"MTC Energy" sh.p.k	40,000
36	"Ayen Energy Trading" sh.a.	40,000
37	"EN Rel Hydro" sh.p.k	40,000
38	"Power Wind Energy" sh.p.k	40,000
39	"Gjure Rec" sh.p.k	40,000
40	"Bistrica 3 Energy" sh.p.k	40,000
41	"Ayen As Energji" sh.a.	40,000
42	"Power Trade Albania" sh.p.k	40,000
43	"Albanian General Electricity" sh.a.	40,000
44	"Antix" sh.p.k	40,000
45	"Emikel" sh.p.k	40,000
46	"Hidropowerplant Construction" sh.p.k.(Komp Energji)	40,000
47	"SA'GA-MAT" sh.p.k	40,000
48	"Energia Gas and Power" sh.p.k (Le Trading Albania sh.p.k)	40,000
49	"Kurum International" sh.a	40,000
50	"Noa Energy Trade" sh.p.k	932,154



VI	Licensë për tregtim te energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2019
51	"Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k	40,000
52	"Hidropower Elektrik " sh.p.k	40,000
53	"Fatlum" sh.p.k	40,000
54	"Future Energy AL" sh.p.k	40,000
55	"Devoll Hydropower" sh.a.	328,373
56	"Albanian Energy Supplier" sh.p.k	40,000
57	"Gaea-Energjia alternative e gjelber" sh.p.k	40,000
58	"Green Energy Trading Albania" sh.p.k	105,753
59	"Electral" sh.p.k	40,000
60	"Koxherri Energji" sh.p.k	40,000
61	"Energal" sh.p.k	40,000
62	"Euron Energy" sh.p.k	40,000
63	"Hec Kabash Porocan" sh.p.k	40,000
64	"Gama Energy" sh.p.k	40,000
65	"Kisi-Bio-Energji" sh.p.k	40,000
66	"Lengarica & Energy" sh.p.k	40,000
67	"Mesopotam Energy "sh.p.k	40,000
68	"Denas Power" sh.p.k	40,000
69	"HP Ujaniku Energy" sh.p.k	40,000
70	"Energjia D O O Veternik" sh.p.k	65,744
71	C & S Energy sh.p.k	40,000
72	Nishova Energy sh.p.k	40,000
73	Perparimi SK sh.p.k	40,000
74	Dragobia Energy sh.p.k	40,000
75	Ballenja Power Martanesh sh.p.k	40,000
76	Hec Lashkiza sh.p.k	40,000
77	Liria Energji sh.p.k	40,000
78	Nordic Invest Group sh.p.k	40,000
79	"Anio Oil & Gas" sh.p.k (Gaz Natyror)	258,329
80	"Phoenix Petroleum" sh.a. (Gaz Natyror)	40,000
81	Energy Market Albania sh.p.k.	40,000
82	DAAB ENERGY GROUP SH.P.K.	40,000
83	XHENGGO ENERGJI sh.p.k	40,000
84	"M.C INERTE LUMZI" sh.p.k	40,000
85	"E N P I" sh.p.k	40,000
86	"Balkan Energy Trade" sh.p.k	40,000
87	"Grid Energy" sh.p.k.	223,008
88	"ALB-ENERGY" sh.p.k.	40,000
89	"ENERGJI UNIVERS" sh.p.k	40,000
90	"ALB ENERGY MARKET" sh.p.k.	40,000
91	"PPC Albania" sh.a.	40,000
92	"Energy Financing Team Tirana" sh.p.k.	2,713,459
93	"ALIN TRADING" sh.p.k.	40,000
94	"ENERGY TO ENERGY" sh.p.k.	40,000
95	"THE BLUE STAR" sh.p.k.	40,000
96	"SMART Trade & Consulting" sh.p.k	40,000
97	"C.G.C" sh.p.k. (Gaz Natyror)	40,000
98	"PRIMA ENERGY" sh.p.k	40,000
99	"WIND POWER ALBANIA" SH.P.K	40,000
100	"SMART WATT" sh.p.k	40,000
101	"Albanian Green Energy" shpk	40,000
102	"Balkan Green Energy" shpk	40,000
103	Furnizuesi i tregut te lire (FTL)	-
104	DON-UCD	8,408
105	Renergy Trading Group	40,000
106	Uradrin	9,354
107	"AEE" sh.p.k.	40,000
108	"TRUEN" sh.p.k	80,000
109	"ENER TRADE" sh.p.k	40,000
110	BALKGAZ sh.p.k (gaz)	40,000
	Total VI	10,147,321
	TOTALI I PAGESAVE RREGULLATORE	163,511,165

**VENDIM****Nr. 237, datë 23.12.2019****MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA
TË RINOVUESHME NGA DIELLI ME
FUQI TË INSTALUAR DERI 2 mw**

Në mbështetje të nenit 10, pika 2 dhe 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 102/2 prot., datë 20.12.2019, të Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve,

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në bazë të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2018, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

- Me vendimin nr. 205, datë 13.9.2018, Bordi i ERE-s ka vendosur për fillimin e procedurës, “Për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli, me fuqi të instaluar deri 2 mw dhe era, me fuqi të instaluar deri 3mw, për vitin 2018”.

- ERE nëpërmjet shkresës 610 prot., datë

28.9.2018, ka kërkuar opinionin e palëve të interesit në lidhje me vendimin nr. 205, datë 13.9.2018, të Bordit të ERE-s “Mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, me fuqi të instaluar deri 2 mw dhe era, me fuqi të instaluar deri 3mw, për vitin 2018”.

- Autoriteti i Konkurrencës shprehet nëpërmjet shkresës nr. 536/1, datë 31.10.2018, se Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë të heqë nga draftmetodologjia afatin 15-vjeçar të kontratave, si edhe çmimet fikse të shitjes së energjisë së rinovueshme.

- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 932/1, datë 15.1.2019, kërkoi përcaktimin e çmimit të blerjes të energjisë elektrike nga impiantet fotovoltaike deri në 2 mw për vitin 2018, për efekt të lidhjes së kontratave të shitblerjes së energjisë elektrike që do të prodhohet nga impiantet fotovoltaike të shoqërive, të cilat kanë nënshkruar kontratat respektive me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

- Në vijim të kësaj kërkesë, ERE me anë të shkresës nr. 40/2, datë 31.1.2019, drejtuar shoqërisë OSHEE sh.a. ka sqaruar se Lidhja e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe këtyre shoqërive nuk kushtëzohet me daljen e vendimit të ERE-s për çmimin e shitjes së energjisë për vitin 2018, pasi në paragrafin e parë të aneks-kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhueseve me përparësi të energjisë elektrike të miratuar me vendimin nr. 255, datë 14.12.2018, të Bordit të ERE-s cilësohet që çmimi do jetë bazuar në vendimin e ERE-s që i përket periudhës kur është nënshkruar autorizimi përfundimtar.

- ERE, me shkresën nr. 40/1 prot., datë 25.1.2019, drejtuar MIE-s ka kërkuar vënien në dispozicion të studimeve të fizibilitetit, si dhe planet e biznesit të shoqërive të cilat kanë nënshkruar kontratat respektive me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

- Në përgjigje të kësaj kërkesë, MIE, me shkresën nr. 653/2, datë 18.2.2019 ka dërguar në ERE informacionin e kërkuar, të dhënat e të cilit janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit në lidhje me centralet fotovoltaike me fuqi të instaluar deri në 2 mw për vitin 2018.



- Në vijim të analizës së materialeve të dërguara nga MIE me anë shkresës nr. 653/2, datë 18.2.2019, si dhe për vështirësitë e hasura në kuptimin dhe zbatimin e çështjeve të veçanta të metodologjisë së miratuar me VKM-n nr. 369, datë 26.4.2017, me anë shkresës nr. 366, datë 24.5.2019, në zbatim të urdhrit nr. 37, datë 24.5.2019, të kryetarit të ERE-s, u zhvillua me datë 3.6.2019 një seancë dëgjimore midis drejtorive teknike të ERE-s, MIE-s, Autoritetit të Konkurrencës, palëve të interesuara dhe shoqërive të cilat kanë nënshkruar kontratë me MIE-n për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centraleve fotovoltaike me kapacitet prodhues deri në 2 mw.

- Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar përfaqësuesit e këtyre shoqërive u shprehën se kostot totale që rezultojnë nga ofertat konkrete për ndërtimin e centraleve fotovoltaike, ndryshojnë nga planifikimi, si dhe në vijim të këtij takimi do të paraqisnin në ERE, informacion zyrtar në lidhje me kostot e investimeve. Përfaqësuesit e MIE-së u shprehën se planbizneset që janë paraqitur në MIE me një vlerë të caktuar investimi kanë qenë kriter vlerësimi për dhënien e miratimit dhe janë të reflektuara në kontratat përkatëse të shoqërive. Këto plan biznese mendohet të jenë baza mbi të cilën duhet të mbështetet ERE për përcaktimin e çmimit për këto teknologji për vitin 2018.

- Shoqëritë “Smart Watt” sh.p.k. dhe “Englantina Xhoxhaj” sh.p.k. me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 213/5 prot., datë 21.06.2019 dhe nr.240/6, datë 21.06.2019, kanë paraqitur informacion mbi kostot e përditësuara të investimeve, si dhe në vijim, kanë paraqitur raportet përkatëse në MIE dhe kanë bërë me dije ERE-n me anë të shkresave me nr. 543 prot. hyrës, datë 10.9.2019 dhe nr. 545 prot. hyrës, datë 11.9.2019.

- Për sa konstatuar nga informacionet e dërguara në ERE dhe diskutimet e kryera në seancën dëgjimore të zhvilluar në datë 3.6.2019, si dhe duke mbajtur në konsideratë se vlerat totale të investimit janë të përcaktuara në nenin 8 të kontratave respektive dhe nuk ka ndryshime të miratuara nga palët, në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të VKM-së nr. 369, datë 26.4.2017, u kryen analizat dhe llogaritjet përkatëse për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga centralët fotovoltaike për vitin 2018.

- Në lidhje me përcaktimin e çmimit të blerjes së

energjisë elektrike të prodhuar nga centralët eolike deri në 3 mw, konstatohet se nuk rezultojnë të jetë lëshuar asnjë miratim nga autoriteti shtetëror, MIE, për këtë teknologji gjatë vitit 2018, ndaj përcaktimi i një çmimi për këtë kategori është i panevojshëm e i pazbatueshëm.

- Çdo ndryshim, në aktet ligjore dhe nënligjore, përbën objekt për rishikimin e këtij çmimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të prodhimit të energjisë elektrike nga centralët fotovoltaike për vitin 2018 prej 71.2 euro/mWh.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 238, datë 23.12.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SA’GA MAT” SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 170, DATË 7.11.2019, TË ERE-S, MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SA’GA MAT” SHPK, PËR LËNIEN PENG TË ASETVE TË LUAJTSHME, TË ARDHSHE APO TË TASHME, DHE VENDOSJEN E HIPOTEKËS MBI ASETET E PALUAJTSHME, QË DO T’I PËRKASIN HEC-eve “GERMAN 1” DHE “GERMAN 2”, NË FAVOR TË BANKËS “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA, PËR EFEKT TË DHËNIES SË KREDISË PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT TË VEPRAVE HIDROENERGJETIKE “GERMAN 1” DHE “GERMAN 2”

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 57 dhe 155, të ligjit nr. 44/2015,



“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 119/10-1, datë 18.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe relacionin nr. 120/3 prot., datë 20.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SA’GA Mat” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 170, datë 7.11.2019,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 170, datë 7.11.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur:

- Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SA’GA Mat” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme, të ardhshme apo të tashme, dhe vendosjen e hipotekës mbi asetet e paluajtshme që do t’i përkasin HEC-it “German 1”, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për efekt të dhënies së kredisë për financimin e ndërtimit të veprës hidroenergetike “German 1”.

- Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SA’GA Mat” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme, të ardhshme apo të tashme, dhe vendosjen e hipotekës mbi asetet e paluajtshme që do t’i përkasin HEC-it “German 2”, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për efekt të dhënies së kredisë për financimin e ndërtimit të veprës hidroenergetike “German 2”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, shoqëria “SA’GA Mat” sh.p.k. i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 01/4 prot, datë 21.11.2019, me anë të së cilës ka kërkuar rishikimin e vendimit.

- “Rregullorja për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” në nenin 16: Ridëgjimi dhe Ankimi kundër vendimit të Bordit, parashikon se: “Për një vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.”

- Në kuptim të sa më sipër, si dhe në analizë të llogaritjes së afateve të cilat lidhen me momentin e

marrjes dijeni mbi vendimin objekt ankimi, si dhe depozitimin e kërkesës për rishikim, Shoqëria rezulton se e ka depozituar këtë kërkesë brenda afateve të parashikuara në “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”.

- Në lidhje me përmbajtjen e ankimit, vlen të marrim në analizë, në cilësinë e provës, elementët sa më poshtë:

- Shoqëria ngre pretendime që lidhen me të drejtën e ERE-s për të kërkuar çdo informacion të nevojshëm me qëllim shqyrtimin e praktikës, e në rastin konkret ky informacion lidhet me depozitimin në ERE të miratimit të autoritetit shtetëror, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për zëvendësimin e palës kontraktore, shoqërisë aplikuese e koncesionare, me Bankën, në rast se shoqëria dështon në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga marrëveshja e huasë.

- Në lidhje me sa më sipër, sqarojmë se është në diskrecionin e plotë të ERE-s të vlerësojë rast pas rasti, të gjithë elementet e nevojshëm që i shërbejnë një vendimmarrje e cila duhet të bazohet në bindjen e plotë e të arsyeshme por edhe në dokumentacionin e domosdoshëm i cili në rastin konkret lidhet pikërisht me dhënien e qëndrimit të MIE-s, për sa më sipër, që do të sillte si rrjedhojë ndryshimin e palës koncesionare në këtë marrëveshje.

- Sa më sipër, pavarësisht kundërshtive, e ka konfirmuar edhe vetë shoqëria e cila ka aplikuar pranë MIE-s për njohjen e kësaj të drejte.

- Në cilësinë e provës së re, në këtë vendimmarrje është dërguar në ERE edhe përgjigja e MIE-s, e cila me anë të shkresës së saj nr. 7547/2, datë 25.9.2019, ka bërë me dije se: midis ish-Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (sot “MIE”) dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Sigers” sh.p.k. dhe “Sina-98” sh.p.k. është nënshkruar kontrata koncesionare e formës BOT (Ndërtim-operim-transferim) nr. 83 rep., nr. 61 kot., datë 10.1.2011, për ndërtimin e hidrocentraleve “Germani F”, “Germani 2”, “Germani 3”, “Germani 4”, “Germani 5”. Së pari, kërkesa juaj i referohet pikave 12.6.1 dhe 12.6.2, të kontratës së koncesionit të cilat kanë të bëjnë me “Njoftimin e palëve financuese” dhe “Zëvendësimin e koncesionarit”. Në pikën 12.6.2, ndër të tjera cilësohet se: “Në rast se nuk është i



mundur korrigjimi i shkeljes nga koncesionari, pala financuese (nëse e gjykon me interes) zgjedh, të ndërhyjë duke i propozuar autoritetit kontraktues transferimin e projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose të një subjekti zëvendësues i cili duhet të ketë ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barasvlershme me atë të koncesionarit në momentin e fillimit të garës”. Referuar sa me sipër sqarojmë se, nuk ndodhemi në kushtet e shkeljes nga ana e koncesionarit të detyrimeve kontraktore që cenojnë zbatimin dhe operimin e koncesionit.

- Pavarësisht sa më sipër, pas këmbënguljes së bankës, në cilësinë e palës financuese, shoqëria “SA’GA Mat” sh.p.k., i është drejtuar sërish ministrisë dhe gjithashtu banka financuese i është drejtuar Ministrisë për dhënien në formë të shprehur të miratimit për zëvendësimin e palës financuese në kushtet kur mund të rezultojë se palët nuk përmbushin detyrimet e marrëveshjes së huasë.

- Të dyja këto korrespondenca janë depozituar në ERE në cilësinë e provës së re.

- Në këmbëngulje të zbatimit të sa më sipër, pala ka vijuar insistimin për përmbushjen e këtij detyrimi nga MIE, duke adresuar kërkesën e saj edhe para Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Platformës për Bashkëqeverisjen, një kopje të të cilave i ka sjellë në cilësinë e provës së re edhe në këtë ankim.

- Gjatë mbledhjes së Bordit të ERE-s të datës 23.12.2019, përfaqësuesit e shoqërisë “SA’GA Mat” sh.p.k. dhanë shpjegime në lidhje me rrethanat që lidhen me objektin e kërkesës dhe iu la detyrë përcjellja e informacionit shtesë, si dhe qëndrimin të MIE-s në lidhje me ndryshimin e palës financuese.

- Për sa më sipër, në kushtet kur kërkesa është depozituar në afat, pala është e qartë për detyrimet e saj dhe ka bërë të gjitha përpjekjet në vullnetin e saj për të përmbushur detyrimin për marrjen e miratimit të MIE-s për sa më sipër bërë me dije,

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “SA’GA Mat” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 170, datë 7.11.2019, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘SA’GA Mat’ sh.p.k., për

lënien peng të aseteve të luajtshme të ardhshme apo të tashme dhe vendosjen e hipotekës mbi asetet e paluajtshme, që do t’i përkasin HEC-ve “German 1” dhe “German 2”, në favor të bankës ‘Intesa Sanpaolo Bank Albania’ sh.a., për efekt të dhënies së kredisë për financimin e ndërtimit të veprave hidroenergjetike ‘German 1’ dhe ‘German 2’”.

2. Ndryshimin e pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 170/2019, si më poshtë:

a) Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SA’GA Mat” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme, të ardhshme apo të tashme, dhe vendosjen e hipotekës mbi asetet e paluajtshme që do t’i përkasin HEC-it “German 1”, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për efekt të dhënies së kredisë për financimin e ndërtimit të veprës hidroenergjetike “German 1”, me kusht që të depozitohet në ERE qëndrimin e MIE-s mbi zëvendësimin e palës financuese, përpara përfundimit të afatit të shqyrtimit të kësaj kërkesë në ERE.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “SA’GA Mat” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 239, datë 23.12.2019

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 114, DATË 22.7.2019, MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPE GJADËR” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “GJADËR NR. 1/1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2134 kW, HEC “GJADËR NR. 1/2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 4406 kW, HEC “GJADËR NR. 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2983 kW, HEC “GJADËR NR. 3”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 3874 kW, HEC “GJADËR NR. 4”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5922 kW, HEC “GJADËR NR. 5”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5619 kW, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 24938 kW

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të nenit 16, pika 1, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 12/1 prot., datë 20.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me rishikimin e vendimit nr. 114, datë 22.7.2019, Mbi licencimin e shoqërisë “SPE Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 114, datë 22.7.2019, vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “SPE Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: HEC “Gjadër nr. 1/1”, me kapacitet të instaluar 2134 kW, HEC “Gjadër nr. 1/2”, me kapacitet të instaluar 4406 kW, HEC “Gjadër nr. 2”, me kapacitet të instaluar 2983 kW, HEC “Gjadër nr. 3”, me kapacitet të instaluar 3874 kW, HEC “Gjadër nr. 4”, me kapacitet të instaluar 5922 kW, HEC “Gjadër nr. 5”, me kapacitet të instaluar 5619 kW; me kapacitet total të instaluar 24938 kW, për një afat 29 vjet e 2 muaj, me kushtin që brenda 3 muajve të dokumentojë marrjen e lejes së ndërtimit të zbardhur.

2. Në çdo rast që autoriteti kontraktor do të shprehet me vendim për shtyrje të afatit të ndërtimit dhe vënies në punë të veprës, shoqëria “SPE Gjadër” sh.p.k. t’i drejtohet ERE-s për miratimin e ndryshimeve që do të prodhojë kontrata shtesë e koncesionit.

- Duke qenë se nga ana e shoqërisë ky kusht nuk u plotësua në kohë, në përfundim të afatit të kushtit të dispozitivit të sipërcituar, ERE iu drejtua shoqërisë “SPE Gjadër” sh.p.k., me shkresën nr. 195/4 prot., datë 19.11.2019, duke i kërkuar informacion mbi plotësimin e tij.

- Në përgjigje të shkresës së ERE-s, shoqëria “SPE Gjadër” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 195/10 prot., datë 10.12.2019, ka përcjellë shkresën drejtuar MIE-s me nr. 338 prot., datë 10.12.2019, me anë të së cilës i ka shprehur shqetësimin në lidhje me mospërkrahjen nga kjo e fundit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, për të garantuar zbardhjen e lejes së ndërtimit të lëshuar me vendimin e KKT-së me nr. 9, datë 9.9.2015.

- ERE vlerësoi se plotësimi i kushtit të vendimit të ERE-s nr. 114, datë 22.7.2019, nuk varet nga vullneti i shoqërisë së licencuar por nga ai i institucioneve shtetërore. ERE mori në konsideratë përpjekjet që shoqëria ka bërë për të plotësuar këtë kusht që nga fillimet e aplikimit për licencë.

- Shtyrja e afatit të ndërtimit dhe vënies në punë të veprës, për shkak të mos marrjes së lejes së ndërtimit, kërkon ndryshime në kontratën e koncesionit që lidhen me afatet e përcaktuara në të për përfundimin e ndërtimit dhe vënies në punë të veprës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1, të vendimit të ERE-s nr. 114, datë 22.7.2019, si vijon:

Të licencojë shoqërinë “SPE Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: HEC “Gjadër nr. 1/1”, me kapacitet të instaluar 2134 kW, HEC “Gjadër nr. 1/2”, me kapacitet të instaluar 4406 kW, HEC “Gjadër nr. 2”, me kapacitet të instaluar 2983 kW, HEC “Gjadër nr. 3”, me kapacitet të instaluar 3874 kW, HEC “Gjadër nr. 4”, me kapacitet të instaluar 5922 kW, HEC “Gjadër nr. 5”, me kapacitet të instaluar 5619 kW; me kapacitet total të instaluar 24938 kW, për një afat 29 vjet e 2 muaj, me kushtin që përpara



vënies në operim të veprës, të depozitave në ERE kontratën shtesë të koncesionit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “SPE Gjadër” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 240, datë 23.12.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E KËRKESAVE DHE
PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E
OPERATORIT TË EMËRUAR TË
TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
(NEMO) DHE ROLET DHE
PËRGJEGJËSITË E NEMO-s DHE
OPERATORËVE TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË NË
TREGUN E BASHKUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 57, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, VKM-së nr. 322, datë 15.5.2019, “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut”, Direktivën nr. 2016/1148, “Mbi sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike” (NIS), e njohur ndryshe dhe si Direktiva mbi “*Cybersecurity*” nenit 19, pika 1, germa f dhe nenit 26, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga Drejtoritë Teknike me nr. 119/3 prot., datë 18.12.2019, në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO-s dhe

operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar

konstatoi se:

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, gjatë takimit të Grupit të Energjisë, të zhvilluar në Bosnjë, në datë 23.10.2019, ka propozuar që në Rregulloren e licencimit, për disa ndryshime në të cilën ka filluar procedurën ERE, të parashikohen edhe kriteret e funksionimit të Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), siç është rekomanduar nga Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB), në mbledhjen e datës 24.4.2019.

- Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB) ka mbështetur masat rregulatore për implementimin e kushteve të Bashkimit të Tregjeve të ditës në avancë nga palët kontraktore të Komunitetit të Energjisë.

- Rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve (*Capacity Allocation and Congestion Management*) (CACM) përcakton qartë se për të bërë të mundur funksionimin e bashkimit të tregjeve, të ditës në avancë të sektorit të energjisë elektrike, në vendet anëtare të Sekretariatit dhe Bashkimit Evropian, duhet të përcaktohen përgjegjësitë e operatorëve të sistemit të transmetimit (OST) dhe operatorëve të tregut të ditës në avancë (NEMO).

- Në mënyrë që operatorët e tregut të ditës në avancë të jenë të integruar institucionalisht në procesin e bashkimit të tregjeve, Rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve përcakton një kornizë për përcaktimin e Operatorëve të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

- Roli i NEMO-s është funksionimi i tregjeve të ditës në avancë dhe/ose *intraday* nën regjimin e bashkimit të tregjeve, siç përcaktohet në Rregulloren për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve. Rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve gjithashtu siguron kriteret e hollësishme sipas të cilave Operatori i Tregut të Energjisë Elektrike (*Nominated Energy Market Operator*) (NEMO) do të përcaktohet dhe funksionojë.

- ENC ka propozuar që ERE të marrë masa për të hartuar/integruar në aktet rregulatore, objekt miratimi e shqyrtimi nga ERE, edhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së Operatorit të Tregut.



- Në vlerësim të sugjerimeve të Sekretariatit në lidhje me parashikimin e kriterëve të Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), u hartua drafti i cili reflekton propozimet e sekretariatit, si dhe të Bordit të Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB).

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO), rolet dhe përgjegjësitë e NEMO-s dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

KËRKESË

Nr. 10966/1, datë 30.12.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit: “Sistemim rrugësh, blloku tek Stadiumi”, Pogradec.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Pogradec.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit

dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, keni të drejtë që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, të paraqitni pretendimet tuaja nëse keni, pranë Bashkisë Pogradec, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 23,004,584,25 (njëzet e tre milion e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëzet e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



Lista Paraprake e shpronësimeve që preken nga projekti "Sistemi rrugësh, blloku tek Stadiumi", Bashkia Pogradec

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Numri i Pasurisë	Sip. Total	Sip. e Shpronësuar	Lloji i pasurisë	Ndertëse		Tokë Trrall		Vlera Totale në Lekë	Konfirmime me shkresë nga ZVRPP nr.2135, date 17.04.2018	Shënime
								Çmimi në Lekë/m2	Vlera në Lekë	Çmimi në Lekë/m2	Vlera në Lekë			
1	Thomas	Mihallaq	Nago	8581	1.338	406.76	23.39	Trrall		10491	245,384.49	245,384.49		
	Leonard	Mihallaq	Nago											
	Tefia	Kopi	Iftica											
	Dhimitra	Kopi	Spiro											
2	Llazi	Dhimiter	Blazhde	8581	1/80	1264	80.3	Trrall		10491	906,107.67	906,107.67		Kufizim seksioni E
	Margarit	Dhimiter	Blazhde											
	Brunilda	Gjergji	Blazhde											
3	Vllazeria		Guxholli	8581	1/443	508	322.27	Trrall		10491	3,380,934.57	3,380,934.57		
4	Jordan	Llambi	Vako	8581	1/12	110	110	Trrall		10491	1,154,010.00	1,154,010.00		
	Drita	Llambi	Vako											
	Agim	Azis	Dervishllari											
5	Mynever	Azis	Dervishllari	8581	2/131	22.5	22.5	Trrall		10491	236,047.50	236,047.50		
	Safije	Azis	Dervishllari											
	Nazime	Azis	Dervishllari											
6	Genci	Reiz	Dervishllari	8581	2/132	114	114	Trrall		10491	1,195,974.00	1,195,974.00		
	Nazime	Azis	Dervishllari											
	Mynever	Azis	Dervishllari											
7	Garip	Nazif	Dikellari	8581	2/133	114	114	Trrall		10491	1,195,974.00	1,195,974.00		
	Rexhep	Nazif	Dikellari											
	Pluturije	Nazif	Dikellari											
8	Myzafer	Nazif	Dikellari	8581	2.333	224	224	Trrall		10491	2,349,984.00	2,349,984.00		Kufizim seksioni E
	Dhurata	Nebi	Malellari											
	Gurie	Myfit	Malellari											
9	Lumturije	Myfit	Malellari	8581	6.388	993	63.96	Trrall		10491	671,004.36	671,004.36		
	Bajram	Myfit	Malellari											
	Hysen	Servet	Minarolli (B)											
10	Ikbal		Myfitiu	8581	6.450	3940	91.39	Trrall		10491	958,772.49	958,772.49		
	Anastasi (Aishe)		Myfitiu (Kace)											
	Nevzat		Minarolli											
	Fatmir		Minarolli											
	Adelina	Nexhip	Minarolli											
	Zhaneta	Nexhip	Minarolli											
11	Lida	Nexhip	Minarolli	8581	2/135	120	13.67	Trrall		10491	143,411.97	143,411.97		
	Makbule	Kasem	Minarolli											
	Sotirag	Koli	Angjellari											
12	Aleksander	Enver	Vesho	8581	1/81+2-1	48.2	48.2	Apartament	45216	2,179,411.20		2,179,411.20		Kufizim seksioni E
	Zana	Qerim	Vesho											
	Petrit	Demir	Rushiti											
13	Lumturije	Jashar	Rushiti	8581	1/81+3-1	40	40	Apartament	45216	1,808,640.00		1,808,640.00		
	Genci	Petrit	Rushiti											
	Gurije	Xhevahir	Elmas											
14	Nevrus	Xhevahir	Elmas	8581	1/81+4-1	25	25	Apartament	45216	1,130,400.00		1,130,400.00		
	Elsa	Shaban	Kurti											
15				8581	1/81+6-1	27.3	27.3	Apartament	45216	1,234,396.80		1,234,396.80		
16	Ferdane	Ismail	Rapollari	8581	1/81+1-1	25.5	25.5	Apartament	45216	1,153,008.00		1,153,008.00		
17	Leonidha	Nevrus	Bracellari	8581	1/81+1-3	67.7	67.7	Apartament	45216	3,061,123.20		3,061,123.20		
	Liljana	Fuat	Bracellari											
Total i shpronësimit										10,566,979.20	12,437,605.05	23,004,584.25		

Shënime:

Çmimi për pasuritë Trrall është marrë sipas VKM nr. 89 date 03.02.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"

Çmimi për pasuritë Apartament është marrë nga mesatarja e shitblerjeve të 3 muajve të fundit nga ZVRPP me shkresën nr 2135, datë 17.04.2018

Informacioni për pasuritë e mesipërme është marrë nga ZVRPP Pogradec



NDREQJE GABIMI MATERIAL

Lista e projekteve (tabela) që duhet të ishin bashkëlidhur vendimit nr. 799, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 170, datë 27.3.2019, të Këshillit të

Ministrave, ‘Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1 000 000 000 (një miliard) lekë në programin: ‘Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 170, datë 13.12.2019.

Tabela - Lista e projekteve

Nr.	Institucioni përfutues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Financimi për vitin 2019	Financimi për vitin 2020
		Totali	1,814,235,669	1,116,424,574	697,811,095
		<i>Projekte për rehabilitimin e digave</i>	<i>448,112,980</i>	<i>264,438,520</i>	<i>183,674,460</i>
1	Bashkia Krujë	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Tapizë	208,640,000	180,000,000	28,640,000
2	Bashkia Mat	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Shoshaj	22,953,070	14,700,000	8,253,070
3	Bashkia Roskovec	Rehabilitimi i ujëmbledhësit Kurjan	27,684,250	14,738,520	12,945,730
4	Bashkia Kamëz	Rezervuari Paskuqan	64,835,713	25,000,000	39,835,713
5	Bashkia Pukë	Rehabilitimi i digës së rezervuarit Kukaj	28,000,000	10,000,000	18,000,000
6	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Arapaj 1	29,945,787	0	29,945,787
7	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Spitalle	20,054,160	0	20,054,160
8	Bashkia Rrogozhinë	Rehabilitimi i digës dhe skemës ujitëse të rezervuarit të Okshtimit	46,000,000	20,000,000	26,000,000
		<i>Projekte për infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja</i>	<i>1,366,122,689</i>	<i>851,986,054</i>	<i>514,136,635</i>
2	Bashkia Elbasan	Përroi Zaranikës	200,000,000	103,578,002	96,421,998
3	Bashkia Fier	Dega Ujitëse e Fierit	42,300,000	20,000,000	22,300,000
4	Bashkia Divjake	Skema ujitëse-Spektori i Ri në Xeng	70,536,158	28,573,126	41,963,032
5	Bashkia Kufonjë	Kanali ujitës Kabash, Leskovik	17,000,000	10,000,000	7,000,000
6	Bashkia Korçë	Rikonstruksioni i pjesës së Degës Venurok	40,960,000	15,000,000	25,960,000
7	Bashkia Pustec	Pastrimi i kanaleve të II dhe të III kullit dhe ndërtimi i urash	1,026,479	1,026,479	
8	Bashkia Mirditë	Rehabilitimi i skemës ujitëse ujëmbledhësi Malaj-2 (Faza 3)	51,039,370	20,000,000	31,039,370
9	Bashkia Malësi e Madhe	Skema ujitëse me rehabilitimin e kanaleve sekondare të Shkodrit, Loti 2	48,126,458	35,000,000	13,126,458
10	Bashkia Pukë	Rehabilitimi i Kanalit Vadiës fshati Qerret	25,500,000	15,000,000	10,500,000
11	Bashkia Shkodër	Kanali Ujitës KU-21	14,510,321	14,510,321	
12	Bashkia Shijak	Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Hardhishtë-Rreth	64,324,175	25,000,000	39,324,175
13	Bashkia Belsh	Kanali i Ujitjes Çerrago	57,404,221	25,000,000	32,404,221
14	Bashkia Gramsh	Rikonstruksion i kanalit ujitës Gafigat-Cingar Sipër-Drizë	33,652,246	20,000,000	13,652,246
15	Bashkia Librazhd	Rikonstruksion i kanalit vaditës Gurakuq Kuturman, (Loti I të ndërtimi i Sifonit të Madh)	32,454,000	15,000,000	17,454,000
16	Bashkia Këlcyre	Skema Ujitëse Ballaban, Ujitja e Pushës Ballaban, vazhdim	27,970,217	10,000,000	17,970,217
17	Bashkia Tepelenë	Rehabilitimi i Kanaleve Ujitës të Dukaj (1.4 km) dhe digës së ujëmbledhësit Dukaj, Bashkia Tepelenë	13,194,000	13,194,000	
18	Bashkia Bulqizë	Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Vija e Mullirit Gjoricë	42,800,328	20,000,000	22,800,328
19	Bashkia Dibër	Kanali ujitës Përroi i Lixhave Lagjia Dobrovë	7,660,000	7,660,000	
20	Bashkia Dibër	Sifoni ujitës dalja e rezervuarit Shumbat	10,183,000	10,183,000	
21	Bashkia Kukës	Rehabilitimi i kanalit ujitës Bushat, Njësia Administrative Dicaj Bashkia Kukës	17,115,990	10,000,000	7,115,990
22	Bashkia Roskovec	Rehabilitimi i pesë kanaleve ujitëse në zonën e Sukut	55,607,977	20,000,000	35,607,977
23	Bashkia Lushnjë	Rehabilitimi i kanalit ujitës U.3-15, U.3-15/4, U.3-15/5 në fshatin Fier i Ri, Nj.A.d. Krujë	18,566,441	10,000,000	8,566,441
24	Bashkia Vlorë	Kanali Ujitës VLII-10	13,750,000	11,115,990	2,634,010
25	Bashkia Ura Vajgurore	Kanali Ujitës BRU-15 Manastir & Ushqyesi i Rezervuarit	24,379,994	15,000,000	9,379,994
26	Bashkia Cërrik	Rehabilitimi Sistemi Ujitës	28,000,000	15,000,000	13,000,000
27	Bashkia Fushë Arrëz	Rikonstruksion i kanalit fshati Thallë	30,816,178	15,000,000	15,816,178
28	Bashkia Përmet	Kanali Strembec	22,700,000	12,700,000	10,000,000
29	Bashkia Libohovë	Rehabilitimi i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë	37,100,000	17,000,000	20,100,000



30	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier	Mbrojtja nga Gërryerja Lumi Kseras krahu i majtë (zonat I, II dhe III). Gjirokastër	79,598,564	79,598,564	
31	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier	Mbrojtje nga Lumi Vjosë, në Kashisht	82,000,000	82,000,000	
32	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës	Argjinatura mbrojtëse Zalli Sines	45,000,000	45,000,000	
33	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë	Mbrojtje nga përmytjet nga lumi Shkumbin në Shushicë (lagjia Gogollaret)	38,000,000	38,000,000	
34	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë	Argjinatura e lumit Drin, krahu i djathtë i rrjedhës Ishull Shëngjin	72,846,572	72,846,572	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 616 lekë